



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 40 regjistër (JR)
Datë 23.07.2021

Nr. 27 i vendimit
Datë 06.07.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 06.07.2022, ditën e mërkurë, në orën 16:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 40/2021, datë 23.07.2021, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë, që i përket subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik Darjel Sina, të paraqitura në ankim, parashtrimet e konkluzionet përfundimtare të paraqitura nga Komisionerja Publike Irena Nino, e cila kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, shqyrtoi dhe dëgjoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Gerd Hoxha (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar *ex officio* procesit të rivlerësimit kalimtar.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.
3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
(i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
(ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
(iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
(iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
(v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), pasi kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dërgoi një raport² pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit ka referuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.*
5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga vetë subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar pranë Komisionit një raport³ të hollësishëm, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga organet ndihmëse, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

¹“Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Gerd Hoxha, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” është përcjellë në Komision nga ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.05.2018.

²Raporti nr. {***} prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KZHD-së nr. {***}, datë 01.03.2019, është përcjellë në Komision nga DSIK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019.

³“Raporti për analizimin e aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit Gerd Hoxha” i KLGj-së, me nr. {***} prot., datë 25.06.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 393, datë 03.06.2021, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, vendosi:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, transferimin e gjetjes nr. {***} prot., datë 13.1.2020, të vëzhguesit ndërkombëtar dhe gjetjes nr. {***} prot., datë 20.1.2020, të vëzhguesit ndërkombëtar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore [...].

8. Këtë vendim, Komisioni e ka mbështetur mbi konkluzionet e arritura për secilin nga kriteret e rivlerësimit, si vijon.

8.1 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë:

[...] subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën “vetting”, pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohej parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

[...] Në lidhje me problematikat e konstatuara/çështjet e trajtuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se:

(i) pavarësisht mospërputhjes të konstatuar midis deklaratës noteriale të bashkëshortëve me deklarimet e ish-bashkëshortes së subjektit në DPV/2004, në vështrim të Aneksit D, pika 5 e Kushtetutës, mospërputhjet në deklarime nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore apo të sjellin pasoja për subjektet, për sa kohë ato nuk janë përpjekur të fshehin apo të deklarojnë në mënyrë të pasaktë pasurinë;

(ii) balanca negative e fondeve në vitin 2006, prej 95.792 lekësh, dhe në vitin 2011, në shumën prej 10.604 lekësh, janë në një vlerë të papërfillshme për të sjellë si pasojë zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;

(iii) pavarësisht faktit nëse prindërit e ish-bashkëshortes kanë pasur ose jo të ardhura për dhënie e huas në shumën 25.000 euro, nuk mund të shërbejë si shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit, për sa kohë kemi të bëjmë me një detyrim të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me ish-bashkëshorten e tij, të lindur para martesës me të, si dhe aktualisht ky detyrim nuk i përket subjektit, por ish-bashkëshortes së tij, që është subjekt rivlerësimi më vete. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarimet e pasakta të konstatuara apo mungesa financiare si më sipër, nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit, dhe as besimin e publikut të drejtësisë.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Gerd Hoxha, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

8.2 Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës:

[...] Subjekti i rivlerësimit Gerd Hoxha ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

8.3 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional. [...] Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në lidhje me dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, Komisioni, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, [...] çmon se këto gjetje nuk përbëjnë shkak për vlerësim negativ të aftësive profesionale të subjektit, pasi nuk ndikojnë në aftësitë profesionale të tij, si dhe nuk përbëjnë shkak për ta konsideruar të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e tij si magjistrat, por që në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, këto dy gjetje duhet të përcillen pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

9. Komisioneri Publik Darjel Sina, në mbështetje të rekomandimit⁴ për paraqitje ankimi, të nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), ka paraqitur ankim⁵ kundër vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit, me anë të të cilit ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”), që pas marrjes në shqyrtim të shkaqeve të ankimit, të vendosë, në mënyrë alternative, ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.
10. Referuar ankimit, Komisioneri Publik ka çmuar se procesi i hetimit, i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit Gerd Hoxha, nuk ka qenë i plotë dhe, për rrjedhojë, përfundimet e arritura nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara. Komisioneri Publik ka kërkuar kontrollin e vendimit të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të interesave privatë të subjektit të rivlerësimit, të personave të lidhur e të personave të tjerë të lidhur me të, si dhe kryerjen e një analize të re financiare⁶, me qëllim justifikimin bindshëm të burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive, me të ardhura të ligjshme, sipas urdhërimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik, mbështetur në rekomandimin e ONM-së, përmbajtjen e mendimit dhe dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, të cilat i kishte bërë pjesë të shkaqeve të ankimit, çmon se përfundimi i Komisionit nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm. Referuar fakteve dhe rrethanave të prezantuara në ankim, sipas Komisionerit Publik, në arsyetimin e Komisionit mungon vlerësimi nëse për rastin konkret, në një vlerësim

⁴ Shih rekomandimin e ONM-së nr. {***} prot., datë 08.07.2021, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në linkun në vijim:

<http://ikp.al/wp-content/uploads/2021/07/19.Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-393-dat%C3%AB-3.6.2021.pdf>

⁵ Shih ankimin e Komisionerit Publik me nr. {***} prot., datë 15.07.2021, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në linkun në vijim:

<http://ikp.al/wp-content/uploads/2021/07/56.Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-393-dat%C3%AB-3.6.2021-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%AB-sr-z.-Gerd-Hoxha.pdf>

⁶ Bazuar në pretendimet e veçanta mbi shkaqet e ankimit, të trajtuara në vijim në këtë vendim.

të përgjithshëm të të tria kriterëve apo vlerësim tërësor të çështjes, gjen zbatim neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

11. Komisioneri Publik pretendon se hetimi i kryer nga Komisioni ka mangësi dhe, për rrjedhojë, në gjendjen që janë aktet, nuk mund të konkludohet se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
12. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

A. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë

13. Shkaqet e ankimit, duke u ndarë sipas pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, janë sa më poshtë vijon.

14. Komisioneri Publik ka vlerësuar se për pasurinë apartament me sipërfaqe 125 m², në Tiranë, burimet e krijimit të deklaruara respektivisht: (i) kursime në *cash* të subjektit të rivlerësimit në shumën 1.500.000 lekë; dhe (ii) hua në shumën 25.000 euro (përdorur për mobilim), marrë nga prindërit e ish-bashkëshortes së subjektit, janë elemente që duhet të rivlerësohen nga Kolegji në kuadër të analizës financiare, lidhur me mjaftueshmërinë e tyre, për shkak se:

14.1 Për të ardhurat e deklaruara si të përfituara në periudhën 1995-2000, nga të cilat kanë rrjedhur kursimet, të deklaruara si burim i pagesës së këstit të parë, provohet se nuk janë paguar detyrimet tatimore, duke mos plotësuar kështu kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme.

14.2 Detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimit të huas në shumën 25.000 euro, dhënë nga prindërit e znj. E. Ll. [hua e cila deklarohet nga subjekti i rivlerësimit se ka shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga Emporiki Bank dhe përdorur në funksion të pasurisë në bashkëpronësi të tyre], i takon edhe subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha. Analiza financiare mbi mundësinë e prindërve të znj. E. Ll. për të mbuluar me burime të ligjshme shumën 25.000 euro në vitin 2011, duhej të ishte kryer për periudhën 01.01.2005 e deri në momentin e dhënies së huas, si dhe duke rivlerësuar të gjitha burimet e deklaruara dhe të pretenduara të të ardhurave të prindërve të znj. E. Ll., pasi të ardhurat e znj. Ll. dhe të prindërve të saj, deri në fund të vitit 2004, kanë shërbyer si burim krijimi i shumës së kursimeve në *cash*, të deklaruara prej saj në shumën 5.000.000 lekë. Analiza e kryer nga Komisioni, duke konsideruar shpenzimet e familjes Ll. në minimumin e shpenzimeve sipas ILDKPKI-së, nuk përputhet me deklaratimet.

15. Komisioneri Publik, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se mbetet i nevojshëm rivlerësimi nga ana e Kolegjit i pasurisë automjet tip "Citroen C4", blerë në vitin 2012 dhe shitur në vitin 2016. Komisioni ka vlerësuar të përfshijë në analizën financiare shumën e pretenduar nga subjekti, të disponuar në *cash*, në vlerën 1.200.000 lekë në vitin 2011, si dhe pakësimin nga kursimet në *cash* të subjektit dhe bashkëshortes së tij, si burim për blerjen e automjetit në vitin 2012. Kolegji duhet të rivlerësojë bazueshmërinë e argumenteve të përdorura nga Komisioni, lidhur me kursimet e subjektit të rivlerësimit, çka do të ndikonte në mundësinë financiare të tij dhe të personit të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe investimet e këtyre viteve.
16. Komisioneri Publik ka vlerësuar se është i nevojshëm rivlerësimi i zërave përbërës të analizës financiare dhe mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes së tij, për të mbuluar me burime të ligjshme, kursimet e deklaruara ndër vite, të përdorura për blerjen e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 126,5 m², në Vlorë, pasi në lidhje me kursimet në *cash* të vitit 2011, me burim të ardhurat nga shitja e një automjeti, nga verifikimi i deklaratës periodike të

interesave të vitit 2011 të subjektit të rivlerësimit, e cila për këtë proces ka vlerën e provës, nuk rezulton të jenë deklaruar disponimi i kursimeve në *cash* në këtë vlerë, dhe si të tilla, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, nuk mund të konsiderohen si kursime *cash* që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 2016. Deklarimet periodike vjetore të pasurisë të ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit mbi kursimet në *cash* të periudhës 2006-2010, të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, nuk mbështesin pretendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.

17. Komisioneri Publik ka vlerësuar se rivlerësimi i fakteve dhe i rrethanave mbi burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë automjet, tip “Audi”, në pronësi të z. R. H. dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit, përdorimi dhe përgjegjësia fizike e së cilës i kaloi subjektit të rivlerësimit një javë mbas nxjerrjes së lejes së qarkullimit, çmohet i nevojshëm, pasi eventualisht, nga kjo situatë faktike duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë pronari *de facto* i këtij aseti, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Zërat e analizës financiare të kryer për personin tjetër të lidhur, z. R. H., duhet të rishikohen dhe rivlerësohen nga ana e Kolegjit, pasi, referuar edhe pretendimeve dhe deklarimeve të subjektit mbi kursimet e deklaruar deri në fund të vitit 2003, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të motrës së tij, znj. I. H., nuk duhen të përfshiheshin në mesin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, z. R. H., për blerjen e pasurisë automjet, tip “Audi”.

B. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe cenimin e besimit të publikut

18. Komisioneri Publik ka çmuar se përfundimi i Komisionit, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm, pasi, bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve apo vlerësim tërësor të çështjes, aplikimi i nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret, nuk është plotësisht i bazuar. Sipas Komisionerit Publik, referuar fakteve dhe rrethanave të prezantuara në dy gjetjet dhe në mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar, duket se në arsyetimin e Komisionit mungon vlerësimi nëse, për rastin konkret, gjen zbatim neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

19. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, në përputhje me arsyetimin në vijim në këtë vendim.

b) Legjitimimi i ankuesit

20. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda

afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

21. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 393, datë 03.06.2021, për subjektin e rivlerësimit Gerd Hoxha, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve, me përjashtim të seancës gjyqësore gjatë së cilës u shpall vendimi, në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ishte i pranishëm, megjithëse ishte njoftuar rregullisht.
22. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në seancën gjyqësore publike të datës 05.04.2022, subjekti i rivlerësimit në vijim të parashtrimeve, kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja që do t'i shërbenin hetimit dhe shqyrtimit të plotë të çështjes. Trupi gjykues, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore⁷ të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

⁷ *Subjekti i rivlerësimit paraqiti:*

- i. kërkesë, datë 25.02.2022, e z. Gerd Hoxha, drejtuar Gjykatës së Apelit, kancelares, znj. L. B., me lëndë: “Kërkesë për marrje aktesh”;
- ii. shkresë nr. {***} prot., datë 28.02.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, drejtuar gjyqtarit Gerd Hoxha, me lëndë: “Përgjigje tuajës, datë 25.03.2022”, bashkëlidhur shkresës “Vërtetim”, datë 25.02.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe 2 (dy) CD audio seancash gjyqësore;
- iii. shkresë nr. {***} prot., datë 25.02.2022, e Gjykatës së Apelit Tiranë, drejtuar z. Gerd Hoxha, me lëndë: “Kthim përgjigje”;
- iv. dosje gjyqësore nr. {***} regjistri themeltar, datë 12.10.2021, vendimi nr. ska, datë 17.11.2021, e gjyqtarit Gerd Hoxha, ku përfshihet edhe procesverbali i seancave gjyqësore të mbajtura në mënyrë të përmbledhur, fashikulli nr. {***}, viti 2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
- v. vendimi nr. {***}, datë 03.03.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- vi. vërtetim nr. {***} prot., datë 24.03.2022, i Gjykatës së Apelit Tiranë;
- vii. vërtetim nr. {***} prot., datë 24.03.2022, i Gjykatës së Apelit Tiranë;
- viii. shkresë nr. {***} prot., datë 07.03.2022, e Gjykatës së Apelit Tiranë, drejtuar z. Gerd Hoxha, me lëndë: “Dërgim fotokopje dosje”;
- ix. dosje gjyqësore nr. {***} regjistri themeltar, datë 07.02.2020, nr. {***} vendimi, datë 27.10.2021;
- x. vendimi nr. {***}, datë 27.10.2021, fashikulli i prokurorit nr. {***}, viti 2018;
- xi. dosja gjyqësore e seancës paraprake me nr. regjistri themeltar {***} datë 28.06.2019, ku ndodhet dhe vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake, datë 05.02.2020;
- xii. dosja gjyqësore nr. {***} regjistri themeltar, datë 07.05.2021, vendimi nr. ska, datë 07.05.2021, me kërkues i pandehuri, z. S. I., me objekt “Përjashtim gjyqtari”;
- xiii. shkresë nr. {***} prot., datë 29.03.2022, e ILD-së, drejtuar z. Gerd Hoxha, me lëndë: “Njoftim mbi vendimin e arkivimit pas shqyrtimit fillestar të rastit të paraqitur nga KPK”;
- xiv. vendimi nr. {***} prot., datë 29.03.2022, i ILD-së “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të rastit të paraqitur nga KPK-ja për magjistratin Gerd Hoxha, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;
- xv. kërkesë nr. {***} prot., datë 30.03.2022, drejtuar Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, me objekt “Marrja urgjente e masës disiplinore ndaj avokates A. M.”, nënshkruar nga avokatë dhe sekretare gjyqësore;
- xvi. procesverbal (Për deklarimin e shtetasit), datë 13.03.2022, i Komisarariatit të Policisë nr. {***};
- xvii. shkresë nr. {***} prot., datë 29.03.2022, e ILD-së, drejtuar z. Gerd Hoxha, me lëndë: “Njoftim mbi vendimin e arkivimit pas shqyrtimit fillestar të rastit të paraqitur nga KPK”;
- xviii. vendimi nr. {***} prot., datë 29.03.2022, i ILD-së “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të rastit të paraqitur nga KPK për magjistratin Gerd Hoxha, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;
- xix. kërkesë nr. {***} prot., datë 30.03.2022, drejtuar Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, me objekt “Marrja urgjente e masës disiplinore ndaj avokates A. M.”; analizë financiare, me kërkues Gerd Hoxha, kryer nga Shoqëria “{***}” ShPK, datë 18.05.2021.

23. Në të njëjtën seancë gjyqësore publike, trupi gjykues, me qëllim shqyrtimin e plotë të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik për kontrollin e pasurisë, me vendim të ndërmjetëm, me shumicë votash, vendosi kryerjen e një analize financiare bazuar në pretendimet e Komisionerit Publik, të përmbajtura në shkaqet e ankimit, për t'i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të paraqiste argumentet e tij për t'u mbrojtur. Në zbatim të vendimit të ndërmjetëm, nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, u hartua *analiza financiare paraprake për subjektin e rivlerësimit, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me të, sipas pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim*, e cila iu përcoll për njohje subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik⁸.
24. Në datën 26.04.2022, vëzhguesi ndërkombëtar, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b” e nenin F, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, depozitoi pranë Kolegjit “Mendim me shkrim”⁹, me anë të të cilit propozonte bashkimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Gerd Hoxha me atë për subjektin e rivlerësimit, znj. E. Ll., ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit dhe gjykimin nga një trup i vetëm gjykues. Sipas “Mendimit me shkrim” të vëzhguesit ndërkombëtar, nëse Kolegji i kryen të veçuara të dyja hetimet, trupi gjykues që gjykon çështjen ndaj subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha, duhet të paraqesë në proces si provë shkresore, dokumentet e nevojshme të disponueshme në dosjen hetimore për subjektin e rivlerësimit, znj. E. Ll., dhe subjekti Gerd Hoxha duhet të vihet qartësisht në dijeni për këtë. Në këtë mënyrë, trupi gjykues i Kolegjit që do të vendosë për subjektin e rivlerësimit Gerd Hoxha do të mund të shqyrtojë si prova, sipas nevojës, aktet e disponueshme në dosjen e subjektit të rivlerësimit, znj. E. Ll.
25. “Mendimi me shkrim” i vëzhguesit ndërkombëtar iu përcoll palëve në gjykim, me qëllim garantimin e së drejtës së tyre për proces të rregullt ligjor, duke iu dhënë mundësinë të njihen dhe të dëgjohen lidhur me të në seancë gjyqësore publike.
Në seancën gjyqësore të datës 06.05.2022, pasi dëgjoji parashtrimet e Komisionerit Publik, i cili e la në tagrin e Kolegjit pranimin ose jo të kërkesës së vëzhguesit ndërkombëtar dhe subjektin e rivlerësimit, i cili kërkoi të mos pranohet kërkesa e sipërcituar, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, në bazë të neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, vendosi vazhdimin e gjyimit dhe marrjen në cilësinë e provës të akteve lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të çështjes së regjistruar në Kolegj me nr. 19/2021 (JR), e cila i përket procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. E. Ll., akte që janë administruar nga Komisioni dhe Kolegji, si dhe aktet që do të administroheshin nga Kolegji deri në përfundim të gjyimit. Subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, respektivisht, u njohën me aktet e sipërcituara.
26. Pas njohjes nga palët në gjykim, me aktet e administruara për kriterin e vlerësimit të pasurisë së çështjes së regjistruar në Kolegj me nr. 19/2021 (JR), e cila i përket procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. E. Ll., në seancën gjyqësore publike të datës 09.06.2022, u debatua analiza financiare paraprake për subjektin e rivlerësimit, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me të, sipas pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi analizën paraprake financiare, duke kërkuar shpalljen e pavlefshme të saj, si dhe ribërjen e analizës paraprake financiare nga Kolegji, duke përfshirë në këtë akt jo vetëm pretendimet e Komisionerit Publik, por edhe pretendimet e tij si subjekt rivlerësimi. Trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi me shumicë votash, të rrëzojë dy kërkesat e sipërcituara të subjektit të rivlerësimit.

⁸ *Analiza financiare paraprake për subjektin e rivlerësimit, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me të, sipas pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim, iu përcoll subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik nëpërmjet shkresës së Kolegjit me nr. {***} prot., datë 20.04.2022.*

⁹ *“Mendim me shkrim”/“Opinion” i vëzhguesit ndërkombëtar me nr. {***} prot., datë 26.04.2022, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 26.04.2022.*

27. Në kuadër të denoncimeve nga publiku të depozituara në Kolegj nga denoncuesit M. S.¹⁰, S. I.¹¹ dhe A. M.¹², vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik, në seancat gjyqësore të datave 05.04.2022 dhe 06.05.2022, nga subjekti i rivlerësimit u paraqitën parashtrime, si dhe aktet shkresore në mbështetje të tyre, të administruara nga Kolegji në cilësinë e provës, duke pretenduar se rrethanat e parashtruara nga denoncuesit janë të pavërteta. Komisioneri Publik, pas parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit mbi denoncimet, depozitoi një qëndrim me shkrim, sipas të cilit denoncimet nuk përmbajnë fakte apo rrethana të tilla që mund të përbëjnë provë në lidhje me kriteret e rivlerësimit. Në seancën gjyqësore të datës 06.05.2022, trupi gjykues, pasi shqyrtoi denoncimet dhe rrethanat e tyre, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos çelë hetimin gjyqësor, pasi denoncimet e depozituara nuk plotësonin kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

28. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit burimet e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 125 m², në Tiranë, duhet të rivlerësohen lidhur me mjaftueshmërinë e tyre, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.

29. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri dhe se subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare për krijimin e saj. Komisioni ka arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në analizën financiare shumën e deklaruar nga subjekti, si të përfituar nga puna e tij me kohë të pjesshme, në sektorin privat, për periudhën 1995-2000, prej 1.500.000 lekësh (duke konsideruar si kursim shumën 1.273.804 lekë), sepse:

- i. kjo shumë është deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2003;*
- ii. kjo shumë është krijuar nga puna e subjektit gjatë kohës që ka qenë student;*
- iii. kjo shumë është krijuar para fillimit të detyrës së subjektit;*
- iv. ISSH-ja nuk disponon asnjë lloj dokumentacioni për subjektin “{***}” ShPK, nuk disponon listëpagesa për subjektin “{***}”, ndërkohë në dosjen që i përket “F.B”, emri i subjektit nuk rezulton;*
- v. bazuar në shkresën e ISSH-së Tiranë, honorarët, pagesat për kontratat e shërbimit, apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, nuk përfshihen në pagën mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore dhe shëndetësore;*
- vi. nga ana e DRT-së Tiranë deklarohet pamundësia për të vërtetuar pagesën e tatimit në burim për shkak të mospasjes së të dhënave të plota dhe mungesës së një sistemi unik informatik;*
- vii. subjekti nuk ka pasur detyrim ligjor të verifikojë pagesën e tatimit në atë periudhë, për aq kohë sa ishte student dhe jo në detyrë;*
- viii. pagesa e tatimit në burim për të ardhurat e përfituar nga puna me kohë të pjesshme është detyrim ligjor i punëdhënësit;*
- ix. subjekti ka bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar informacionin, duke ezauruar në mënyrë shteruese me punëdhënësit dhe institucionet shtetërore, ai ka qenë këmbëngulës në*

¹⁰ Denoncimi i znj. M. S. është regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 21.01.2022.

¹¹ Denoncimi i z. S. I. është përcjellë në Kolegj me shkresë nr. {***} prot., datë 01.03.2022 të Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 01.03.2022.

¹² Denoncimi i znj. A. M. është regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 16.03.2022 dhe me nr. {***} prot., datë 19.04.2022.

kërkimet e tij, duke i provuar këto përpjekje, në përputhje me nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Mosparaqitja e dokumenteve justifikuese për pagesën e detyrimeve tatimore nga subjekti, rezulton se është bërë për shkaqe të arsyeshme;

x. edhe pse nuk ka një dokument shkresor në kohë reale që të vërtetojë këto të ardhura, rezulton se ato janë deklaruar rregullisht në DPV-në e vitit 2003, kur subjekti ka deklaruar kursime cash në shumën 2.500.000 lekë, me burim të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës dhe të ardhura të realizuara në sektorin privat gjatë periudhës 1995-2000 dhe DPV-në e vitit 2004, ku ka deklaruar kursime cash në shumën 1.500.000 lekë, me burim nga paga nga Shkolla e Magjistraturës dhe nga puna në sektorin privat nga viti 1995, akte të cilat, sipas pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë shkresore për efekt të procesit të rivlerësimit;

xi. Komisioni mban në vëmendje edhe faktin se shuma prej 1.273.804 lekësh, e pretenduar si e fituar gjatë periudhës 1995-2000, është një shumë brenda kufijve të arsyes, duke u përpjesëtuar në muaj, rezulton afërsisht 20.000 lekë në muaj, që është e pranueshme si pagë për atë periudhë, për atë lloj pune.

Pas kryerjes së analizës financiare, rezulton se, edhe pa i përfshirë në të ardhura shumën e deklaruar cash në vitin 2003, prej 1.500.000 lekësh, subjekti ka pasur mundësi për blerjen e pjesës takuese të tij në këtë apartament.

30. Komisioneri Publik, në ankim dhe në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi si të pabazuar arsyetimin dhe konkluzionin e Komisionit, me pretendimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë objekt kontrolli. Komisioneri Publik ka ndarë qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, për sa i përket mbulimit me burime të ligjshme të shumës së paguar nga subjekti i rivlerësimit nga kursimet *cash* deri në vitin 2003, ashtu dhe për mundësinë e prindërve të ish-bashkëshortes së subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme huan prej 25.000 eurosh, dhënë ish-bashkëshortes së tij, për të shlyer kredinë bankare, kredi në të cilën vetë subjekti i rivlerësimit ka dalë në cilësinë e dorëzanësit. Këtë shkak të ankimit të tij, Komisioneri Publik e mbështet në pretendimet dhe argumentet e mëposhtme.

30.1 Në deklarin e tij të parë, në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash* në shumën 2.500.000 lekë. Duke pranuar edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se të ardhurat e realizuara nga pagat e tij, prej vitit 1995, administroheshin dhe kurseheshin të gjitha, pasi shpenzimet e jetesës mbuloheshin nga prindërit, nga aktet në dosje rezulton se vetëm për të ardhurat në shumën prej 1.226.026 lekësh, provohet se janë të ardhura që kualifikohen si të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për të ardhurat e pretenduara të fituara nga punësimi në sektorin privat në periudhën 1995-2000, të deklaruara si burim për pagesën e kështit të parë të pasurisë, mbetet i paqartë dhe jo i bazuar vlerësimi i Komisionit mbi pamundësinë reale të subjektit, për të provuar pagesën e tatimit në burim për këto të ardhura. Nga deklaratat noteriale të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe konfirmimet nga organet tatimore, konstatohet në mënyrë të qartë se punëdhënësit për këtë periudhë, konfirmojnë mospagimin e detyrimeve tatimore për z. Gerd Hoxha, fakt ky i konfirmuar edhe nga përgjigjet respektive të institucioneve përgjegjëse. Për pasojë, të ardhurat e deklaruara si të përfituara në periudhën 1995-2000, nga të cilat kanë rrjedhur kursimet në *cash* në shumën 1.500.000 lekë, të deklaruara si burim i pagesës së kështit të parë, provohet se nuk janë paguar detyrimet tatimore, duke mos plotësuar kështu kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme.

30.1.1 Në konkluzionet përfundimtare gjatë gjykimit në Kolegj, Komisioneri Publik parashtrroi se kursimet në *cash* të deklaruara prej subjektit të rivlerësimit deri në fund të vitit 2010, janë të mjaftueshme për pagesën e kështit të parë në shumën 1.500.000 lekë, por mbeten të pambuluara me burime të ligjshme kursimet e deklaruara në deklaratën e vitit 2003, në shumën 2.500.000 lekë, pasi rezultoi se të ardhurat e ligjshme për të cilat është provuar pagesa

e detyrimeve tatimore, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, janë në shumën 1.226.026 lekë.

30.2 Detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimit të huas në shumën 25.000 euro, dhënë nga prindërit e znj. E. Ll. [hua e cila deklarohet nga subjekti i rivlerësimit se ka shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga Emporiki Bank dhe përdorur në funksion të pasurisë apartament në bashkëpronësi të tyre], i takon edhe subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha. Analiza financiare mbi mundësinë e prindërve të znj. E. Ll. për të mbuluar me burime të ligjshme shumën 25.000 euro në vitin 2011, duhej të ishte kryer për periudhën 01.01.2005 e deri në momentin e dhënies së huas, si dhe duke rivlerësuar të gjitha burimet e deklaruara dhe të pretenduara të të ardhurave të prindërve të znj. E. Ll., pasi të ardhurat e znj. Ll. dhe të prindërve të saj, deri në fund të vitit 2004, kanë shërbyer si burim krijimi i shumës së kursimeve në *cash*, të deklaruara prej saj në shumën 5.000.000 lekë. Analiza e kryer nga Komisioni, duke konsideruar shpenzimet e familjes Ll. në minimumin e shpenzimeve sipas ILDKPKI-së, nuk përputhet me deklarinimet.

31. Lidhur me këtë shkak të ankimit, në parashtrimet para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit argumentoi se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve të pasurisë objekt kontrolli, janë të pabazuara. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

31.1 Të ardhurat e deklaruara si të përfituara në periudhën 1995-2000, nga kanë buruar kursimet e deklaruara në deklaratën e interesave të vitit 2003, janë të ardhura të ligjshme, pasi:

a) në dokumentacionin e depozituar dhe të marrë në shqyrtim nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në lidhje me kërkesën e Komisionit për të vendosur në dispozicion dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 2.500.000 lekë, të deklaruara si kursime *cash* në vitin 2003 dhe të shumës 1.500.000 lekë, e përdorur nga ai si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë;

b) detyrimet tatimore nuk janë paguar jo për faj të subjektit të rivlerësimit, sikundër ka ndodhur me shumë shtetas shqiptarë të tjerë. Në kohën kur ka ndodhur kjo situatë, subjekti nuk ka qenë subjekt rivlerësi, por ka qenë një student, që si çdo student tjetër në botë, kërkonte jo vetëm të studionte, por edhe të punonte dhe të kursente për një të ardhme më të mirë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur vëmendjen për të vërtetuar nëse ishin paguar apo jo sigurimet, apo detyrime të tjera nga punëdhënësit. Për më tepër, në këtë punë, ai merrte dhe bakshishe nga klientët, të cilat dhe sot e kësaj dite nuk deklarohen dhe nuk taten, pasi konsiderohen si dhurata. Në situatën e një kamerieri, i cili dihet botërisht që përfiton të ardhura nga bakshishet, si mund ai të vërtetojë ekzistencën e tyre apo pagimin e detyrimeve tatimore, kur një gjë e tillë nuk është e rregulluar me ligj? Në momentin e deklarinimit të parë, 13 vjet përpara se të miratohej ligji nr. 84/2016, subjekti nuk ka pasur asnjë arsye për të deklaruar një shumë që nuk e kishte;

c) subjekti e ka të pamundur të provojë me dokumentacion të kohës marrëdhënien reale të punësimit, pasi kanë kaluar më shumë se 20 vjet nga punësimi i tij, i cili për më tepër ka qenë me kohë të pjesshme, pasi vijonte edhe studimet. Në kushtet në të cilat ndodhet aktualisht, e vetmja mundësi për të provuar punësimin ka qenë prova me deklarinimet noteriale të dëshmitarëve okularë. Për këtë arsye, deklarinatat noteriale të paraqitura prej tij për të provuar marrëdhënien e punësimit, duhet të konsiderohen si prova me fuqi të plotë provuese, në referim të nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit. Përmbajtja e këtyre akteve përputhet plotësisht me shpjegimet e subjektit të paraqitura me shkrim gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore në Komision;

d) nisur nga jurisprudenca e Kolegjit, verifikohen rrethanat e kërkuara për t'i konsideruar të ligjshme të ardhurat e krijuara nga subjekti, në vitet 1995-2000, pasi:

(i) provohet bindshëm ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, me anë të deklaratës së pasurisë të vitit 2003 dhe deklaratave noteriale të lëshuara nga subjektet përkatëse, këto deklarata noteriale nuk janë të vetme por të ndërthurura me prova të tjera;

(ii) vërtetohet bindshëm se këto të ardhura nuk mund të provohen me mjete të tjera, pasi organet kompetente për mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit ligjor, kanë kthyer përgjigje se nuk i disponojnë këto dokumente për shkak të kohës së gjatë dhe mungesës së një sistemi unik elektronik informatizues;

(iii) sjellja e subjektit nuk ka pasur për qëllim të arrijë mospagimin e këtyre detyrimeve, por një pakujdesi apo dhe paqartësi e krijuar nga rrethanat e kohës, kur janë krijuar këto të ardhura, rreth 22-27 vjet përpara.

31.2 Në lidhje me huan në shumën 25.000 euro, dhënë ish-bashkëshortes nga prindërit e saj, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 e 31 të ligjit nr. 84/2016:

31.2.1 Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të deklarojë dhe të provojë ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive dhe të të ardhurave të tij apo të personave të lidhur e të tjerë të lidhur, por nuk ka detyrimin për të deklaruar dhe provuar ligjshmërinë e të ardhurave të prindërve të ish-bashkëshortes së tij, nga të cilët ajo ka marrë hua shumën 25.000 euro.

31.2.2 Pavarësisht argumentimit të vetëm e të pakundërshtueshëm ligjor se subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrimin të justifikojë ligjshmërinë e burimit të shumës 25.000 euro, të marrë hua nga znj. Ll. te prindërit e saj, gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, ai ka paraqitur të gjitha provat dhe faktet, të cilat vërtetojnë katërçipërisht se prindërit e ish-bashkëshortes kanë pasur të ardhura të ligjshme për t'i dhënë asaj shumën prej 25.000 eurosh në formën e huas, duke e bërë shkakun e ankimit të Komisionerit Publik të pabazuar në prova dhe në ligj, pasi:

(i) prindërit e znj. Ll. kishin mundësi të kursenin shumën 25.000 euro, pasi janë ndihmuar nga vajza e tyre, znj. A. Ç., e cila kishte mundësi të jepte këtë shumë si ndihmë mujore për prindërit e saj;

(ii) analiza financiare për mundësinë e prindërve të znj. Ll. për të krijuar kursimet në shumën 25.000 euro, duhet të kryhet nga dita që ata kanë hyrë në punë e deri në datën e dhënies së huas, 02.02.2011, pasi në kundërshtim me sa ka pretenduar Komisioneri Publik, kursimet e prindërve të znj. Ll. nuk kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 5.000.000 lekësh, të deklaruar prej saj si kursim deri në vitin 2004. Por edhe nëse analiza financiare kryhet sipas pretendimit të Komisionerit Publik, për periudhën janar 2004 - shkurt 2011, rezulton se prindërit e znj. Ll. kanë pasur mundësinë të krijojnë shumën prej 25.000 eurosh deri në vitin 2011;

(iii) edhe nëse merret i mirëqenë pretendimi i Komisionerit Publik se ekzistojnë të meta, defekte apo pamjaftueshmëri në deklaratimet vjetore të znj. Ll., ato nuk mund të passjellin caktimin e një mase disiplinore në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, pasi këto janë defekte të konstatuara për pasuri ose burime pasurish të krijuara para martesës së subjektit me znj. Ll., një qëndrim tashmë i konsoliduar ky i jurisprudencës së Kolegjit.

32. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, në shqyrtimin e shkakut të ankimit lidhur me kontrollin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë “apartament me sip. 125 m² në Tiranë”, pasi analizoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe konstatoi faktet dhe rrethanat e shtjelluara në vijim në këtë vendim, konstatoi sa më poshtë.

32.1 Origjina e pasurisë apartament me sipërfaqe 125 m², në Tiranë, regjistruar në ASHK Tiranë me nr. pasurie {***}, zk. {***}, vol. {***}, f. {***}, rrjedh nga kontrata premtim shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.02.2011, dhe kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***}

kol., datë 10.10.2012¹³, të lidhura mes palës shitëse, znj. A. Ç. e z. A. Ç., dhe palës blerëse, z. Gerd Hoxha dhe znj. E. Ll. Sipas parashikimeve kontraktore, vlera e përgjithshme e objektit të kontratës është 6.500.000 lekë, më e ulët se çmimi i tregut për shkak të marrëdhënieve të ngushta gjinore midis palëve kontraktore, e shlyer nga pala blerëse nëpërmjet pagesës së kështit të parë, në shumën 1.500.000 lekë, likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës premtim shitje, më datë 10.02.2011, dhe kështit të dytë, në shumën 5.000.000 lekë, i cili është shlyer nëpërmjet kredisë së marrë nga blerësi, z. Gerd Hoxha, në Bankën Kombëtare Tregtare.

32.2 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar si burime të krijimit të kësaj pasurie: (i) 5.000.000 lekë, kredi pranë Bankës BKT, sipas VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007; (ii) diferenca prej 1.500.000 lekësh është siguruar nga kursimet personale ndër vite; (iii) pjesa prej 50% e znj. E. Ll. është përfituar me dhurim, për shkak të marrëdhënies së posaçme me palën shitëse.

a. *Në lidhje me të ardhurat e deklaruara të përfituara në periudhën 1995-2000*

33. Trupi gjykues konstatoi rrethanat dhe faktet, si vijon.

33.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të ardhura neto të fituara nga puna në sektorin privat dhe vetëpunësim (bare, restorante, lojëra fati, bingo, këmbim valutë, laborant dentar etj.) për periudhën 1995-2000, vlera 1.500.000 lekë.*

33.2 Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, e cila përbën dhe deklarimin e pasurisë për herë të parë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Gjendje cash në shtëpi, në vlerën 2,5 milion lekë, me burim krijimi të ardhura të realizuara nga paga mujore gjatë tri viteve si student në Shkollën e Magjistraturës, Tiranë, për periudhën 2000-2003, dhe të ardhura të realizuara në sektorin privat gjatë periudhës shtator 1995 deri në janar 2000.*

33.3 Në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, në lidhje me shumën 2.500.000 lekë¹⁴, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo shumë përbëhet nga: *Një shumë në total prej rreth 1.226.196 lekësh, përfaqëson të ardhurat neto nga pagesat si student i Shkollës së Magjistraturës, në periudhën tetor 2000 - tetor 2002, në shumën 531.320 lekë dhe të ardhurat neto nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën nëntor 2002 - dhjetor 2003, në shumën 694.876 lekë. Shuma e mbetur e kursimit, prej 1.273.804 lekësh, është kursyer nga të ardhurat e mia të përfituara nga puna me kohë të pjesshme dhe shërbimet e ofruara gjatë kohës që kam qenë student, për një periudhë 5-vjeçare, nga viti 1995 deri në vitin 2000.*

33.4 Në përgjigje të pyetjes së drejtuar nga Komisioni mbi burimin e shumës prej 1.500.000 lekësh¹⁵, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe në parashtrimet gjatë

¹³ Kontratat janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, si dhe janë përcjellë në Komision nga ASHK Tiranë me shkresën nr. {***} prot., datë 07.03.2019, si pjesë e praktikës së regjistrimit të pasurisë.

¹⁴ Komisioni i ka drejtuar subjektit të rivlerësimit një pyetësor më datë 05.02.2021, në adresën e tij të e-mail-it, të cilit subjekti i ka kthyer përgjigje më datë 26.02.2021. Pyetja nr. 5 e këtij pyetësori ishte: “Lutemi të vini në dispozicion dokumentacionin provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave, në shumën 2.500.000 lekë, të deklaruara nga ana juaj si kursime cash në vitin 2003 (të dhëna nga organet tatimore, ISSH etj.)”.

¹⁵ Komisioni i ka drejtuar subjektit të rivlerësimit një pyetësor më datë 06.08.2020, në adresën e tij të e-mail-it, të cilit subjekti i ka kthyer përgjigje më datë 15.09.2020. Pyetja nr. 1 e këtij pyetësori ishte: “Në deklaratën “vetting” keni deklaruar si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë, shumën 1.500.000 lekë nga kursimet personale ndër vite. Lutemi të na sqaroni se kur janë krijuar këto kursime, duke na vënë në dispozicion dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të këtyre kursimeve, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës”.

gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur se: [...] kursimet e mia prej 1.500.000 lekësh, të përdorura për blerjen e një të dytës pjesë të pasurisë apartament me sipërfaqe 125 m², janë kursime nga të ardhurat e mia personale ndër vite. Këto të ardhura përbëhen nga:

a) shuma prej 1.500.000 lekësh, e fituar nga unë gjatë viteve 1995-2000 sipas përshkrimit si më poshtë:

- menaxher shitjesh dhe shpërndarje, gjatë periudhës tetor 1995 – tetor 1997, në shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, me pagë mujore 20.000 lekë, i pasiguruar;

- shitës në shoqërinë “{***}” ShPK, gjatë periudhës janar 1998 – dhjetor 1998, me pagë mujore 12.000 lekë në muaj, plus të ardhura nga bakshishet, jo më pak se 1.000 lekë në ditë, që për nga vetë natyra e punës, nuk përfshiheshin në pagë;

- kamerier në bar-kafe “{***}”, nga muaji janar 1999 deri në muajin maj të vitit 2000, me pagesë 12.000 lekë në muaj, ndërsa bakshishet kanë qenë përgjithësisht jo më pak se 1.000 lekë në ditë, të cilat për nga vetë natyra e tyre, por edhe sipas një rregulloreje të lokalit, nuk përfshiheshin në pagë dhe i takonin kamerierit;

b) të ardhura neto si student i Shkollës së Magjistraturës në periudhën tetor 2000 – tetor 2002, në shumën 531.320 lekë;

c) të ardhura neto nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën nëntor 2002 - shkurt 2011, në shumën 7.200.002 lekë;

d) shpërblime si ekspert i Shkollës së Magjistraturës, për periudhën 2007-2010, në shumën 113.386 lekë;

e) të ardhura neto të përfituara nga paga si pedagog i jashtëm në Universitetin jopublik {***}, Tiranë, për periudhën janar 2004 - shkurt 2008, në shumën 392.940 lekë;

f) të ardhura neto të përfituara nga shpërblime si ekspert i OSBE-së për periudhën 22.09.2009 - 30.01.2010, në shumën 2.100 euro.

Duke pasur parasysh që konform ligjit të zbatueshëm në periudhën kohore 1995-1999, regjistrimet dhe pagesat përkatëse të kontributeve shoqërore/shëndetësore (nëse do të aplikoheshin) dhe tatimit në burim, kur dhe ashtu siç mund të aplikohen, kanë qenë përgjegjësi e subjekteve tregtare, unë kam kërkuar zyrtarisht nga institucionet përkatëse (Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë) dokumentacion në lidhje me çdo pagesë sigurimesh shoqërore/shëndetësore dhe tatime në burim/të ardhura, dhe këto institucione kanë dështuar të gjejnë dhe sigurojnë dëshmi të pagesave të kryera nga subjektet tregtare, kryesisht për shkak të periudhës mjaft të hershme kohore, dhe mungesës së sistemeve të informatizimit në atë kohë. [...] Të ardhurat e mia gjatë periudhës 1995-1999, janë të ardhura që vijnë nga ofrimi i shërbimeve me kohë të pjesshme gjatë kohës që unë isha student në Fakultetin e Drejtësisë, çka është lehtësisht e verifikueshme. Gjatë kësaj periudhe, për shkak të angazhimit universitar, unë nuk mund të mund të punësohesha me kohë të plotë. Si rregull dhe në përputhje me ligjin e aplikueshëm të kohës, shërbimeve të mia në atë kohë nuk u aplikoheshin pagesa të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, pavarësisht se çdo detyrim për pagesa të tilla në fakt do të ishte detyrim i subjektit tregtar dhe jo i imi. Çdo tatim i aplikueshëm në burim apo të ardhura në atë kohë gjithashtu do të ishte vetëm detyrim ligjor i subjektit tregtar. Sidoqoftë, për të qenë maksimalisht bashkëpunues në këtë proces, unë vendosa të shteroj të gjitha dhe çdo mundësi për të provuar në mirëbesim të ardhurat e mia. Aktualisht, pavarësisht përpjekjeve të mia maksimale për të siguruar informacion dhe dokumentacion provues shtesë nga organet kompetente të ngarkuara nga ligji, pavarësisht se detyrimi për pagesa dhe evidencat në lidhje me to, bie mbi subjektet tregtare, dhe duke pasur parasysh që tashmë këto organe nuk janë në gjendje kryesisht për shkak të kohës mjaft të largët dhe mungesës së informatizimit, të identifikojnë këto dokumente, dhe për sa kohë sa më sipër është tërësisht jashtë kontrollit tim,

unë gjendem qartësisht në kushtet e parashikuara në paragrafin 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Ndërkohë, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, duke pasur parasysh që këto interesa private të mia që datojnë 22-26 vite më parë, është fakt që ato janë deklaruar prej meje në mënyrë të rregullt dhe transparente menjëherë që në momentin e deklarimit të parë periodik në ILDKPKI, pothuaj 18 vite më parë, në mënyrë të arsyeshme, ky fakt duhet të përdoret si provë konform nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Të ardhurat si më sipër, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar në mënyrë të njëjtë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

33.5 Për të provuar pretendimet e tij si më sipër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar gjatë hetimit administrativ:

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.07.2018, lëshuar nga znj. G. Xh., e cila deklaron se: *Duke filluar nga viti 1994, familja ka pasur në pronësi shoqëritë private “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, të cilat ushtronin aktivitet privat në fushën e përpunimit të drithërave [...]. Gjatë periudhës tetor 1995 - tetor 1997, z. Gerd Hoxha [...] ka qenë i punësuar në këto shoqëri i pasiguruar, me detyrë menaxhimin e shpërndarjes dhe shitjes së produkteve tona [...], me pagë 20.000 lekë/muaj”.*

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.07.2018, lëshuar nga z. P. A., i cili deklaron se: *Në periudhën janar 1998 - dhjetor 1998, z. Gerd Hoxha [...] ka qenë punonjës si dhe unë (shitës) në bingon “{***}”. Paga mujore e jona ka qenë 12.000 lekë, ndërsa të ardhurat nga bakshishet kanë qenë jo më pak se 1.000 lekë në ditë.*

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt.14.08.2020, lëshuar nga z. V. Ç., i cili deklaron se: *Nga viti 1998 e në vazhdim, kam qenë administrator dhe ortak i shoqërisë “{***}”. Kjo shoqëri kishte si pjesë të aktivitetit të saj edhe “{***}”, me seli në bulevardin “{***}”, godina e gazetës “{***}”, Tiranë. Në këtë bingo, ka qenë punonjës z. Gerd Hoxha, [...] për periudhën janar 1998 - dhjetor 1998, si shitës. Paga mujore e shitësve ka qenë 12.000 lekë në muaj neto, ndërsa të ardhurat nga bakshishet kanë qenë jo më pak se 1.000 lekë në ditë. [...] për z. Gerd Hoxha nuk janë paguar sigurimet shoqërore dhe detyrimet tatimore për të ardhurat, fakt për të cilin z. Hoxha nuk ka qenë në dijeni.*

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.06.2018, lëshuar nga z. H. H., i cili deklaron se: *[...] kam pasur në pronësi bar-kafe “{***}” në Tiranë, në buzë të Lanës, përballë me lulishten “{***}”. Ky lokal është hapur në vitin 1994 dhe ka ekzistuar deri në vitin 2004. Në këtë lokal, nga muaji janar 1999 - maj 2000, ka punuar si kamerier (i pasiguruar në ISSH) z. Gerd Hoxha. Paga e tij mujore ka qenë 12.000 lekë. Kjo pagë nuk përfshinte pjesën e bakshisheve prej rreth 1.000 lekë në ditë, e cila i mbetej kamerierit.*

- Vërtetim nr. {***} prot., datë 15.06.2020, i Degës Rajonale të Arkivit të ISSH-së Tiranë, sipas të cilit rezulton se: *Nga verifikimi i bërë në DAQ, emri i subjektit nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë “{***}”.*

- Vërtetim nr. {***} prot., datë 15.06.2020, i Degës Rajonale të Arkivit të ISSH-së Tiranë, sipas të cilit rezulton se: *Për subjektin juridik “{***}” ShPK, për periudhën 01.10.1995 -30.10.1997, nuk administrojnë listëpagesa deri tani. Në dosjen {***}, listëpagesat fillojnë në janar të vitit 1998.”*

- Shkresë, me lëndë “Kthim përgjigje”, e ISSH-së, Drejtoria Rajonale Tiranë, me nr. {***} prot., datë 12.02.2021, sipas së cilës: *Mbështetur në VKM-në nr. 452, datë 16.09.1993, VKM-në nr. 42, datë 23.1.1995, VKM-në nr. 73, datë 30.1.1998, pika IV, “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”. Pika IV, “Në zbatim të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërisë”, të neneve 8, 9 dhe 11 të ligjit 7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, punëdhënësi detyrohet të paguajë dhe të paraqesë çdo muaj në agjencitë e sigurimeve shoqërore të rrethit*

listën emërore, pagën mujore, pagën mbi të cilën është derdhur kontributi dhe masën e kontributit të derdhur për çdo të punësuar. Honorarët, pagesat për kontratat e shërbimit apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre nuk përfshihen në pagën mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore dhe shëndetësore.

• Shkresë e DRT Tiranë nr. {***} prot., datë 20.05.2021, me lëndë kthim përgjigje, sipas së cilës: [...] *Nga të dhënat që disponohen në regjistrat e llogarive të tatimeve të tjera, si dhe nga verifikimet e kryera në bazë të të dhënave banka, llogari të tjera, e administruar nga DRT-ja Tiranë, e mbajtur jashtë sistemit informatik elektronik deri në periudhën 31.12.2014, për periudhën tetor 1995 - tetor 1997, për shoqërinë “{***}”, me NIPT {***}; për periudhën janar 1998 - dhjetor 1998, për shoqërinë “{***}”, me NIPT {***}; për periudhën janar 1999 - maj 2000, për shoqërinë “{***}”, kemi pamundësi të vërtetojmë pagesën e tatimit në burim për periudhat e sipërcituara, për shkak të mospasjes së të dhënave të plota dhe mungesës së një sistemi unik informatik për këtë periudhë.*

34. Në referim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm jo vetëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruar, por edhe të të ardhurave. Nën dritën e këtij parashikimi kushtetues, si dhe vlerësimit të Kolegjit në jurisprudencën e konsoliduar prej tij¹⁶, për raste të ngjashme, se standardi i vendosur nga kjo dispozitë, për përcaktimin e ligjshmërisë së të ardhurave kërkon që ato të jenë krijuar nga burime të ligjshme, të jenë deklaruar dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse, si dhe në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues vlerësoi si vijon.

Në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vëren se në kushtet e mungesës së ekzistencës së një kontrate pune, apo një akti të ngjashëm me të që formalizonte marrëdhënien e punës, të hartuar në kohën e krijimit të marrëdhënies së punës së subjektit të rivlerësimit, deklaratat noteriale të punëdhënësve të tij për periudhën e pretenduar, përmbajnë indicie lidhur me faktin e kryerjes prej subjektit të një veprimtarie si shitës në lojërat e fatit apo kamerier dhe përfitimit prej tij të të ardhurave në këmbim të kësaj veprimtarie, por ato nuk mund të përbëjnë prova të plota e të mjaftueshme, të tilla që të mos vënë në diskutim ekzistencën e burimit të ligjshëm të të ardhurave të pretenduara. Edhe pse këto akte japin indicie për ekzistencën e një veprimtarie të subjektit të rivlerësimit me këto subjekte tregtare, si dhe besueshmërinë për ofrimin prej tij të një pune apo shërbimi pranë tyre, ato nuk provojnë ekzistencën e elementeve të detyrueshme të një marrëdhënieje punësimi¹⁷, sipas nenit 12 të Kodit të Punës dhe rekomandimit nr. 198 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, “Për marrëdhëniet e punësimit”.

34.1 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjatë hetimit administrativ në Komision se ka qenë i punësuar me kohë të pjesshme pranë subjekteve tregtare përkatëse dhe, për këtë arsye, nuk janë paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga punëdhënësit, në zbatim të legjislacionit të kohës për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ashtu siç edhe ka konfirmuar në përgjigjen e dhënë ISSH-ja, si autoriteti shtetëror përkatës. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se pagimi i detyrimeve tatimore ka qenë detyrim i punëdhënësit dhe jo i tij, pretendim ky i pranuar nga Komisioni. Në analizë të këtij pretendimi, duke pranuar interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit për sigurimet shoqërore nga institucioni shtetëror përgjegjës, se: “Honoraret, pagesat për kontratat e shërbimit apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre nuk përfshihen në pagën mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore dhe shëndetësore”, trupi gjykues vëren se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe i administruar nga Komisioni, i cili konsiston në deklaratat noteriale të punëdhënësve të subjektit të rivlerësimit, nuk qartëson natyrën e marrëdhënieve juridike të krijuara mes subjekteve tregtare dhe subjektit të

¹⁶ Vendimet e Kolegjit nr. 23/2020 (JR); nr. 6/2019 (JR); nr. 07/2019 (JR); nr. 19/2019 (JR) etj.

¹⁷ Elementi më i rëndësishëm është përcaktimi i shpërblimit/pagës për punën/shërbimit dhe përfitimi i tij.

rivlerësimit, në raport me punën e ofruar prej këtij të fundit, për sa kohë në asnjë prej këtyre akteve nuk gjenden gjurmë për punësim me kohë të pjesshme të subjektit të rivlerësimit. Punëdhënësit përkatës shprehen qartë se z. Gerd Hoxha ka qenë i pasiguruar, ndërsa në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, përfaqësuesi i shoqërisë “{***}” është shprehur se detyrimet tatimore nuk janë paguar dhe z. Hoxha nuk ka pasur dijeni për këtë fakt. Në këto kushte, në mungesë të një dokumentacioni, apo qoftë dhe indicieje që përcakton llojin e marrëdhënies juridike [nëse subjekti është punësuar me kohë të plotë, me kohë të pjesshme etj.], që ka ekzistuar mes palëve punëdhënëse dhe subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e punëmarrësit, në të cilën të përcaktoheshin edhe të drejtat dhe detyrimet reciproke të tyre, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit që ai ka qenë i punësuar me kohë të pjesshme dhe se detyrimi për të paguar detyrimet ndaj organeve tatimore ka qenë i subjekteve përkatëse tregtare, nuk mund të provohet.

34.2 Bazuar në situatën e referuar nga administrata tatimore se është në pamundësi të vërtetojë pagesën e tatimit në burim për periudhat e punësimit të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, për shkak të mospasjes së të dhënave të plota dhe mungesës së një sistemi unik informatik për këtë periudhë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se z. V. Ç., administrator i shoqërisë “{***}”, në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 14.08.2020, ka deklaruar se detyrimet tatimore nuk janë paguar nga shoqëria “{***}” për periudhën e punësimit të subjektit të rivlerësimit. Për sa u përket subjekteve të tjera tregtare, “{***}” SHPK dhe bar-kafe “{***}”, rezulton se në deklaratat përkatëse noteriale, përfaqësuesit e tyre nuk janë shprehur nëse janë kryer ose jo pagesat e detyrimeve tatimore, por kanë deklaruar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një marrëdhënie pune dhe është paguar me pagë mujore.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së përgjigjes që DRT Tiranë i ka kthyer subjektit të rivlerësimit me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 20.05.2021, trupi gjykues vëren se institucioni përgjegjës është shprehur se, *për shkak të mospasjes së të dhënave të plota dhe mungesës së një sistemi unik informatik për këtë periudhë, për periudhat e sipërcituara, është në pamundësi të vërtetojmë pagesën e tatimit në burim*, bazuar në kërkesën e subjektit për ta informuar për pagesat e bëra në emër të tij vetëm për këtë lloj tatimi. Sipas ligjit të kohës nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, i cili kishte si objekt rregullimi marrëdhëniet që lindnin në fushën e tatimeve mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin, si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave [neni 1], të ardhurat nga një burim, por pa u kufizuar vetëm në to, përfshinin të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë [neni 4, shkronja “a”], ndërsa për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, konsideroheshin si të ardhura të tatueshme pagat dhe shpërblimet e tjera, të lidhura me marrëdhëniet aktuale të punës [neni 8, shkronja “a”]. Tatimi në burim, si një nga llojet e tatimit mbi të ardhurat personale, vendosej mbi kategoritë e tjera të të ardhurave të tatueshme, si shpërblime për shërbime individuale dhe të ardhurat nga qiratë e banesave [neni 2]. Parashikime të njëjta përmbante edhe ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, si ligji vijues që ka shfuqizuar ligjin e sipërcituar. Në analizë të këtyre parashikimeve, të cilat përbëjnë bazë ligjore për tatimin mbi të ardhurat në periudhën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, tetor 1995 - maj 2000, në raport me rrethanat konkrete objekt shqyrtimi të pasqyruara më sipër, trupi gjykues vlerësoi se nuk ka të dhëna të mjaftueshme, të cilat të provojnë se marrëdhënia e punës së subjektit të rivlerësimit të ishte e tillë që ta vendoste atë në detyrimin e pagimit të tatimit në burim. Për pasojë, pamundësia e administratës tatimore për të vërtetuar pagimin e një tatimi të tillë, nuk i shërben zgjidhjes së rastit konkret, pasi nuk e vendos subjektin në kushtet e parashikimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

35. Në përmbledhje të arsytimit të mësipërm, në vlerësim të trupit gjykues, edhe pse provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit hedhin dritë mbi indicie të ekzistencës së një marrëdhënieje pune, si dhe besueshmërinë për ofrimin prej tij të një pune apo shërbimi pranë tyre, ato nuk arritën të provojnë ekzistencën e elementeve të detyrueshme të saj – përfitimin periodik të shpërblimit të punës (pagës), si dhe pagesën e detyrimeve tatimore për këtë shpërblim, ndaj në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, në vlerën prej 1.500.000 lekësh, si të përfituara nga puna në sektorin privat në periudhën 1995-2000, nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, për t'u konsideruar të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi.

b. Në lidhje me huan në shumën 25.000 euro, dhënë ish-bashkëshortes nga prindërit e saj

36. Trupi gjykues, nga aktet e administruara, konstatoi rrethanat dhe faktet si vijojnë.

36.1 Komisioni, në vendim, lidhur me huan në shumën 25.000 euro, ka arsytuar se, *referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor për vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, vlerëson se detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të huas, në shumën 25.000 euro, e ka pasur ish-bashkëshortja e subjektit, e cila është gjykuar nga një trup tjetër gjykues, në kuadër të një hetimi të pavarur dhe të paanshëm.*

36.2 Huan në shumën 25.000 euro, dhënë ish-bashkëshortes, znj. E. Ll., nga prindërit e saj, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke përshkruar se kjo hua e marrë në vitin 2011, pa interes dhe pa afat, si dhe pa kontratë për shkak të marrëdhënieve të posaçme mes palëve, shërbeu për shlyerjen e kredisë së marrë nga znj. Ll., më datë 02.04.2009, në Emporiki Bank, kredi e cila u shlye tërësisht më datë 02.02.2011.

Ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, me anë të kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2009¹⁸, ka marrë hua nga Banka Emporiki shumën prej 25.000 eurosh, e cila do të përdorej për rikonstruksionin e apartamentit me sipërfaqe 125 m², në Tiranë¹⁹. Kontrata e kredisë është nënshkruar edhe nga z. Gerd Hoxha dhe znj. A. Ç., në cilësinë e dorëzanësve. Si mjet sigurimi për të garantuar shlyerjen e kredisë, është lidhur kontrata e hipotekës nr. 1673 rep., nr. 684 kol., datë 26.03.2009, me anë të së cilës znj. A. Ç. dhe z. A. Ç. kanë vënë në hipotekë në favor të Bankës Emporiki, apartamentin me sipërfaqe 125 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, në pronësi të tyre, apartamenti për rikonstruksionin e të cilit ishte lidhur kontrata e kredisë bankare mes znj. Ll. dhe bankës në fjalë.

Sipas të dhënave bankare për pagesat e kësteve mujore të kredisë bankare, subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës 2009 - 2010, ka paguar disa këste për shlyerjen e saj, në llogarinë e kredisë në emër të znj. E. Ll.. Kredia është shlyer tërësisht në datën 02.02.2011, nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 24.500 euro, nga znj. A. Ç., motra e ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

36.3 Gjatë gjykimit në Kolegj, por edhe në deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ në Komision²⁰, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *Bazuar në kontratën e huas, shuma prej 25.000 eurosh është marrë hua vetëm nga ish-bashkëshortja ime dhe jo nga unë, nga Emporiki Bank Tiranë, me qëllim rikonstruksionin dhe arredimin e apartamentit në Tiranë, i cili u ble më pas nga unë dhe ish-bashkëshortja. Në këtë kontratë, unë kam qenë në cilësinë e dorëzanësit. Theksoj se, në atë kohë, unë dhe znj. E. Ll. nuk kishim filluar ende bashkëjetesën*

¹⁸ Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Abi Bank (ish-Emporiki Bank), me shkresën nr. {***} prot., datë 25.02.2019.

¹⁹ Sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 14 të kontratës së kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2009.

²⁰ Në përgjigjet e pyetësorit të dërguara nga subjekti i rivlerësimit në Komision, më datë 15.09.2020.

dhe nuk kishim lidhur ende martesë ligjore, e cila u lidh më datë 09.07.2012. [...] Me qëllim për t'i kursyer kohën dhe për lehtësi veprimi, nisur nga marrëdhënia (të fejuar, në prag të bashkëjetesës) që ekzistonte mes nesh, në atë kohë edhe unë kam ndihmuar znj. E. Ll. në depozitim të shumave të kësteve të kredisë në Emporiki Bank, të dhëna nga znj. E. Ll., për llogari të shlyerjes së kredisë të marrë nga kjo e fundit. [...] Në dijeninë time, deri në periudhën që kam qenë i martuar dhe bashkëjetesë me znj. E. Ll., kjo hua vijonte ende të ishte e pashlyer nga ana e saj. Huaja vijonte të ishte e pashlyer edhe në momentin e plotësimit të pyetësorit nr. 1, drejtuar znj. E. Ll. nga Komisioni, dhe është pasqyruar edhe në deklaratën e datës 25.01.2017, pranë ILDKPKI-së. Aktualisht nuk kam asnjë dijeni nëse kjo hua është shlyer ose jo nga znj. E. Ll.. Ndërkohë që kjo shumë i është dhënë në formën e huas pa interes dhe pa afat, sikundër është pasqyruar nga unë dhe ish-bashkëshortja në të gjitha deklaratat vjetore të interesave pasurorë të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, si dhe në deklaratën e vetting-ut, dorëzuar më datë 25.01.2017. Për pasojë, nuk ka asnjë lidhje ligjore mes meje dhe kësaj huaje. Rrjedhimisht, në bazë të ligjit nr. 84/2016, prindërit e ish-bashkëshortes sime, që në atë kohë ende nuk kishte filluar bashkëjetesën me mua dhe as nuk kishte lidhur martesë, nuk konsiderohen persona të lidhur dhe as persona të tjerë të lidhur.

37. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, në raport me argumentet e Komisionerit Publik se detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të huas në shumën 25.000 euro e ka pasur edhe subjekti i rivlerësimit, si dhe prapësimet e këtij të fundit, trupi gjykues vlerësoi si vijon.

37.1 Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit dhe znj. E. Ll. kanë qenë në posedim të apartamentit me sipërfaqe 125 m² në Tiranë e, njëkohësisht, në marrëdhënie interesi, kohë më parë nga momenti i deklarimit të fitimit të pronësisë së tij e, për këto arsye, detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimit të huas në shumën 25.000 euro i përket edhe subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik këtë pretendim e mbështet vetëm në faktin se huaja është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit se ka shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga ish-bashkëshortja në Emporiki Bank, e cila është përdorur në funksion të pasurisë apartament në bashkëpronësi të tij dhe të ish-bashkëshortes, si dhe faktit se subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e dorëzuesit në këtë kredi.

37.1.1 Trupi gjykues vëren se sipas parashikimeve të Kodit Civil në nenet 304, 305 dhe 309 të tij, *posedimi fitohet me anë veprimesh juridike, me trashëgim dhe me pushtim. Posedimi është i ligjshëm kur poseduesi e ka posedimin nga pronari, në bazë të një veprimi juridik, në bazë të ligjit ose të një akti administrativ.* Në kuptim të dispozitave të sipërcituara, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja e tij kanë fituar posedimin ligjor të apartamentit me sipërfaqe 125 m² në Tiranë, nëpërmjet kontratës premtim shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.02.2011, ndërsa pronësinë mbi këtë apartament, me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.10.2012.

37.1.2 Gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në apartamentin objekt kontrolli, ai dhe znj. Ll. kanë filluar të jetojnë në fillim të vitit 2011, deklarim që përkon me datën e lidhjes së kontratës premtim shitjeje për këtë pasuri. Nga verifikimi i deklaratave periodike të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes së tij, rezulton se ata kanë deklaruar si adresë banimi, adresën e pasurisë në fjalë, duke filluar nga deklarimi periodik i vitit 2011, çka përputhet me deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, mbi momentin e fillimit të jetesës në këtë apartament.

37.1.3 Vetëm fakti i marrjes së kredisë për rikonstruksionin e këtij apartamenti nga ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, nuk mund të çojë në përfundimin se subjekti i

rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja e tij kanë poseduar pasurinë, në përputhje me kuptimin ligjor që i jep posedimit neni 304 i Kodit Civil, sipas të cilit: *Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë*. Në këtë analizë, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin e provuar se pasuria apartament me sipërfaqe 125 m², që nga data 26.03.2009 [data e lidhjes së kontratës së huas bankare nga znj. E. Ll.], është vënë në hipotekë e, për pasojë, hipotekuesit, z. A. dhe znj. A. Ç., pronarët e atëhershëm të pasurisë, sipas pikës 3.1 të kontratës së hipotekës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2009, kanë qenë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim juridik me këtë pasuri.

37.1.4 Marrja e kredisë bankare nga znj. Ll., për të rikonstruktuar një apartament të cilin nuk e posedonte ende, justifikohet nga marrëdhënia e ngushtë familjare mes saj dhe pronarëve të apartamentit në fjalë – bashkëshortëve Ç.²¹, të cilët i kishin premtuar nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.02.2009 [deklarata pjesë e dosjes së kredisë bankare, por e hartuar në kohë, para marrjes së saj], se në të ardhmen këtë pasuri do t’ia kalonin në pronësi asaj dhe z. Gerd Hoxha, me anë të një veprimi juridik të mëvonshëm për kalim pronësie. Vullneti i bashkëshortëve Ç., i shprehur në këtë deklaratë noteriale të hartuar përpara marrjes së kredisë, i parë në harmoni me marrëdhëniet e ngushta familjare që ekzistonin mes tyre dhe ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, i kishin krijuar znj. Ll. sigurinë që do ta dispononte e zotëronte apartamentin në një kohë të mëvonshme, duke justifikuar qëllimin për të investuar në të. Trupi gjykues krijon bindjen mbi vërtetësinë e fakteve të deklaruara në deklaratën noteriale të sipërcituar, pasi është një akt i hartuar jo gjatë dhe për efekt të provimit të fakteve në procesin e rivlerësimit, por edhe se faktet e deklaruara janë vërtetuar më pas me lidhjen e kontratës së premtimit të shitjes dhe kontratës së shitblerjes së apartamentit me sipërfaqe 125 m² në Tiranë, mes bashkëshortëve Ç. dhe znj. Ll. e z. Gerd Hoxha.

37.1.5 Trupi gjykues vëren gjithashtu se pjesë e dosjes së kredisë bankare është edhe akti “Raport vlerësimi për pronën apartament me sipërfaqe 125 m², rruga “{***}”, Tiranë”, i hartuar për vlerësimin e pronës për efekt të kredisë bankare, hartuar më datë 26.02.2009, i cili konfirmon se në apartament po bëheshin punime rikonstruksioni, madje raporti shoqërohet edhe me foto të pronës, e cila shfaqet në kushte të pabanueshme, për shkak të rikonstruksionit që kishte filluar të kryhej në të.

37.1.6 Për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se marrëdhënia e posedimit të subjektit të rivlerësimit me pasurinë apartament me sipërfaqe 125 m², në Tiranë, nuk ka filluar kohë më parë nga momenti i deklarimit të posedimit ligjor të tij.

37.2 Në analizë të argumentit tjetër të Komisionerit Publik, se subjekti i rivlerësimit dhe znj. E. Ll. kanë qenë në marrëdhënie interesi, kohë më parë nga momenti i deklarimit të fitimit të pronësisë së apartamentit 125 m², pasi subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e dorëzanësit në kredinë e marrë prej saj, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se z. Gerd Hoxha ka deklaruar se ka filluar bashkëjetesën me znj. Ll. në fillim të vitit 2011, kohë që përkon me mbarimin e punimeve të rikonstruksionit të apartamentit me sipërfaqe 125 m² dhe me lidhjen e kontratës premtim shitjeje për këtë pasuri mes tyre dhe bashkëshortëve Ç., më datë 10.02.2011.

37.2.1 Për shkak të lidhjes së kontratës së kredisë bankare mes znj. Ll. dhe Emporiki Bank, më datë 26.03.2009, subjekti i rivlerësimit është bërë dorëzanës, cilësi e cila ka përfunduar në datë 02.02.2011, kur znj. Ll. ka shlyer tërësisht kredinë e marrë, në shumën 25.000 euro. Cilësia e subjektit të rivlerësimit si dorëzanës i kredisë bankare, ka përfunduar më parë në kohë nga fillimi i posedimit prej tij të pasurisë apartament me sipërfaqe 125 m².

²¹ Znj. A. Ç. është motra e znj. E. Ll..

Trupi gjykues vlerëson se fakti që subjekti i rivlerësimit ka qenë dorëzanës në kredinë e marrë nga znj. Ll., nuk e vendos atë në kushtet e detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve të shlyerjes së kësaj kredie, pasi marrëdhënia juridike e dorëzansisë, ndonëse përfaqëson interesa pasurorë, nuk hyn në rrethin e marrëdhënieve të cilësuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të cilat vendosin detyrimin e subjektit të rivlerësimit për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive, qëndrim ky i mbajtur tashmë në jurisprudencën e Kolegjit²². Përveç këtij konkluzioni, rrjedhje e interpretimit të dispozitës, trupi gjykues mbajti në konsideratë dhe faktin se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e dorëzanësit, e ka ushtruar këtë rol në kuptimin formal të tij, në kushtet kur nuk ka qenë e nevojshme që ai të luajë rol efektiv në shlyerjen e kredisë me burimet e tij financiare, pasi këstet e kredisë dhe më pas e gjithë vlera e saj është shlyer nga kredimarrësja znj. Ll.. Edhe pse nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se disa këste për shlyerjen e kësaj kredie janë derdhur në llogarinë bankare të znj. Ll. nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë konstatim, dhënë gjatë hetimit të kryer nga Komisioni²³, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj, se shumata e derdhura buronin nga të ardhurat e znj. Ll., ndërsa ai ka kryer thjesht depozitimin e tyre në bankë, për shkak të marrëdhënies *mes tyre, si të fejuar, në prag të bashkëjetesës* që ekzistonte mes tyre.

37.2.2 Huaja bankare e disbursuar është tërhequr tërësisht nga znj. Ll. më datë 06.04.2009 dhe është përdorur për kryerjen e punimeve të rikonstruksionit dhe arredimin e apartamentit me sipërfaqe 125 m², i cili, më pas, në shkurt 2011, ka kaluar në posedimin ligjor dhe faktik të saj dhe subjektit të rivlerësimit. Për shlyerjen e kredisë bankare përpara afatit kontraktor, znj. Ll. ka deklaruar se ka shërbyer huaja në shumën 25.000 euro, dhënë pa interes dhe pa afat nga prindërit e saj.

37.2.3 Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave të subjektit të rivlerësimit dhe të znj. Ll., si dhe nga verifikimi i deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, rezulton se kjo hua, në shumën 25.000 euro, nuk ka qenë shlyer, as pjesërisht [nuk ka asnjë deklaram për shlyerje të ndonjë pjese të huas] në kohën kur subjekti i rivlerësimit dhe znj. Ll. kanë filluar bashkëjetesën në vitin 2011, as në kohën e lidhjes së martesës në vitin 2012, as gjatë kohës së ekzistencës së marrëdhënies martesore e as në vitin 2016 dhe deri në datën e plotësimit të deklaratës së rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, se në dijeninë e tij, deri në periudhën që ka qenë i martuar dhe bashkëjetonte me znj. E. Ll., kjo hua vijonte ende të ishte e pashlyer nga ana e saj²⁴.

37.2.4 Në analizë dhe interpretim harmonik të rrethanave faktike si më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se si burim financiar për rikonstruksionin dhe arredimin e apartamentit me sipërfaqe 125 m², ka shërbyer kredia bankare në shumën 25.000 euro, marrë në Emporiki Bank nga ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Huaja e marrë nga ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit te prindërit e saj, ka shërbyer vetëm për shlyerjen e kësaj kredie dhe jo si burim krijimi për rikonstruksionin dhe arredimin e apartamentit me sipërfaqe 125 m². Kjo logjikë arsyetimi e bazuar në rrethanat faktike të pasqyruara më sipër, gjen mbështetje edhe në deklaramin e huas nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, vetëm në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” dhe jo në burimet e krijimit të pasurisë objekt kontrolli.

²² Vendimi i Kolegjit nr. 22/2022(JR), datë 22.06.2022, paragrafi 13.11.

²³ Sipas deklaramëve të përcjella në Komision nga subjekti i rivlerësimit, më datë 15.09.2020, në të cilat ka deklaruar se: “me qëllim për t’i kursyer kohën dhe për lehtësi veprimi, nisur nga marrëdhënia (të fejuar, në prag të bashkëjetesës) që ekzistonte mes nesh në atë kohë, edhe unë kam ndihmuar znj. E. Ll. në depozitimin e shumave të kësteve të kredisë në Emporiki Bank, të dhëna nga znj.E. Ll., për llogari të shlyerjes së kredisë së marrë nga kjo e fundit”.

²⁴ Subjekti i rivlerësimit ka zgjidhur martesën me znj. Ll. në prill 2019.

38. Në vijim, trupi gjykues vlerësoi se tërësia e rrethanave të analizuarra më sipër, tregojnë se huaja në shumën 25.000 euro nuk provohet se mund t'i atribuohet subjektit të rivlerësimit e, për pasojë, të shoqërohet me detyrimin e tij për të shpjeguar e vërtetuar ligjshmërinë e krijimit të saj, në raport me parashikimin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

Ky konkluzion është rrjedhojë, nga njëra anë, e analizës së parashikimit të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij apo të personave të lidhur me të dhe, nga ana tjetër, rrethanat faktike të provuara më sipër se më datë 02.02.2011, datë në të cilën znj. Ll. ka shlyer kredinë bankare nëpërmjet huas së marrë prindërve të saj, subjekti dhe znj. Ll. nuk ishin në marrëdhënie bashkëjetese dhe nuk kanë pasur posedimin efektiv dhe as ndonjë të drejtë reale mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 125 m², se subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë kontribut në marrëdhënien e huas mes znj. Ll. dhe prindërve të saj, si dhe në kushtet kur huaja e sipërcituar nuk ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli [dhe as të ndonjë pasurie tjetër të krijuar në vijim nga subjekti i rivlerësimit]. Për rrjedhojë, ky pretendim i Komisionerit Publik, përveçse nuk gjendet i bazuar në fakte, në vijim të analizës së mësipërme, nuk sjell efekte në kontrollin e vendimit të Komisionit lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 125 m², në Tiranë.

39. Pavarësisht përfundimit të arritur më sipër, me qëllim analizimin shterues të të gjitha shkaqeve ankimore të Komisionerit Publik, trupi gjykues shqyrtoi edhe pretendimin e tij, ashtu siç është pasqyruar më sipër në këtë vendim, se prindërit e znj. E. Ll. nuk kishin mundësi që burime të ligjshme të krijojnë shumën prej 25.000 eurosh, dhënë hua asaj në vitin 2011.

39.1 Në analizë të këtij pretendimi, nga shqyrtimi i deklarimeve të znj. Ll. në deklaratën e interesave të vitit 2004, e cila është deklarata e parë e dorëzuar në ILDKPKI, trupi gjykues vëren se si burim krijimi të kursimeve në *cash*, të deklaruara në shumën 5.000.000 lekë, ajo ka renditur *kursimet e veta dhe të familjes, si dhe dhuratë nga motra*. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, znj. Ll. ka deklaruar të ardhura neto për periudhën 2003-2004, në shumën 5.000.000 lekë, duke renditur burimet e krijimit të kësaj shume, si dhe duke deklaruar se gjatë kësaj kohe, të gjitha shpenzimet e saj përballoheshin nga të ardhurat nga bursa si studente e shkëlqyer e Fakultetit të Drejtësisë, prindërit, me të cilët banonte, dhe motra e saj, znj. A. Ll. (Ç.). Në interpretimin në harmoni të këtyre deklarimeve, si dhe në kushtet kur deklarimi i interesave të vitit 2004 shërben si provë në bazë të parashikimit të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se është i drejtë pretendimi i Komisionerit Publik, se analiza financiare mbi mundësinë e prindërve të znj. E. Ll. për të mbuluar me burime të ligjshme shumën 25.000 euro, dhënë hua znj. Ll., duhej të ishte kryer për periudhën 01.01.2005 e deri në momentin e dhënies së huas në datë 02.02.2011, në ndryshim nga Komisioni, i cili vlerësimin e mundësisë së prindërve të znj. Ll. për krijimin e kësaj shume, e ka shtrirë nga viti 1995 deri në vitin 2011, si dhe në ndryshim nga pretendimi i subjektit të rivlerësimit i cili pretendimet e tij i ka mbështetur në periudhën e analizuar nga Komisioni.

39.2 Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik se analiza e kryer nga Komisioni, duke konsideruar shpenzimet e familjes Ll. në minimumin e shpenzimeve sipas ILDKPKI-së, nuk përputhet me deklaratimet e prindërve të znj. Ll. se shuma prej 40.000 lekësh, si ndihmë nga vajza e tyre, znj. A. Ç., u është dhënë me qëllim mbulimin e shpenzimeve jetësore të tyre dhe të znj. Ll., të një niveli mesatar, trupi gjykues vëren se edhe gjatë gjykimit në Kolegj, megjithëse kundërshtoi standardin e përdorur nga Komisioni në analizën financiare mbi mundësinë për të krijuar kursime nga prindërit e znj. Ll., Komisioneri Publik, në argumentimin e këtij pretendimi, nuk identifikoi standardin apo metodologjinë se si duhet të përllogariteshin shpenzimet e jetesës në përputhje me pretendimin e tij.

39.3 Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi pretendimin e Komisionerit Publik, duke argumentuar se prindërit e ish-bashkëshortes kishin pasur mundësi të krijonin shumën prej 25.000 eurosh, në versionin e analizës financiare sipas së cilës, për periudhën 1995 - shkurt 2011, prindërit e znj. Ll. kanë kursyer gjatë një muaji pensionet e tyre dhe vetëm 10.000 lekë nga ndihma mujore prej 40.000 lekësh, dhënë nga vajza e tyre A. Ç., por edhe në versionin e dytë, sipas të cilit ata kanë shpenzuar pensionet, duke kursyer tërësisht shumën e ndihmës mujore prej 40.000 lekësh në muaj.

39.4 Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë faktin se shpenzimet e jetesës, bazuar në standardin e ILDKPKI-së sipas INSTAT, janë shpenzime të cilat u referohen shpenzimeve mesatare vjetore për konsum për frymë²⁵, standard ky i pranuar nga jurisprudenca e Kolegjit, për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për subjektet e rivlerësimit kalimtar [dhe familjet e tyre] apo për personat e tjerë të lidhur me ta, pavarësisht nivelit të të ardhurave, çmori të arsyeshëm dhe objektiv përdorimin e të njëjtit standard edhe në rastin konkret. Ndihma prej 40.000 lekësh në muaj, dhënë prindërve të znj. Ll. nga vajza e tyre, znj. A. Ç., në kuadrin e marrëdhënieve të ngushta familjare, si dhe në kushtet kur nga hetimi administrativ i kryer në Komision, ka rezultuar se znj. Ç. kishte mundësi që me të ardhura të ligjshme të ndihmonte familjarët e saj, është konsideruar nga trupi gjykues si e ardhur shtesë e prindërve të znj. Ll., që jo domosdoshmërisht mund të ndikonte në rritjen e shpenzimeve të jetesës së tyre, të cilat, edhe sipas deklarimeve të znj. L. e z. Xh. Ll. në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.06.2018, përsëri kanë mbetur në nivelin mesatar²⁶. Ndihma e përfituar nga prindërit e znj. Ll. nga vajza tjetër në formën e të ardhurave shtesë, nuk mund të përbëjë një rrethanë të veçantë që të justifikojë aplikimin automatikisht të një standardi të posaçëm në përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës së tyre, të ndryshëm nga ai i ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT²⁷.

39.5 Nga analiza financiare e kryer²⁸, duke reflektuar arsyetimin si më sipër, trupit gjykues i rezultoi se prindërit e znj. Ll., në periudhën 01.01.2005 - 02.02.2011, kishin mundësi që, me burime të ligjshme, të krijonin shumën prej 25.000 eurosh. Trupi gjykues kreu analizën financiare mbi mundësinë e prindërve të znj. Ll. për të krijuar shumën e dhënë hua prej 25.000 eurosh edhe në versionet e pretenduara prej subjektit të rivlerësimit, të cilat rezultuan me

²⁵ Referuar informacionit të përcjellë nga ILDKPKI në Kolegj, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 04.03.2019.

²⁶ Prindërit e znj. E. Ll., z. Xh. e znj. L. Ll., në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.06.2018, kanë deklaruar: “[...] Sa i përket shumës 25.000 euro, të cilën ia kemi dhënë vajzës sonë, znj. E. Ll., hua pa afat dhe pa interes, me qëllim shlyerjen e një kredie, deklarojmë se kjo shumë përfaqëson kursimet tona si familje, që nga momenti i hyrjes në punë deri në momentin e dhënies së kësaj huaje. Këto kursime përbëhen nga: pagat; pensioni mujor i z. Xh. Ll. nga viti 1994 e në vijim, 28.300 lekë; pensioni mujor i znj. L. Ll. nga viti 2000 e në vijim, 13.500 lekë; shuma prej 40.000 lekësh/muaj, dhënë nga vajza A. Ç. që prej vitit 1995 dhe aktualisht, me qëllim përmbushjen e nevojave tona për jetesë mesatare dhe për çdo shpenzim tjetër, që kemi pasur nevojë [...]”.

²⁷ Një standard të tillë pranoi edhe Komisioneri Publik gjatë gjykimit në Kolegj të çështjes nr. 19/2021 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. E. Ll., i cili në konkluzionet përfundimtare, në paragrafin 4.3, ka parashtruar se, lidhur me këtë shkak ankimi, duke i qëndruar të gjithë arsyetimit, bërë në ankimin e datës 14.4.2021, mbi periudhën që duhet marrë në analizë, 2005 – shkurt 2011, e gjen të drejtë pretendimin e subjektit mbi përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës së prindërve në përputhje me standardin e përdorur nga organet e rivlerësimit, gjatë këtij procesi. Trupi gjykues çmoi t’i drejtohej këtij vlerësimi të Komisionerit Publik, në kuadër të vendimit të ndërmjetëm në seancën gjyqësore të datës 06.05.2022, sipas të cilit, në këtë gjykim, u administruan në cilësinë e provës, të gjitha aktet që i përkasin procesit të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për subjektin e rivlerësimit, znj. E. Ll..

²⁸ Në analizën financiare, në të ardhurat e prindërve të znj. Ll., u përlllogaritën edhe të ardhurat e z. Xh. Ll. nga pensioni suplementar për periudhën 01.01.1999 - 22.03.2021, bazuar në vërtetim nr. {***} prot., datë 28.04.2022, të DRSSH Tiranë, të paraqitur si provë nga znj. Ll., gjatë gjykimit në Kolegj, të çështjes (JR) nr. 19/2021, datë 19.04.2021.

balanca pozitive, megjithëse shpenzimet e jetesës së prindërve të znj. Ll., të propozuara nga subjekti i rivlerësimit, në këto versione, rezultojnë në vlera më të larta se standardi i ILDKPKI-së bazuar në INSTAT.

39.6 Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se znj. Ll., shumë prej 40.000 lekësh, dhënë si ndihmë prindërve nga motra e saj, nuk e ka deklaruar në deklaratat e interesave, por vetëm gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues, në verifikim të detyrimit ligjor të znj. Ll. për deklarimin e kësaj ndihme, vëren se ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, [sipas përmbajtjes së tij në periudhën 2004-2011] në nenin 21, pika 1 parashikon: *Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit.*

Në zbatim të këtij parashikimi ligjor, edhe formulari i deklarimit të interesave privatë, i miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, në periudhën e marrë në shqyrtim, kërkonte prej zyrtarëve të deklaronin pasuritë vetëm për veten, bashkëshortin/en dhe fëmijët në moshë madhore [në përbërje familjare]. Pjesët përbërëse të këtij formulari nuk parashikojnë detyrimin për deklarimin e interesave të prindërve të zyrtarit deklarues, edhe pse mund të jenë të regjistruar në të njëjtën certifikatë familjare, pasi në radhën e subjekteve që duhet të plotësojnë deklarimin veçmas, paraqiten bashkëshorti/ja e zyrtarit deklarues dhe fëmijët në moshë madhore. Sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se znj. Ll. nuk kishte detyrimin të deklaronte të ardhurat e prindërve të saj, duke përfshirë edhe ndihmën e dhënë atyre nga vajza, znj. A. Ç., në deklaratat periodike të interesave.

40. Në vijim të analizës mbi këtë shkak ankimi, trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik, në ankim, se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi që, me burime të ligjshme, të paguante këstin e parë të pasurisë apartament me sipërfaqe 125 m² në Tiranë, shqyrtoi kundërshtimet e shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për to, si dhe pasi analizoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, nën dritën e legjislacionit të zbatueshëm në rrethanat konkrete, i vlerësoi ato në raport me pretendimin e Komisionerit Publik në konkluzionet përfundimtare, sipas të cilave subjekti rezultoi me mjaftueshmëri burimesh të ligjshme për pagesën e këstit objekt shqyrtimi, duke arsyetuar siç shtjellohet në detaj në vijim.

41. Analizën e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të paguar këstin e parë të pasurisë apartament me sipërfaqe 125 m² në Tiranë, në shumë 1.500.000 lekë, në datë 10.02.2011 [referuar parashikimeve të kontratës premtim shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.02.2011], trupi gjykues e mbështeti në verifikimin e kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit, bazuar në deklarimin e tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, se shuma prej 1.500.000 lekësh është siguruar nga kursimet personale ndër vite, deklarim ky i konfirmuar edhe nga të dhënat e deklaratës periodike të interesave të vitit 2011, në të cilën subjekti ka pasqyruar të njëjtin burim krijimi për këtë pagesë.

42. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike vjetore të interesave, për periudhën 2003 - 2010, nga subjekti i rivlerësimit rezultojnë të jenë deklaruar kursimet në *cash*, të analizuara si më poshtë.

42.1 *Për vitin 2004*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “të ardhura vjetore nga paga si student në Shkollën e Magjistraturës dhe nga puna në sektorin privat, kursime personale të miat që nga viti 1995 e në vazhdim deri sot, në shumë 1.500.000 lekë, në të holla *cash* në shtëpi”.

Në interpretim të deklarimit si më sipër të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi:

i. Në analizë të pretendimeve të palëve në gjykim, lidhur me mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar kursimet *cash* nga burimet e deklaruara në shumën 2.500.000 lekë, në vitin 2003, trupi gjykues mbajti në konsideratë arsyetimin e bërë në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të krijonte me burime të ligjshme, vetëm shumën prej 1.226.026 lekësh, si kursim në *cash* në fund të vitit 2003 e, për pasojë, në fillim të vitit 2004 kishte gjendje *cash* shumën e sipërcituar.

ii. Në raport me kursimet e krijuara nga burimet të ligjshme në shumën 1.226.026 lekë, gjendja e kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit është pakësuar me 1.147.766 lekë²⁹, për shkak të blerjes së automjetit tip “Mercedes Benz”, më datë 01.11.2004, për të cilin si burim krijimi, subjekti ka deklaruar kursimet personale³⁰. Për pasojë, pas blerjes së automjetit, subjekti i rivlerësimit kishte gjendje *cash* të krijuar nga burime të ligjshme, shumën 78.260 lekë, e cila rrjedh nga diferenca mes gjendjes së kursimeve në *cash* në fillim të viti 2004, të krijuara nga burime të ligjshme, në shumën 1.226.026 lekë dhe vlerës së blerjes së automjetit prej 1.147.766 lekësh.

iii. Në burimet e krijimit të kursimeve në *cash*, subjekti i rivlerësimit, duke deklaruar *kursime që nga viti 1995 e në vazhdim deri sot*, ka përfshirë edhe kursimet e krijuara nga të ardhurat gjatë vitit 2004. Në një interpretim të logjikshëm, të arsyeshëm dhe objektiv të këtij deklarimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmoi se gjendja e kursimeve në *cash* në fund të vitit 2004, është produkt kumulativ i kursimeve të ligjshme të mbetura nga viti 2003, në shumën 78.260 lekë dhe mundësisë së kursimit të subjektit gjatë vitit 2004, në shumën 643.382 lekë, e rezultuar si diferencë mes të ardhurave të përfituara dhe shpenzimeve të kryera gjatë këtij viti.

Si rezultat, gjendja e kursimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, në fund të vitit 2004, në *cash*, çmohet të jetë në shumën prej 721.642 lekësh.

42.2 Për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “gjendje *cash* në shumën 350.000 lekë”. Në interpretim të deklarimit si më sipër të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vendim, këtë shumë e ka konsideruar si shtim të gjendjes në *cash* të subjektit të rivlerësimit. Lidhur me deklarimin e tij mbi kursimet në *cash* të këtij viti, gjatë gjyqimit në Kolegj³¹, subjekti i rivlerësimit pretendoi se deklarimi i tij nuk mund të konsiderohet si gjendje *cash* në fund të periudhës, pasi shuma prej 350.000 lekësh, e kursyer, është krijuar nga të ardhurat nga paga si gjyqtar dhe si pedagog i jashtëm në Universitetin {***} e, për rrjedhojë, duhet t’i shtohet gjendjes së kursimeve në çelje të vitit.

Bazuar në sa më sipër, në përputhje me frymën e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, i cili përcakton rregullin se deklarohen ndryshimet vjetore të pasurisë, përfshirë dhe ndryshimin e gjendjes së likuiditetit jashtë sistemit bankar, por jo totalin e gjendjes së likuiditeteve, si dhe në kushtet kur vlerësimi i bërë nga Komisioni nuk është kundërshtuar nga Komisioneri Publik në ankim dhe në parashtrimet gjatë gjyqimit në Kolegj, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka deklaruar shtesën vjetore të kursimeve në *cash*, duket bindës. Pasi verifikoi nëpërmjet kryerjes së analizës financiare për vitin 2005, se subjekti i rivlerësimit dispononte burime të ligjshme financiare për krijimin e kursimeve në shumën e deklaruar prej 350.000 lekësh, në kushtet kur prej tij nuk janë krijuar pasuri të tjera dhe as është deklaruar pakësim i gjendjes së kursimeve në *cash*, trupi gjykues konstatoi se, në fund të vitit 2005,

²⁹ E përlllogaritur sipas kursit të këmbimit 1 euro = 126,74 lekë, të Bankës së Shqipërisë, në datën e blerjes së pasurisë.

³⁰ Në rubrikën “Pasuri të paluajtshme e të luajtshme”, në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Autoveturë benz, viti i prodhimit 1998, ngjyrë gri, me targa {***}. Blerë nga kursimet personale në datë 01.11.2004. Vlera 5.900 euro, plus 400.000 lekë zhdoganim, taksë regjistrimi dhe taksë pasurie”.

³¹ Në parashtrimet e paraqitura në seancën gjyqësore të datës 09.06.2022, si dhe në konkluzionet përfundimtare të paraqitura në seancën gjyqësore të datës 22.06.2022.

kursimet në *cash* të subjektit të rivlerësimit kanë qenë në shumën kumulative prej 1.071.642 lekësh.

42.3 *Për vitin 2006*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në *cash*.

42.4 *Për vitin 2007*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Gjatë vitit 2007 kam pasur një shtim të pasurisë personale, në vlerë monetare 100.000 lekë”. Ndërsa në rubrikën “Të ardhura dhe angazhime nga veprimtari private dhe/ose publike”, subjekti, nën shënimin “Koment”, ka sqaruar: *Deklaroj se në deklarimin e mëparshëm të bërë më datë 20.03.2007, për shkak të paqartësisë në përpilimin e deklaratës, kam deklaruar të ardhura të njëjta si në faqen nr. 3, ashtu dhe në faqen nr. 4 të deklaratës, te rubrika e plotësuar si të ardhura nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Ky deklarim i kësaj shume përfaqëson shumën e kursyer nga unë për periudhën 01.01.2006 deri më 31.12.2006, dhe jo të ardhurat neto nga puna si gjyqtar në këtë periudhë. I njëjti lapsus ekziston edhe në deklarimin e të ardhurave si pedagog, të cilat nuk janë të ardhura të kursyera, por të ardhurat e përfituara për periudhën në fjalë dhe të kursyera.*

Në deklaratën e interesave të vitit 2006, subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*, por ka deklaruar të ardhurat nga paga si gjyqtar dhe nga puna si pedagog në Universitetin {***}, *përkatësisht në shumat 350.000 lekë dhe 250.000 lekë*, si në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, ashtu edhe në rubrikën “Të ardhura dhe angazhime nga veprimtari private dhe/ose publike”.

Ndodhur në këto rrethana, trupi gjykues vlerësoi se deklarimi i subjektit në vitin 2007, duhet lexuar e kuptuar si korigjim i atij të vitit 2006, për sa kohë procesi i rivlerësimit implikon verifikimin e deklarimeve periodike të interesave të deklaruar më parë në ILDKPKI, të cilat në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të shërbejnë si provë në këtë proces, e për sa kohë që pavarësisht paqartësisë në deklarimin e vitit 2006, nga analiza financiare e kryer për këtë vit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të krijonte shumën 495.200 lekë, si kursim në *cash*, në *ndryshim nga shuma prej 600.000 lekësh sa ka deklaruar subjekti*. Sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se në fund të vitit 2007, kursimet në *cash* të subjektit të rivlerësimit kanë qenë në shumën kumulative prej 1.666.842 lekësh [e rezultuar si shumatore e shumës kumulative prej 1.071.642 lekësh në fund të vitit 2005 + shumën prej 495.200 lekësh kursim i vitit 2006 + 100.000 kursim i vitit 2007].

42.4.1 Trupi gjykues gjen me vend të qartësojë se rezultati i analizës financiare i referuar më sipër, vjen si pasojë e verifikimit dhe vlerësimit të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, të deklaruara nga punësimi si pedagog i jashtëm në Universitetin {***}.

Nevoja e qartësisë në këtë rast, vjen për shkak të mospërputhjes së shumës së të ardhurave të përfituara nga punësimi në Universitetin {***}, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit me atë të deklaruar në deklaratat periodike vjetore, si dhe mënyrës së përshkrimit të këtyre të ardhurave në dokumentacionin justifikues të përcjellë nga Universiteti {***}. Vërtetimi, datë 26.10.2016, i Universitetit {***}, paraqitur nga subjekti bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit, pasqyron të ardhurat *neto* të përfituara nga z. Gerd Hoxha, si pedagog, në periudhën janar 2004 - dhjetor 2008, në shumën totale 392.940 lekë, por nuk pasqyron në mënyrë analitike të ardhurat vjetore. Në vërtetimin e datës 16.05.2013, Universiteti {***} ka detajuar periudhat e punësimit të z. Gerd Hoxha për secilin vit, por të pashoqëruara me shumën e të ardhurave të përfituara në secilën periudhë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë në Komision nga Banka Intesa San Paolo, rezultoi se, në vitin 2007, ka kaluar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit shuma 35.550 lekë, me përshkrimin: *Fakulteti {***}, paga si pedagog i jashtëm*. Me po të njëjtin përshkrim, në vitin 2008, ka kaluar shuma 30.690 lekë.

Në mungesë të informacionit analitik për të ardhurat vjetore të subjektit të rivlerësimit nga puna si pedagog, bazuar në vlerën totale të dokumentuar të të ardhurave prej 392.940 lekësh, si dhe

në shumat e pagave të kaluara nëpërmjet sistemit bankar për vitet 2007 e 2008 në shumën 66.240 lekë, u krye shpërndarja e thjeshtë matematikore e vlerës së mbetur, për vitet 2004, 2005 e 2006 [392.940 lekë – 66.240 lekë = 326.700 lekë/ 27 muaj = 12.100 lekë/ muaj]. Sipas kësaj shpërndarjeje, subjekti i rivlerësimit, bazuar në periudhën e punësimit për secilin vit, ka përfituar nga Universiteti {***}, për vitin 2004 shumën 36.300 lekë, për vitin 2005 shumën 145.200 lekë dhe për vitin 2006 shumën 145.200 lekë.

Duke vlerësuar se ky arsyetim është objektiv dhe i shërben zgjidhjes sa më të drejtë të çështjes, trupi gjykues i konsideroi këto vlera si të ardhura nga punësimi në Universitetin {***}, si pasqyruar më sipër, në analizën financiare për vlerësimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit, që me të ardhura të ligjshme të krijonte kursimet e deklaruara.

42.5 *Për vitin 2008*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “kursime nga paga vjetore si gjyqtar dhe shpërblimet si ekspert në Shkollën e Magjistraturës dhe pedagog në Universitetin {***}, në vlerën 200.000 lekë”.

Për vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “kursime nga paga vjetore si gjyqtar dhe shpërblimet si ekspert në Shkollën e Magjistraturës dhe OSBE, në vlerën 400.000 lekë”.

Për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “kursime nga paga vjetore si gjyqtar dhe shpërblimet si ekspert në Shkollën e Magjistraturës dhe OSBE Tiranë, në vlerën 350.000 lekë”. Trupi gjykues, nga balancat pozitive të rezultuara nga analiza financiare për secilin vit, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi që, me burime të ligjshme, të krijonte kursimet në shumat e deklaruara.

43. Në përfundim të këtij arsyetimi, trupi gjykues konstatoi se shuma kumulative e kursimeve në *cash*, që subjekti i rivlerësimit dispononte nga burime të ligjshme, në fund të vitit 2010, ishte në vlerën 2.616.842 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare, të mjaftueshme për të paguar këstin e parë të pasurisë apartament me sipërfaqe 125 m² në Tiranë, në vitin 2011, në shumën 1.500.000 lekë.

Për pasojë, pretendimi i Komisionerit Publik në ankim, gjendet i pabazuar dhe subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e parashikuara nga shkronja “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

44. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit është i nevojshëm rivlerësimi nga ana e Kolegjit i pasurisë automjet, tip “Citroen C4”, blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2012, trupi gjykues konstatoi si vijon.

45. Komisioni, në përfundim të kontrollit e vlerësimit të kësaj pasurie, në vendim ka arsyetuar: *Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe duke u mbështetur në analizën e kryer më lart në lidhje me të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme për periudhën 1995-2000 dhe të ardhurat nga shitja e automjetit dhe kursimet cash të bashkëshortes së tij, vlerëson të përfshijë në analizë financiare këto të ardhura. Si burim për blerjen e këtij automjeti, subjekti, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, ka deklaruar kursimet personale të tij dhe të bashkëshortes së tij. I njëjti deklaram është bërë dhe nga ish-bashkëshortja e subjektit. Mbështetur në deklaramet e subjektit, si dhe shpjegimet e tij pas kalimit të barrës së provës, Komisioni do të zbrësë nga gjendja cash e subjektit dhe bashkëshortes së tij vlerën e automjetit, duke e konsideruar si pakësim të gjendjes cash në vitin 2012. Nga analiza financiare, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.*

46. Komisioneri Publik kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e mësipërm lidhur me pasurinë objekt kontrolli, me pretendimin se Kolegji, lidhur me kursimet e subjektit të rivlerësimit, duhet të rivlerësojë bazueshmërinë e argumenteve të përdorura nga Komisioni në vlerësimin për të përfshirë në analizën financiare shumën e pretenduar nga subjekti, të disponuar në *cash*, në

vlerën 1.200.000 lekë në vitin 2011, si dhe pakësimin nga kursimet në *cash* të subjektit dhe bashkëshortes së tij, si burim për blerjen e automjetit në vitin 2012, çka do të ndikonte në mundësinë financiare të tyre për të mbuluar me burime të ligjshme blerjen e automjetit, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës, për një diferencë negative prej 687.222 lekësh.

47. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet para Kolegjit, argumentoi se pretendimet e Komisionerit Publik janë të pabazuara. Ai prapësoi se ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, pasi në fund të vitit 2011, ai dispononte në *cash*, shumën prej 1.200.000 lekësh, e përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes Benz”. Sipas subjektit, rrethanat e shitjes së kësaj pasurie vetëm 2 muaj nga përfundimi i periudhës së deklarimit, si dhe fakti që ai nuk ka deklaruar apo pranuar shpenzimin e menjëhershëm të saj, tregojnë qartë se ai e dispononte këtë shumë në *cash*, në fund të vitit 2011. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka deklaruar saktë këtë shumë në deklaratën periodike të vitit 2011, pasi nuk ka pasur një shtim të mirëfilltë pasurie, por vetëm një konvertim në *cash* të pasurisë ekzistuese, automjetit tip “Mercedes Benz”, si pasojë e shitjes së saj.
48. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, në shqyrtimin e shkakut të ankimit lidhur me kontrollin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë automjet tip “Citroen C4”, pasi analizoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstatoi faktet dhe rrethanat si më poshtë.

48.1 Në datë 16.08.2012, subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja e tij kanë lidhur me shoqërinë “{***}” ShA, kontratën e qirasë financiare-*leasing* nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.08.2012, për blerjen e automjetit tip “Citroen C4”. Sipas shtojcës nr. 1 të kësaj kontrate, të titulluar “Kushtet e posaçme të qirasë financiare nr. 2044”, vlera e automjetit është 16.500 euro, nga të cilat, pjesa prej 54,5% është likuiduar nga pala blerëse në momentin e nënshkrimit të kontratës, dhe pjesa tjetër do të paguhej nëpërmjet qirasë financiare me këste mujore.

48.2 Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma prej 9.679,47 eurosh, e paguar për blerjen e automjetit në datën e lidhjes së kontratës së qirasë financiare, është siguruar në mënyrë të barabartë, nga *kursimet personale të tij dhe të bashkëshortes*.

48.3 Gjatë gjykimit në Kolegji, subjekti i rivlerësimit solli në vëmendje deklaratimet e tij në përgjigje të barrës së provës, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, përcjellë në Komision më datë 21.05.2021, në të cilat ka shpjeguar se të ardhurat në shumën prej 1.200.000 lekë të përfituara nga shitja e automjetit me targë {***}, në vitin 2011, janë përdorur për pagesën e një pjese të çmimit të blerjes së automjetit tip “Citroen C4”, në vitin 2012, si dhe për krijimin e pasurive të tjera. Në të njëjtat shpjegime, subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit me targë {***}, ka deklaruar se: *Ky transaksion është pasqyruar në mënyrë të rregullt në deklaratimin periodik vjetor për vitin 2011 dhe në deklaratën “vetting” të vitit 2016 prej meje dhe ish-bashkëshortes sime. Dua të theksoj se ai është paraqitur pikërisht në kolonën përkatëse të ndryshimit të pasurive dhe burimit të krijimit të tyre, në formularin periodik vjetor, ku unë kam deklaruar shitjen e këtij automjeti dhe të ardhurat e krijuara në vlerën 1.200.000 lekë. Qëllimi im i vetëm ka qenë deklarimi i saktë dhe transparent i këtij transaksioni dhe trajtimi i kësaj vlere si shumë “cash”, e cila fillon dhe kursethet në momentin e marrjes prej meje të vlerës monetare nga blerësi. Dëshiroj të theksoj se në këtë rast pasuria automjet, është konvertuar në gjendje para, në vlerën e shitjes prej 1.200.000 lekësh, mjete të cilat nuk u shpenzuan, por u përdorën si gjendje cash kursimi në atë moment, dhe në vazhdim. [...] në asnjë dokument, apo rrethanë tjetër, unë nuk kam deklaruar apo pranuar shpenzimin e menjëhershëm, apo aty për aty të kësaj shume të përfituar nga shitja,*

apo të lë të kuptoj se kjo shumë është shpenzuar në të njëjtin vit kalendarik (2011). Ajo shumë i është bashkuar gjendjes së kursimeve të tjera. Qëllimi i vetëm në deklarimin, ka qenë pasqyrimi i qartë dhe i saktë i transaksionit, dhe shtesës së gjendjes së parasë cash, të akumuluar si pasojë e të ardhurave të krijuara nga ky transaksion. Në çdo rast, nuk ka pasur një shtim të mirëfilltë pasurie, si rezultat i ndonjë të ardhure shtesë, por vetëm një konvertim në vlerë cash monetare, i një pasurie ekzistuese (automjeti). Vetë Komisioni ka pasur mundësinë të konstatojë se nuk ka pasur asnjë shtesë tjetër në pasuri të tjera, të luajtshme apo të paluajtshme në atë vit kalendarik, për të cilat mund të ishte përdorur kjo shtesë në kursime, çka qartësisht nënkupton se kjo vlerë është shtuar në kursimet ekzistuese, për vitin në vazhdim. Në konkluzion, kërkoj që Komisioni të konsiderojë si kursim shumë prej 1.200.000 lekësh në vitin 2011, duke ia shtuar këtë shumë gjendjes ekzistuese të kursimeve cash.

48.4 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratën periodike të interesave të vitit 2011, në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Daimler Chrysler”, me targë {***}, në shumën 1.200.000 lekë. Në deklaratën e interesave të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa apo pakësime të kursimeve në cash.

48.5 Nga verifikimi i akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, rezultoi se shitja e automjetit, tip “Daimler Chrysler”, z. E. G., ka kaluar në dy faza:

i. Më datë 31.03.2011, është lidhur kontrata premtim shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2011, sipas së cilës, palët në marrëveshje mes tyre kanë përcaktuar se çmimi i shitjes së automjetit do të jetë 1.200.000 lekë, nga i cili, shuma prej 1.000.000 lekësh është likuiduar me nënshkrimin e kësaj kontrate, ndërsa diferenca prej 200.000 lekësh do të likuidohet në një periudhë të mëvonshme, në marrëveshje ndërmjet palëve.

ii. Më datë 29.10.2011, është lidhur kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2011, sipas së cilës, palët në marrëveshje mes tyre, kanë përcaktuar se çmimi i shitjes së këtij automjeti do të jetë 1.200.000 lekë, shumë e cila është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Shitësi ka deklaruar se automjetin e dorëzon në gjendje të rregullt teknike.

Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.01.2015, deklaruesi E. G. ka deklaruar: [...] Kam lidhur një kontratë shitjeje automjeti me nr. 5132 rep., nr. 1412 kol., datë 29.10.2011, me palë Gerd Hoxha, shitës, dhe unë deklaruesi, si palë blerëse, për mjetin me të dhëna: automjet, marka Daimler Chrysler [...]. Pronësinë e mjetit e kam ndërruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, më datë 15.11.2013 [...]. Që nga momenti i nënshkrimit të kontratës e deri në momentin që është bërë ndërrimi i pronësisë, automjetin e kam pasur dhe vazhdoj ta kem unë në përdorim”.

48.6 Nga informacioni i përcjellë në Komision nga DPSHTRr-ja³², konfirmohet se z. E. G. ka fituar pronësinë e automjetit, tip “Daimler Chrysler”, më datë 15.11.2013 dhe po në të njëjtën datë ka marrë edhe lejen e qarkullimit për këtë mjet.

- 49.** Në shqyrtim të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues, në vijim edhe të qëndrimeve të mbajtura tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit³³, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësinë e disponimit të likuiditetit cash në fund të vitit 2012, në shumën 1.200.000 lekë, ndonëse kjo shumë nuk rezultoi e deklaruar saktësisht si shtim i likuiditetit në gjendje cash jashtë sistemit bankar, në deklaratën periodike të vitit 2011. Në këtë konkluzion, trupi gjykues arriti pasi mori në konsideratë e vlerësoi në harmoni se:

³² Informacion i përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 25.02.2019.

³³ Vendimi nr. 33/2021 (JR), datë 03.11.2021, paragrafi 44; vendimi nr. 37/2021 (JR), datë 24.11.2021, paragrafi 10.25; vendimi nr. 20/2022, datë 14.06.2022, paragrafi 14.

i. shuma prej 1.200.000 lekësh ka rrjedhur nga një transaksion i ligjshëm – shitja e automjetit tip “Daimler Chrysler”, veprim juridik ky lehtësisht i verifikueshëm nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, për rrjedhojë rezultojnë të jetë krijuar nga burime të ligjshme;

ii. subjekti i rivlerësimit, çmimin e shitjes së makinës e ka përfituar në dy këste: në datë 31.03.2011, në shumën 1.000.000 lekë dhe në datë 29.10.2011, në shumën 200.000 lekë. Nga leximi i kryqëzuar i të dhënave të kontratës së shitblerjes së automjetit, të dhënave zyrtare të përcjella në Komision nga DPSHTRr, si dhe deklaratës noteriale të z. E. G., blerësit të automjetit, rezultojnë se ky i fundit e ka marrë automjetin në dorëzim në datën e lidhjes së kontratës së shitjes, dhe makina i është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në po të njëjtën datë, në gjendje të rregullt teknike. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit e kishte ende në pronësi dhe në përdorim automjetin edhe pas përfitimit të pagesës së parë pas premtimit të shitjes së tij, duket e logjikshme që vlerën e përfituar prej 1.000.000 lekësh, të mos ta shpenzonte, pasi nuk kishte siguri për lidhjen e kontratës së shitjes, por edhe për faktin se kishte detyrimin që në momentin e shitjes së premtuar, mjetin ta dorëzonte te blerësi në gjendje të rregullt teknike. Në këtë kuptim, është e pranueshme dhe e besueshme që, në datën 29.10.2011, datë e lidhjes së kontratës së shitjes së automjetit, subjekti i rivlerësimit të posedonte vlerën e plotë të shitjes së automjetit, prej 1.200.000 lekësh, në *cash*;

iii. deklarimi i të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit e më tej përdorimi i tyre si burim krijimi për pasuritë e tjera, nuk është një deklarim i posaçëm i kryer nga subjekti i rivlerësimit vetëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por ka qenë një deklarim i bërë që në deklaratat periodike të interesave të viteve 2011 e 2012;

iv. koha relativisht e shkurtër nga momenti i përfitimit të plotë të vlerës së shitjes së automjetit në datën 29.10.2011, deri në datën 31.12.2011, datë në të cilën verifikohet e deklarohet gjendja e kursimeve në *cash*, nuk ndikon për të ngritur një dyshim të arsyeshëm të trupi gjykues në drejtim të shpenzimit tërësisht të kësaj shume, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, në harkun kohor mars - dhjetor 2011, nuk ka krijuar pasuri. Shlyerja e pagesës për këstin e parë të apartamentit me sipërfaqe 125 m² në Tiranë, në datë 10.02.2011, rreth dy muaj para lidhjes së kontratës premtim shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2011, për automjetin, tip “Daimler Chrysler”, përjashton logjikisht mundësinë e përdorimit të shumës së përfituar nga shitja e automjetit si burim për këtë pagesë, mbështetur edhe në faktin se sipas përcaktimit kontraktor, shuma prej 1.000.000 lekësh, është përfituar nga subjekti i rivlerësimit në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate;

v. nga verifikimi i dokumentacionit të krijuar gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që të tregojë se shuma e përfituar nga shitja e automjetit të jetë përdorur në ndonjë destinacion tjetër, në drejtim të krijimit të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, apo për kryerjen e shpenzimeve të tjera;

vi. përdorimi i këtyre të ardhurave për financimin e blerjes së pasurisë automjet “Citroen C4”, është kryer në distancë të afërt kohore nga data 29.10.2011, datë e përfitimit të plotë të shumës prej 1.200.000 lekësh, deri në datën e lidhjes së kontratës së qirasë financiare-*leasing*, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.08.2012, sipas së cilës pagesa e një pjese të çmimit të automjetit është likuiduar në datën e nënshkrimit të saj.

50. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të shkakut të ankimit për pasurinë objekt kontrolli, vëren se vlerësimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur janë në pamundësi financiare për të mbuluar me burime të ligjshme blerjen e automjetit, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës, për një diferencë negative prej 687.222 lekësh, është afektuar tërësisht nga moskonsiderimi prej tij i shumës prej 1.200.000 lekësh, si gjendje në *cash* në fund të vitit 2011, i cili ishte dhe pretendimi thelbësor lidhur me këtë pasuri. Në vijim, në kushtet kur nga arsyetimi i mësipërm u krijua bindja se qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në fund të vitit 2011, ka pasur shtesë në kursimet në *cash* shumën

prej 1.200.000 lekësh, të përfituar nga shitja e automjetit, trupi gjykues çmoi se bie konkluzioni i Komisionerit Publik mbi pamundësinë e subjektit dhe të personit të lidhur për krijimin me burime të ligjshme, të pasurisë objekt kontrolli.

51. Përpos këtij përfundimi, në kushtet kur krijimi i pasurisë automjet, tip “Citroen C4”, ka ndikuar në pakësimin e kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, analiza financiare për vitin 2012, shtjellohet në vijim të shqyrtimit të shkaqeve të tjera të ankimit.
52. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të blerë pasurinë automjet, tip “Citroen C4”, në vitin 2012 e, për pasojë, nuk gjendet në kushtet e parashikuara nga shkronja “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
53. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit: *është i nevojshëm rivlerësimi i zërave përbërës të analizës financiare dhe mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes së tij, për të mbuluar me burime të ligjshme, kursimet e deklaruara ndër vite, të përdorura për blerjen e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 126,5 m², në Vlorë, trupi gjykues konstatoi si vijon.*
54. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie. Komisioni, në lidhje me mundësinë financiare të subjektit dhe të personit të lidhur, ka arsyetuar se *pas përfshirjes në analizë të: (i) kursimeve “cash” të deklaruara ndër vite nga ish-bashkëshortja e tij; (ii) konsiderimit si kursime “cash”, në vitin 2004, të shumës 1.500.000 lekë, duke pranuar të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme e subjektit për periudhën 1995-2000; (iii) shumës 1.200.000 lekë, si shtesë e gjendjes “cash” e subjektit në vitin 2011; rezulton se ai së bashku me ish-bashkëshorten e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës.*
55. Komisioneri Publik kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, me pretendimin se nga analiza financiare e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes së tij, për të mbuluar me burime të ligjshme, kursimet e deklaruara ndër vite, të përdorura për blerjen e pasurisë, rezulton një diferencë negative prej 5.971.505 lekësh, pasi:
 - i. të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit nga puna e tij me kohë të pjesshme, për periudhën 1995-2000, nuk plotësojnë kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme dhe subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016;
 - ii. deklaramet periodike vjetore të pasurisë së ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit mbi kursimet në *cash* të periudhës 2006-2010, të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, nuk mbështesin pretendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ;
 - iii. kursimet në *cash* të vitit 2011, nga shitja e një automjeti në shumën 1.200.000 lekë, nuk rezultojnë të jenë deklaruar si të disponuara në *cash* në këtë vlerë në deklaratën periodike vjetore të këtij viti dhe, si të tilla, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, nuk mund të konsiderohen si kursime *cash* që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 2016.
56. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij para Kolegjit, argumentoi se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me pasurinë objekt kontrolli, janë të pabazuara. Ai prapësoi se ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për blerjen e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 126,5 m², në Vlorë, pasi:
 - i. shuma prej 1.500.000 lekësh, e rrjedhur nga të ardhurat nga puna në sektorin privat në periudhën 1995-2000, duhet të konsiderohet si kursim nga të ardhura të ligjshme;

ii. për periudhën 2006-2010, shuma e kursimeve në *cash* të ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, bazuar në deklaratimet periodike, është në shumën 2.335.000 lekë;

iii. të ardhurat në shumën 1.200.000 lekë, nga shitja e automjetit në vitin 2011, janë deklaruar saktësisht në rubrikën e ndryshimit të pasurive dhe kjo shumë është trajtuar si kursim në *cash* nga subjekti i rivlerësimit, pasi nuk ka pasur një shtim të mirëfilltë pasurie, si rezultat i ndonjë të ardhure shtesë, por vetëm konvertim në vlerë *cash* të një pasurie ekzistuese, shumë e cila është përdorur më pas, për krijimin e pasurive të tjera.

57. Trupi gjykues, në shqyrtimin e shkakut të ankimit lidhur me kontrollin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë “apartament banimi” me sipërfaqe 126,5 m² në Vlorë, si dhe të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit për të, pasi analizoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstatoi faktet dhe rrethanat si më poshtë.
58. Me anë të kontratës për shitblerje apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.09.2016, subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja e tij kanë blerë nga znj. A. e z. A. Ç.[motra e znj. Ll. dhe bashkëshorti i saj], apartamentin me sipërfaqe 126,5 m², në Vlorë, në shumën 55.452 euro. Likuidimi i çmimit të shitblerjes së pasurisë në fjalë, është realizuar nga subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja e tij me kalimin e shumës 55.452 euro në llogarinë bankare të noteres I. B., pranë Bankës Kombëtare Tregtare, më datë 09.09.2016³⁴.
59. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se: “[...] Shuma për blerjen e apartamentit është siguruar nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes sime, të realizuara gjatë gjithë jetës sonë, sipas përshkrimit të bërë në deklaratat tona të pasurisë, për efekt të ligjit nr. 84/2016”. Ky deklaram përputhet plotësisht me atë në deklaratën periodike të interesave, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së në vitin 2016.
60. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstatoi, fillimisht, që disa nga pretendimet e Komisionerit Publik janë pretendime të lidhura edhe me pasuritë e tjera të subjektit të rivlerësimit, të shqyrtuara dhe të zgjidhura në arsyetimin e bërë më sipër në këtë vendim, në analizën dhe vlerësimin përkatës të pasurive objekt kontrolli. Trupi gjykues nënvizon se konkluzionet e arritura më sipër në këtë vendim, se:

i. të ardhurat në shumën 1.500.000 lekë, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit se janë krijuar nga marrëdhënia e punësimit në sektorin privat në periudhën 1995-2000, duke mos përmbushur kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës për t’i konsideruar ato të ardhura të ligjshme, afektonin ligjshmërinë e kursimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në shumën 2.500.000 lekë, e për pasojë u konsiderua i bazuar pretendimi i Komisionerit Publik, se subjekti i rivlerësimit deri në fund të vitit 2003, kishte mundësi të krijonte me burime të ligjshme vetëm shumën prej 1.226.026 lekësh, e rrjedhur nga të ardhurat nga bursa e studimeve në Shkollën e Magjistraturës dhe pagat si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Trupi gjykues vlerësoi pa peshë dhe të panevojshme të mbante në konsideratë në procesin e kontrollit të kriterit të pasurisë, të kundërtën e konkluzionit të mësipërm, se nga kursimet e deklaruara në vitin 2003, në shumën 2.500.000 lekë, subjekti nuk mund të krijonte me burime të ligjshme shumën prej 1.273.974 lekësh, në kushtet kur objekti i pretendimit të Komisionerit Publik në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj³⁵, lidhej me interpretimin e të dhënave të deklaratës së

³⁴ Në dokumentacionin e regjistrimit të pasurisë pranë ASHK Vlorë, gjendet mandati, datë 09.09.2016, i arkëtimit “cash” të shumës 55.452 euro, nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë e klientit I. B., në Bankën Kombëtare Tregtare, me përshkrimin: “Gerd Hoxha derdh likuidimin e çmimit të shitjes së apartamentit nr. {***}, me sipërfaqe 126,5 m² [...]”. Ky veprim bankar konfirmohet edhe nga BKT-ja, në informacionin e përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 08.03.2019.

³⁵ Në konkluzionet përfundimtare të parashtruara në seancën gjyqësore të datës 22.06.2022, lidhur me shumën 2.500.000 lekë, të deklaruar si kursim në *cash* nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, Komisioneri Publik u shpreh vetëm në paragrafin 1.5, në të cilin ai është shprehur se: “[...] Por mbeten të

pasurisë së vitit 2003 dhe me efektin që ky interpretim kishte vetëm mbi krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit. Duke konsideruar si burim në krijimin e kursimeve në *cash*, vetëm shumën e rezultuar si e krijuar me burime të ligjshme, trupi gjykues ka verifikuar pasojën që ka dhënë ky konkluzion në krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë, nëse do t'i jepej peshë e posaçme mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e shumës 2.500.000 lekë me pasojë në drejtim të përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit, atëherë ai do të vendosej në kushtet e ngarkimit të përsëritur me të njëjtën mungesë burimesh dhe detyrimisht në rritje artificiale të kësaj mungese. Trupi gjykues mbajti në konsideratë gjithashtu, edhe faktin që përfitimi i të ardhurave nga sektori privat, si burim krijimi për kursimet në *cash*, është deklaruar rregullisht nga subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe nuk ka ardhur në proces si një deklaram i posaçëm, vetëm për efekt të justifikimit të burimeve të pamjaftueshme të të ardhurave.

ii. shuma prej 1.200.000 lekësh, e përfituar si pasojë e shitjes së automjetit, tip “Daimler Chrysler”, dhe e deklaruar si e tillë në deklaratën e interesave të vitit 2011 dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, disponohej prej subjektit të rivlerësimit si kursim në *cash* në fund të vitit 2011 e, për pasojë, u konsiderua i bazuar pretendimi i Komisionerit Publik për të kundërtën;

– kanë dhënë përgjigje, duke zgjidhur pretendimet e njëjta të Komisionerit Publik, lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 126,5 m² në Vlorë. Këto konkluzione, trupi gjykues i mbajti në konsideratë në analizën financiare të kryer për verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme pasurinë objekt kontrolli.

61. Në lidhje me pretendimet e tjera lidhur me pasurinë objekt kontrolli, trupi gjykues vëren se në seancën gjyqësore të datës 09.06.2022, Komisioneri Publik parashtrroi si vijon.

Në analizë të akteve të administruara deri në këtë moment procedural, Komisioneri Publik çmon të nevojshme të sqarojë dhe të prapësojë një pretendim të subjektit të rivlerësimit në raport me shkaqet e ankimit, parashtruar prej tij në seancën e datës 06.05.2022 [...]. Për efekt edhe të përmbajtjes së analizës financiare të kryer nga Kolegji, Komisioneri Publik sqaron se ndryshe nga sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, shuma prej 5.000.000 lekësh përfshihet në shkaqet e ankimit, kundër vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit, shkak ky i cili është ngritur në kuadër të nevojës për kryerjen e një analize të re financiare, me qëllim vlerësimin e mundësive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme pasuritë e deklaruara në deklaratën “vetting”, si dhe ato të rezultuara gjatë hetimit administrativ. Duke iu referuar përmbajtjes së ankimit, kuptohet lehtësisht se në shkaqet e ankimit për këtë pasuri, objekt kontrolli, të referuara për juridiksionin rivlerësues të Kolegjit, përfshihen të gjitha burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “vetting” dhe atë periodike [...].

61.1 Subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore të datës 06.05.2022, në parashtrimet fillestare, parashtrroi se nga përmbajtja e ankimeve të depozituara nga Komisionerët Publikë kundër vendimit nr. 393, datë 03.06.2021 dhe nr. {***}, datë 02.02.2021 të Komisionit, rezulton qartësisht se shkaqet e ankimeve janë të ndryshme. Ankimi i Komisionerit Publik kundër vendimit të konfirmimit në detyrë të z. Gerd Hoxha, nuk përmban shkaqe kundër shumës

pambuluara me burime të ligjshme kursimet e deklaruara në deklaratën e parë të vitit 2003, në shumën 2.500.000 lekë, pasi nga aktet në dosje, rezulton se të ardhurat e ligjshme për të cilat është provuar pagesa e detyrimeve tatimore në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, janë në vlerën 1.226.026 lekë. Bazuar në këto të ardhura, rezulton se kursimet e deklaruara në DV-2003, nuk mbulojnë me burime të ligjshme për një diferencë negative prej 1.281.804 lekësh, diferencë që reflektohet në pamundësinë e mbulimit me burime të ligjshme të pasurisë, apartament, të ndodhur në Vlorë”.

prej 5.000.000 lekësh, të sjellë nga znj. Ll. para martesës, ndërkohë që kjo shumë përbën shkakun themelor të ankimit kundër znj. Ll.

Këtë qëndrim, subjekti i rivlerësimit e përsëriti edhe në parashtrimet e tij në seancën gjyqësore të datës 09.06.2022 dhe në parashtrimet për konkluzionet përfundimtare në seancën gjyqësore të datës 22.06.2022.

Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i Komisionerit Publik se, nga shuma prej 5.000.000 lekësh, e deklaruar si kursim në “cash” nga personi i lidhur, znj. Ll., në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2004, vetëm shuma prej rreth 1.465.243 lekësh rezulton se mbulohet me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nuk përfshihet në shkaqet e ankimit e, për pasojë, nuk mund t’i nënshtrohet shqyrtimit e analizës nga trupi gjykues. Vlerësimi i trupit gjykues mbështetet në arsyet në vijim.

i. Nga përmbajtja e ankimit nr. {***} prot., datë 15.07.2021, të Komisionerit Publik, konstatohet se në paragrafin 32 të tij, Komisioneri Publik ka parashtruar se kursimet “cash” të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, janë elemente që do të duhet të analizohen në kuadër të ligjshmërisë së të ardhurave të përdorura si burim për krijimin e kësaj pasurie. Më tej, në paragrafët 32.1, 32.2 dhe 32.3 të ankimit, Komisioneri Publik ka shtjelluar pretendimet konkrete për këtë shkak ankimi, se cilat kursime në cash të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të duhet të analizoheshin, ashtu siç ato janë pasqyruar më sipër në këtë vendim. Në paragrafin 32.4, ka parashtruar: *Për sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, çmohet i nevojshëm rivlerësimi i zërave përbërës të analizës financiare dhe mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes së tij, për të mbuluar me burime të ligjshme, kursimet e deklaruara ndër vite, të përdorura për blerjen e kësaj pasurie*, duke lënë të kuptohet qartësisht se pretendimet e tij lidhen vetëm me aq sa është kundërshtuar prej tij në nënparagrafin 32.3, për sa u përket kursimeve të znj. Ll., të deklaruara në deklaratat periodike të viteve 2006-2010. Duke kufizuar periudhën në segmentin kohor si më sipër, Komisioneri Publik ka pasur si qëllim përjashtimin e kërkimit të ankimit për shumën 5.000.000 lekë, e cila është deklaruar si kursim cash në vitin 2004.

Trupi gjykues vëren se në ankim, në elaborimin e pretendimeve mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 126,5 m² në Vlorë, në asnjë prej tyre, jo vetëm nuk kontestohet në asnjë element, por as nuk përmendet shuma prej 5.000.000 lekësh, e deklaruar si kursim nga znj. Ll. në vitin 2004. Kjo shumë evidentohet të jetë përmendur vetëm në paragrafin 30.5 të ankimit, në të cilin Komisioneri Publik ka konstatuar: *[...] Bazuar në këto deklaratime, duket se gjithë të ardhurat e znj. Ll. dhe prindërve të saj, deri në fund të vitit 2004, kanë shërbyer si burim krijimi të shumës së kursimeve “cash”, të deklaruara prej saj në shumën 5.000.000 lekë. Nisur nga ky konstatim, vlerësojmë se analiza financiare mbi mundësinë e prindërve të znj. Ll. për të mbuluar me burime të ligjshme shumën 25.000 euro në vitin 2011, duhej të ishte kryer për periudhën 1.1.2005 e deri në momentin e dhënies së huas. Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton se kundërshtimi i shumës prej 5.000.000 lekësh, si kursim i znj. Ll., nuk ka qenë qëllim i ankimit të Komisionerit Publik, por vetëm një konstatim në shërbim të pretendimit lidhur me periudhën e kryerjes së analizës financiare mbi mundësinë e prindërve të znj. Ll. për të mbuluar me burime të ligjshme shumën 25.000 euro, të dhënë hua prej tyre, në vitin 2011.*

ii. Trupi gjykues verifikoi përmbajtjen e rekomandimit³⁶ nr. {***} prot., datë 08.07.2021, për paraqitje ankimi, të nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të ONM-së kundër vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit, nga e cila konstatoi se në asnjë rresht, vëzhguesit ndërkombëtarë nuk kanë shprehur kundërshtime apo qoftë edhe rezerva në lidhje me shumën prej 5.000.000 lekësh, të deklaruar si kursim nga znj. Ll. në vitin 2004, duke e

³⁶ Shih rekomandimin e ONM-së nr. {***} prot., datë 08.07.2021, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në linkun në vijim:

<http://ikp.al/wp-content/uploads/2021/07/19.Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-393-dat%C3%AB-3.6.2021.pdf>.

pranuar të mirëqenë ligjshmërinë e krijimit të saj, në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në procesin e rivlerësimit për subjektin Gerd Hoxha.

iii. Në dokumentin e prodhuar në Kolegj – *Analizë financiare paraprake për subjektin e rivlerësimit Gerd Hoxha, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me të, sipas pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim* – trupi gjykues, në paragrafin 6.4, është shprehur mbi shumën 5.000.000 lekë, duke e konsideruar si një shkak hipotetik ankimi, për të shmangur çdo vlerësim e paragjykim mbi çështjen, ashtu siç është kujdesur të theksojë që në paragrafin 1 të kësaj analize, se ajo nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet në asnjë moment se përmban vlerësimin e trupit gjykues mbi faktet dhe rrethanat e vlerësimit të kriterit të pasurisë.

iv. Shuma prej 5.000.000 lekësh nuk është përmendur e as zhvilluar si shkak ankimi apo si pretendim, jo vetëm në ankim, por as në parashtrimet fillestare të Komisionerit Publik, gjatë seancës gjyqësore të datës 05.04.2022. Në këtë seancë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit qartësoi pozicionin e tij lidhur me shumën 5.000.000 lekë, duke mos e konsideruar atë si pretendim të Komisionerit Publik në ankim, qëndrim ky që nuk u kundërshtua nga Komisioneri Publik në këtë seancë.

61.2 Trupi gjykues, në vijim të konstatimeve e analizës si më sipër, çmon se për të zgjidhur situatën konkrete, duhet t'u referohet dispozitave të posaçme të Kodit të Procedurës Civile, në referencë të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën parashikohet se: “Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji” dhe nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, konkretisht ku parashikohet se: “Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.”

Në mbështetje të parashikimit të nenit 459 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se “1. Kur kërkimet dhe pretendimet e papranuara nga gjykata e shkallës së parë nuk përsëriten në ankim, konsiderohet sikur është hequr dorë prej tyre. 2. Në ankim nuk mund të parashtrihen kërkime të reja që nuk janë parashtruar në gjykimin në shkallë të parë”, trupi gjykues vlerësoi se Komisioneri Publik nuk mund të paraqesë një pretendim të ri gjatë gjykimit në Kolegj, nëse atë nuk e ka parashtruar në shkaqet e ankimit me anë të të cilit ka vënë në lëvizje Kolegjin. Për pasojë, trupi gjykues vendosi të mos shqyrtojë pretendimin e Komisionerit Publik, lidhur me shumën 5.000.000 lekë të deklaruar si kursim nga ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

61.3 Në këtë përfundim, trupi gjykues mbajti në konsideratë dhe qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit, në vendimin orientues nr. 17, datë 27.05.2022, sipas të cilit: [...] *vlen të theksohet se secili subjekt rivlerësimi duhet të rivlerësohet në mënyrë të pavarur jo vetëm në kriteret e figurës dhe aftësisë profesionale, të cilat janë thellësisht individuale, por edhe në kriterin e pasurisë, si një kriter që përfshin edhe persona të tjerë në marrëdhënie pronësie, persona të lidhur apo të tjerë të lidhur qofshin ata. Kolegji vlerëson se, si në rastin konkret, qenia e dy subjekteve të rivlerësimit njëkohësisht edhe bashkëshortë, si dhe pasja e pasurive të përbashkëta në objekt të shqyrtimit në proceset e tyre të rivlerësimit, nuk afekton procesin e bashkëshortit që rivlerësohet i dyti në kohë dhe nuk përbën gjë të gjykuar edhe pse kanë pasuri të përbashkëta, pasi subjektet e rivlerësimit që janë subjekt i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kanë të drejtën e një procesi rivlerësimi të pavarur, bazuar vetëm në provat që i përkasin çështjes së tyre dhe konsiderohen procese me palë të ndryshme e, për rrjedhojë, nuk përbëjnë gjë të gjykuar; bazuar në faktin se ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. {***}, datë 02.02.2021, të Komisionit, që i përkiste*

subjektit të rivlerësimit, znj. E. Ll., u shqyrtua në Kolegj njëkohësisht me ankimin objekt i këtij vendimi.

62. Në vijim të trajtimit të shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisioneri Publik, trupi gjykues vëren se në lidhje me kursimet në *cash* të deklaruara nga znj. Ll. për periudhën 2006-2010, Komisioneri Publik ka pretenduar se deklaramet periodike vjetore të pasurisë së ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, nuk mbështesin pretendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Të njëjtin qëndrim Komisioneri Publik mbajti edhe gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrimet e paraqitura në seancën gjyqësore të datës 05.06.2022, ndërsa në konkluzionet përfundimtare në seancën gjyqësore të datës 22.06.2022, Komisioneri Publik elaboroi qëndrimin e tij, duke u përqendruar vetëm në pretendime mbi kursimet në *cash*, të deklaruara nga znj. Ll. në vitin 2006, duke parashtruar se³⁷: *Për sa i përket pretendimit të subjektit mbi mënyrën e deklarimit të kursimeve "cash" nga ana e ish-bashkëshortes dhe përfshirjen e tyre në analizë financiare (për periudhën 2006-2010), Komisioneri Publik vlerëson se edhe duke i marrë në konsideratë këto pretendime, përsëri do të rezultonte pamjaftueshmëri në burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë në vitin 2016. Në konsideratë të pretendimit të subjektit se në vitin 2006, personi i lidhur me të ka realizuar kursime "cash" në shumën 960.000 lekë, nga analiza financiare e këtij viti do të rezultonte se personi i lidhur nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe këto kursime në një shumë rreth 486.000 lekë. Ky rezultat përfitohet edhe pse shuma e pretenduar nga subjekti nuk është në përputhje me deklaramet e bërë nga vetë personi i lidhur, e cila deklaron se për vitin 2006, ka kursime "cash" në vlerën 810.000 lekë. Bazuar në sa më sipër trajtuar, do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare e burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë, apartament banimi në Vlorë, dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, për rreth 5,4 milionë lekë, në vlerësim edhe të analizimit të deklarimeve vjetore të subjektit dhe personit të lidhur, mbi pakësimet e kursimeve "cash" në vitin 2012, si dhe marrë në konsideratë pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar mbi kursimet cash, të pretenduara të vitit 2006, pasi rezulton se shuma e disponuar e kursimeve "cash" për t'u përdorur për blerjen e pasurisë, apartament banimi në Vlorë, mbuluar me burime të ligjshme, në analizën e kryer nga Kolegji, do të ishte në vlerën rreth 1,7 milionë lekë.*
63. Komisioni, në vendim³⁸, lidhur me kursimet në *cash* të deklaruara nga znj. Ll., ka arsyetuar: *Komisioni, bazuar në analizimin e deklarimeve periodike të ish-bashkëshortes së subjektit, konstaton një model të njëjtë deklarimi të kursimeve të saj për periudhën 2006-2011. Ish-bashkëshortja e subjektit, në seksionin "Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme" (seksioni në të cilin deklarohen, ndër të tjera, edhe shtesat apo pakësimet e gjendjes "cash") ka deklaruar në mënyrë të njëjtë për të gjitha vitet kursimet "cash" vjetore në formën e të ardhurave, duke cilësuar dhe burimet përkatëse. Në vitin 2006, në seksionin "Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme", ajo deklaron të ardhura nga paga si gjyqtare 450.000 lekë, ndërkohë që në seksionin "Të ardhurat nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private", deklaron se të ardhurat vjetore nga paga si gjyqtare, janë 900.000 lekë, i njëjti deklarim bëhet dhe për të ardhurat si pedagoge, si dhe nga shitja e automjeteve. Këtë formë deklarimi, ish-bashkëshortja e subjektit e ka bërë për të gjitha vitet në vazhdim. Mbështetur në këtë model deklarimi të ish-bashkëshortes së subjektit, Komisioni vlerëson të pranojë shpjegimet e tij, duke pranuar që çdo e ardhur e deklaruar nga ish-bashkëshortja në seksionin "Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme", do të konsiderohet si shtim i gjendjes "cash" në vitin përkatës të deklarimit. Në lidhje me kursimet "cash" të ish-bashkëshortes, Komisioni do të përfshijë në analizën*

³⁷ Shih paragrafët 2.3.3 - 2.3.5 të konkluzioneve përfundimtare të Komisionerit Publik.

³⁸ Paragrafi 27.4.3.1 i vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit.

financiare shumën 5.000.000 lekë, të deklaruar në vitin 2004 nga ana e saj dhe shumën 2.535.000 lekë si total i kursimeve “cash” të deklaruara në vitet 2006-2012.

64. Ky vlerësim i Komisionit ka ardhur si pasojë e pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në të cilat ai ka argumentuar se: [...] kam vënë re se Komisioni nuk ka konsideruar të paktën disa kategori të kursimeve “cash” ndër vite, si më poshtë vijon: të ardhura të tjera të kursyera “cash”, të deklaruara në deklaratimet periodike vjetore për ish-bashkëshorten. Në total, për vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2010, shuma e kursimeve është në vlerën 2.335.000 lekë, ndërkohë që relacioni ka paraqitur si kursime vlerën prej 1.000.000 lekësh, me një diferencë prej 1.335.000 lekësh. Sa më sipër, kërkoj nga Komisioni që, bazuar në faktet dhe analizën e mësipërme, të konsiderojë shumën shtesë të kursimeve, në përputhje me sa më sipër. Në total, vlera shtesë e kursimeve “cash” nga të ardhurat e përcaktuara dhe të argumentuara më sipër, është në shumën totale 4.035.000 lekë. Kjo shumë e përmbys dhe e kalon në mënyrë të konsiderueshme balancën negative të konstatuar nga Komisioni, duke sjellë faktikisht një balancë pozitive të konsiderueshme. Të njëjtat pretendime, subjekti i rivlerësimit i parashtroi edhe gjatë gjyqimit në Kolegj, në prapësim të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik.
65. Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave të znj. Ll., në vitet 2006-2010, trupi gjykues vëren se znj. Ll., në vitet 2006, 2007 dhe 2008³⁹, ka deklaruar të ardhurat nga paga në dy rubrika të formularit, në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” dhe në rubrikën “Të ardhurat nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”. Për vitet 2006 dhe 2007, në secilën rubrikë janë deklaruar vlera të ndryshme, ndërsa për vitin 2008, vlerat janë deklaruar të njëjta në të dyja rubrikat e sipërcituara.

65.1 Megjithëse vëren se deklarimi i znj. Ll. në vitet 2006, 2007 dhe 2008 nuk përputhet plotësisht me parashikimet ligjore të kohës, sipas kërkesave të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, në të cilin përcaktohet se: *Subjektet e [...] këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat*

³⁹ **Në deklaratën e interesave të vitit 2006:**

Në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”:

Të ardhura nga paga si gjyqtare. Vlera 450.000 lekë.

Të ardhura si pedagoge e Fakultetit {***}. Vlera 360.000 lekë.

Të ardhura nga shitja e automjetit, tip “Fiat Punto”. Vlera 400.000 lekë.

Automjet, tip “Opel Joy Corsa”. Vlera 250.000 lekë.

Në rubrikën “Të ardhurat nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”:

Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtare. Vlera 900.000 lekë.

Të ardhura nga paga mujore si pedagoge në Fakultetin {***}. Vlera 45.000 lekë/muaj.

Në deklaratën e interesave të vitit 2007:

Në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”:

Të ardhura nga paga si gjyqtare. Vlera 150.000 lekë.

Të ardhura nga paga si pedagoge e Fakultetit jopublik {***}. Vlera 300.000 lekë.

Në rubrikën “Të ardhurat nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”:

Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtare [...]. Vlera 825.442 lekë.

Të ardhura nga paga mujore si pedagoge, janar – korrik, 45.000 lekë/muaj, nëntor - dhjetor 15.000 lekë/muaj.

Në deklaratën e interesave të vitit 2008:

Në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”:

Të ardhura nga paga si gjyqtare 819.755 lekë/vit. Vlera 200.000 lekë.

Të ardhura si pedagoge e Fakultetit {***}, vetëm muajt janar - shkurt. Vlera 25.000 lekë.

Në rubrikën “Të ardhurat nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”:

Të ardhura nga paga si gjyqtare 819.755 lekë/vit. Vlera 200.000 lekë.

Të ardhura si pedagoge e Fakultetit {***}, vetëm muajt janar - shkurt. Vlera 25.000 lekë.

reale mbi to; [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në “cash”, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...], trupi gjykues vlerësoi të bëjë verifikimin e deklarimeve sipas të dhënave të pasqyruara nga znj. Ll. në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, krahasuar me linjën logjike që ka ndjekur dhe arsyetimi i Komisionit në vendim, për sa kohë që pavarësisht paqartësisë konsekuente në deklaram, znj. Ll. ka përshkruar ekzistencën e këtyre kursimeve dhe burimet e krijimit të tyre. Mbi këtë bazë vlerësimi, trupi gjykues verifikoi edhe mundësinë e znj. Ll. që me burime të ligjshme, të krijonte shumat e deklaruara si të kursyera.

65.2 *Për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka pretenduar se kursimet në cash të znj. Ll. janë në shumën totale prej 960.000 lekësh, të përbëra nga kursimet nga pagat dhe të ardhurat e siguruar nga diferenca e përfituar nga shitja dhe blerja e automjeteve, ashtu siç ajo ka deklaruar në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”. Komisioneri Publik, gjatë gjykimit në Kolegj, ka pretenduar se, në konsideratë të pretendimit të subjektit se në vitin 2006, personi i lidhur me të ka realizuar kursime “cash” në shumën 960.000 lekë, nga analiza financiare e këtij viti do të rezultonte se personi i lidhur nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe këto kursime në një shumë rreth -486.000 lekësh. Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të mësipërme, vlerësoi të konsiderojë si kursime në cash të znj. Ll., vetëm shumat e deklaruara me burim krijimi nga paga si gjyqtare dhe nga të ardhurat e përfituara si pedagoge në universitetin “{***}”, ndërsa nuk konsideroi të ardhurat e përfituara nga shitblerja e automjeteve, pasi krijoi bindjen se deklarimi i znj. Ll. për to, ka pasur si qëllim evidentimin e ndryshimeve të ndodhura në pasuritë automjete, dhe jo deklaramin e tyre si kursime, pasi nëse do të ishte kështu, do të duhej të kishte pasqyruar në formën e të ardhurës edhe shumën e mbetur si diferencë nga shitblerja e pasurive. Përpos sa më sipër, në këtë përfundim, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe vetë qëndrimin e znj. Ll. në lidhje me kursimet në cash për periudhën 2006-2010, e cila gjatë gjykimit⁴⁰ të çështjes së saj në Kolegj, nuk e pretendoi si kursim në cash për vitin 2006, të ardhurën e mbetur si diferencë nga shitblerja e automjeteve.*

65.2.1 *Në verifikim të burimeve të krijimit të kursimeve në cash të znj. Ll. për vitin 2006, trupi gjykues, duke ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi si në rastin e subjektit të rivlerësimit, verifikoi të ardhurat e përfituara nga znj. Ll., nga puna si pedagoge në Universitetin {***}. Edhe në rastin e znj. Ll., trupi gjykues vëren mospërputhje të shumës së të ardhurave të përfituara nga punësimi në Universitetin {***}, deklaruar nga znj. Ll. në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, me atë të deklaruar në deklaratat periodike vjetore, si dhe mënyrës së përshkrimit të këtyre të ardhurave në dokumentacionin justifikues, të përcjellë nga Universiteti {***}. Vërtetimi, datë 26.10.2016, i Universitetit {***}, paraqitur nga znj. Ll. bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit, pasqyron të ardhurat *neto*, për periudhën janar 2004 - dhjetor 2008, në shumën totale 774.360 lekë, por nuk pasqyron në mënyrë analitike të ardhurat vjetore. Edhe në vërtetimin nr. {***} prot., datë 16.12.2019, Universiteti {***} ka saktësuar vetëm periudhën e punësimit të znj. Ll., e cila ka qenë tetor 2003 - dhjetor 2008, por të pashoqëruar me shumën e të ardhurave të përfituara në secilin vit.*

*Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë në Komision nga Banka Intesa San Paolo, rezultoi se në vitin 2007, ka kaluar në llogarinë e znj. Ll. shuma 45.990 lekë, me përshkrimin Fakulteti {***}, paga si pedagoge e jashtme. Me po të njëjtin përshkrim, në vitin 2008, ka kaluar shuma 22.320 lekë.*

⁴⁰ Në faqen 36 të konkluzioneve përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, znj. E. Ll..

Bazuar në vlerën totale të të ardhurave prej 774.360 lekësh, si dhe në shumat e pagave të kaluara nëpërmjet sistemit bankar për vitet 2007 e 2008 në shumën 68.310 lekë, u krye shpërndarja e thjeshtë matematikore e vlerës së mbetur, për vitet 2003, 2004, 2005 e 2006, [774.360 lekë – 68.310 lekë = 706.050 lekë/ 3 vite = 235.350 lekë/ vit]. Sipas kësaj shpërndarjeje, rezultoi se znj. Ll. ka përfituar nga Universiteti {***}, për vitin 2006, shumën 235.350 lekë.

Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se kursimet në *cash* të znj. Ll. për vitin 2006, janë në shumën 685.350 lekë, si shumatore e kursimeve prej 450.000 lekësh të kursyera nga paga si gjyqtare + 235.350 lekë të kursyera nga paga si pedagogë në Universitetin {***}. Trupi gjykues arriti në këtë përfundim, pasi mbajti në konsideratë rezultatin pozitiv të analizës financiare për vitin 2006, i cili tregoi se znj. Ll. kishte mundësi të krijonte këto kursime me burimet e ligjshme të deklaruara.

65.3 *Për vitin 2007*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, se kursimet në *cash* të znj. Ll., janë në shumën totale prej 450.000 lekësh, të përbëra nga kursimet nga paga si gjyqtare dhe të ardhurat si pedagogë në Universitetin {***}, ndërsa *për vitin 2008*, ka pretenduar kursime në *cash* në shumën 225.000 lekë, të përbëra nga kursime nga paga si gjyqtar dhe të ardhurat si pedagogë në Universitetin {***}. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, në ndjekje të së njëjtës linjë arsyetimi si për vitin 2006, konsideroi si kursim *cash* për vitin 2007, shumën 195.990 lekë, si shumatore të vlerave 150.000 lekë kursime nga paga si gjyqtare dhe 45.990 lekë nga kursimi i pagës si pedagogë në Universitetin {***} [shumë kjo e përfituar nëpërmjet sistemit bankar]. Për vitin 2008, u konsiderua si kursim *cash* shuma 222.320 lekë, si shumatore e vlerave 200.000 lekë kursime nga paga si gjyqtare dhe 22.320 lekë nga kursimi i pagës si pedagogë në Universitetin {***}, kaluar nëpërmjet sistemit bankar. Trupi gjykues arriti në këtë përfundim, pasi nga analiza financiare për vitet 2007 dhe 2008, rezultoi se znj. Ll. mund të krijonte këto kursime me burimet e ligjshme të deklaruara.

65.4 *Për vitin 2010*, trupi gjykues vëren se znj. Ll. nuk ka deklaruar ndryshime të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme. *Për vitin 2010*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, se kursimet në *cash* të znj. Ll. janë në shumën totale prej 700.000 lekësh, të përbëra nga kursimet nga paga si gjyqtare dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e një automjeti. Trupi gjykues vëren se znj. Ll., në deklaratën e këtij viti⁴¹, ka deklaruar kursimet në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit nr. 9049/2003. Për pasojë, konsideroi si kursim në *cash* vetëm shumën prej 200.000 lekësh, e deklaruar si kursim me burim krijimi nga paga si gjyqtare, ndërsa nuk konsideroi si kursim të ardhurat e përfituara nga shitja e një automjeti në shumën 500.000 lekë, pasi krijoi bindjen se deklarimi i znj. Ll. për këto të ardhura, ka pasur si qëllim evidentimin e ndryshimit të ndodhur në lidhje me pasurinë automjet dhe jo deklarimin si kursim të shumës së përfituar. Në konsiderimin si kursim të shumës prej 200.000 lekësh, trupi gjykues u mbështet në rezultatin e analizës financiare për vitin 2010, nga i cili rezultoi se znj. Ll. mund të krijonte këto kursime, me burimet e ligjshme të deklaruara. Përpos sa më sipër, në këtë përfundim, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe vetë qëndrimin e znj. Ll. në lidhje me kursimet në *cash* për periudhën 2006-2010, e cila gjatë gjykimit⁴² të çështjes së saj në Kolegj, nuk e pretendoi si kursim në *cash* për vitin 2006, të ardhurën e përfituar nga shitja e automjetit.

⁴¹ Në deklaratën e interesave të vitit 2010, në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, znj. Ll. ka deklaruar: “Kursyer nga paga si gjyqtare. Vlera 200.000 lekë. Përfituar të ardhura nga shitja e automjetit “Opel Corsa”. Vlera 500.000 lekë.

⁴² Në faqen 39 të konkluzioneve përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, znj. E. Ll..

65.5 Në përfundim të këtij arsyetimi, trupi gjykues konstatoi se kursimet në *cash* të znj. Ll., të krijuara nga burime të ligjshme, për periudhën 2006-2010, kanë qenë në shumën totale 1.303.660 lekë.

66. Në përmbledhje të arsyetimit të bërë si më sipër, kursimet e znj. Ll., të akumuluar për periudhën 2004-2010, rezultuan në shumën 6.303.660 lekë, përfshirë këtu dhe shumën prej 5.000.000 lekësh, të deklaruar në deklarin për herë të parë në vitin 2004, e cila u konsiderua e krijuar me burime të ligjshme, për sa kohë që ajo nuk ishte kundërshtuar nga Komisioneri Publik, ndërsa kursimet e subjektit të rivlerësimit, deri në fund të vitit 2011, konsiderohen në shumën totale prej 2.316.842 lekësh. Ky konkluzion do të jetë i përdorshëm, sërish, prej trupit gjykues, në vijim të analizës për zgjidhjen e çështjes.
67. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të pretendimeve e Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit, vlerësoi ndikimin e konkluzioneve të arritura si më sipër, në analizën financiare të kryer deri në datën 09.09.2016, datë e kryerjes së pagesës për blerjen e pagesës së pasurisë, apartament me sipërfaqe 126,5 m², në Vlorë. Në këtë analizë, në kuadër të vlerësimit të burimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja e tij për krijimin e kësaj pasurie – kursimet në vite – trupi gjykues përfshiu edhe kursimet e deklaruara në *cash* në deklaratat periodike të interesave për vitet 2012 e në vazhdim nga subjekti i rivlerësimit, pasi verifikoi se ai kishte mundësi t'i krijonte ato në shumën e deklaruara, në kuadër të kontrollit me qëllim zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë dhe faktin se Komisioneri Publik, në ankim, mbështetur mbi rekomandimin e vëzhguesve ndërkombëtarë, por edhe gjatë gjykimit në Kolegj, nuk paraqiti pretendime kundërshtuese për kursimet e periudhës në fjalë, mbi vlerësimin ose jo të tyre si të ardhura të ligjshme, në kuptim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore.
68. Në vijim të sa më sipër, nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave të subjektit të rivlerësimit dhe znj. Ll., rezultojnë të jenë deklaruar kursimet në *cash* si më poshtë:
Në vitin 2011, znj. Ll. ka deklaruar kursime shtesë nga paga si gjyqtare, në shumën 200.000 lekë.
Në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit dhe znj. Ll. kanë lidhur martesë dhe, për këtë shkak, kanë deklaruar si persona të lidhur. Deklarimet e tyre përputhen në lidhje me kursimet e deklaruara në *cash*. Për këtë vit, kursimet në *cash* të tyre janë pakësuar në shumën 1.359.056 lekë, si pasojë e blerjes së automjetit tip “Citroen C4”.
Në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit dhe znj. Ll. nuk kanë deklaruar shtesa apo pakësime të kursimeve në *cash*.
Në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit dhe znj. Ll. kanë deklaruar shtesë të kursimeve në *cash*, në shumën 300.000 lekë.
Në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit dhe znj. Ll. kanë deklaruar *pakësim të kursimeve në “cash” të mbledhura ndër vite*, në shumën 800.000 lekë.
69. Si rrjedhojë e konstatimeve si më sipër, por edhe konkluzionit të arritur në paragrafin 68 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerësoi se shuma e kursimeve të akumuluar në *cash*, të disponuara nga subjekti i rivlerësimit dhe znj. E. Ll., në fillim të vitit 2011, ishte në shumën 6.961.446 lekë⁴³. Kjo vlerë e kursimeve në *cash*, u përdor në kryerjen e analizës financiare për verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur që, me burime të ligjshme, të kryenin pagesën e pasurisë, apartament me sipërfaqe 125 m² në Vlorë, në datë 09.09.2016, në shumën 7.615.223 lekë. Nga analiza financiare, rezultoi një balancë negative prej 662.373 lekësh. Për pasojë, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i

⁴³ Përfshirë këtu dhe shumën prej 5.000.000 lekësh, të deklaruar nga personi i lidhur, znj. E. Ll., në deklarin për herë të parë në vitin 2004, e cila u konsiderua e krijuar me burime të ligjshme.

lidhur ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

70. Pavarësisht këtij konstatimi, trupi gjykues vlerësoi se kjo mungesë nuk mund të konsiderohet se shërben për t’u kualifikuar si deklarim i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin se vlera e mungesës së burimeve zë një peshë krahasimisht të vogël në raport me vlerën e blerjes së pasurisë objekt kontrolli, si dhe faktin se nga analiza financiare e kryer për çdo vit, rezultojnë balanca pozitive të të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera, përveç vitit 2016, si më sipër evidentuar.
71. Në lidhje me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, i cili në tërësinë e tij ka të bëjë me rivlerësimin e fakteve dhe rrethanave mbi burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë automjet, tip “Audi Q7”, në pronësi të shtetasit R. H. dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.
72. Komisioni në vendim, në përfundim të kontrollit e vlerësimit të kësaj pasurie, ka arsyetuar: *Nga analiza financiare, rezulton se babai i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti. Komisioni ka mbajtur në konsideratë faktin që kjo analizë i përket babait të subjektit, i cili, si ai, ashtu edhe familjarët e tij, nuk kanë qenë subjekte deklaruese dhe, për rrjedhojë, nuk kanë pasur detyrimin e deklarimit të të ardhurave, si dhe faktin që në mungesë të të dhënave të plota, ka qenë objektivisht e pamundur për të kryer një analizë të saktë dhe të mirëfilltë të gjendjes së tyre financiare.*
73. Komisioneri Publik, në ankim dhe në parashtrime gjatë gjykimit në Kolegj, ka kundërshtuar përfundimin si më sipër të Komisionit, duke argumentuar se rivlerësimi i fakteve dhe i rrethanave mbi burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë automjet, tip “Audi Q7”, në pronësi të shtetasit R. H. dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit, përdorimi dhe përgjegjësia fizike e të cilit i kaloi subjektit të rivlerësimit një javë pas nxjerrjes së lejes së qarkullimit, çmohet i nevojshëm, pasi eventualisht, nga kjo situatë faktike, duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë pronari *de facto* i këtij aseti, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.
74. Në kundërshtimin e këtij shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij para Kolegjit, pretendoi se u qëndron shpjegimeve që ka paraqitur gjatë hetimit administrativ në Komision, duke argumentuar, në mënyrë të përmbledhur, se pretendimi i Komisionerit Publik është i pabazuar në prova dhe në ligj, pasi për këtë pasuri, ai ka pasur vetëm të drejtën e përdorimit. Automjeti është përdorur nga subjekti vetëm për udhëtime jashtë vendit, në shumicën e rasteve me fëmijët e tij të mitur, në kuadër të marrëdhënieve të posaçme prindër-fëmijë. Blerja e automjetit nga babai i tij, si dhe marrja e huave për të njëjtin qëllim është bërë nëpërmjet disa transaksioneve bankare, veprime këto të kryera 5 vjet përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se, bazuar në nenet 30 e 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka detyrimin për të deklaruar dhe provuar ligjshmërinë e të ardhurave të prindërve të tij, të cilat kanë shërbyer për krijimin e automjetit, tip “Audi”, pasi në këtë rast ata nuk konsiderohen persona të lidhur apo persona të tjerë të lidhur, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit. Në shqyrtim të pretendimit të Komisionerit Publik, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, vlerësoi pretendimet e Komisionerit Publik mbi situatën faktike, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi, konstatoi si më poshtë.
 - 74.1 Në datën 20.04.2011, z. R. H., babai i subjekti të rivlerësimit, ka blerë automjetin, tip “Audi Q7”, nga z. B. B. në ShBA, në shumën 37.000 USD, siç rezulton nga të dhënat e përcjella

në Komision nga DPSHTRr-ja⁴⁴. Sipas këtyre të dhënave, z. R. H. ka pasur të regjistruar vetëm automjetin, tip “Audi”, me targë {***}.

74.2 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së z. R. H. në Tirana Bank, rezultoi se janë kryer këto lëvizje:

Në datën 25.04.2011, z. R. H. ka depozituar shumën 15.000 USD.

Në datën 25.04.2011, z. R. H. i është transferuar shuma 12.102 USD nga z. A. H., me përshkrimin: “Borxh për blerjen e makinës”.

Në datën 25.04.2011, z. R. H. i është transferuar shuma 10.000 USD nga znj. M. B., me përshkrimin: “Borxh për blerje makine”.

Në datën 25.04.2011, z. R. H. ka transferuar shumën 37.000 USD në llogari të z. B. dhe znj. M. B. (shitësit e automjetit në ShBA).

74.3 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: *Automjet, tip “Audi”, me targë {***}, në pronësi të babait tim R. H., në përdorim nga unë, sipas kontratës së huapërdorjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2011, redaktuar nga notere M. Ç., Tiranë.* Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur kontratën e huapërdorjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2011, sipas së cilës z. R. H., automjetin, tip “Audi Q7”, ia lë në përdorim huapërdoruesit Gerd Hoxha, për një afat kohor të papërcaktuar, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

74.4 Nga të dhënat e policave të sigurimit, ka rezultuar se z. R. H. ka paguar policat e sigurimit për automjetin, tip “Audi Q7”, edhe për subjektin i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorten e tij, znj. E. Ll., për periudha të ndryshme gjatë viteve 2011-2017.

74.5 Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 12.09.2020, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, shtetasit R. dhe A. H., ndër të tjera, kanë deklaruar: *Sipas kontratës së huapërdorjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2011, rezulton se automjeti është përdorur nga djali im, z. Gerd Hoxha, dhe nga ish-bashkëshortja e tij, znj. E. Ll., kryesisht, vetëm për udhëtimet jashtë shtetit. Përdorimi i automjetit jashtë shtetit kërkonte patjetër një “autorizim” nga pronari apo kontratë huapërdorjeje, përndryshe nuk mund të kaloje kufirin shtetëror. Arsyeja e përdorimit jashtë shtetit ka qenë se automjeti ishte më i sigurt nga pikëpamja teknike dhe në atë kohë, ata nuk dispononin automjet. Edhe pasi ata blenë automjetin e tyre, ata vazhduan ta përdorin automjetin në pronësinë time për udhëtime jashtë shtetit, për shkak të sigurisë që ofronte, pasi kanë udhëtuar dhe me fëmijët e tyre të mitur.*

74.6 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve drejtuar nga Komisioni⁴⁵, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *[...] Gjatë shtatë viteve të fundit (2011 – 2017), kam pasur në përdorim së bashku me bashkëshorten time, znj. E. Ll., automjetin e babait tim, z. R. H., tip “Audi”, me targa {***}. Ky automjet është përdorur nga ne vetëm për udhëtimet jashtë vendit me makinë dhe aktualisht është shitur nga z. R. H., dhe nuk është më në pronësi të tij. [...] Automjeti tip “Audi”, me targë {***}, është blerë nga im atë, z. R. H., nga shitësi, z. B. B., qytetar i ShBA-së, në shumën USD 37.000,00, sipas kontratës së datës 20.04.2011. Detyrimet doganore, AUT, TVSH të paguara nga z. R. H., janë në shumën 932.091 lekë. [...] Nuk ka asnjë provë apo asnjë arsye që të vërtetojë, se im atë nuk e ka përdorur këtë automjet. Përdorimi nga ana ime i këtij automjeti ka qenë sporadik, vetëm për udhëtime jashtë shtetit (pak herë në vit) dhe jo për përdorim të përditshëm. Theksoj se në asnjë rresht të deklarimeve të mia, nuk kam thënë se automjeti, tip “Audi”, me targë {***}, është në përdorimin tim të përditshëm. Sipas*

⁴⁴ Dosja e automjetit, tip “Audi”, është pëcjellë në Komision nga DShTRr-ja, me shkresat nr. {***} prot., datë 25.02.2019 dhe nr. {***} prot., datë 01.03.2019.

⁴⁵ Në përgjigje të pyetësorit standard, si dhe në përgjigje të pyetësorit, datë 06.08.2020, të drejtuar nga Komisioni.

të gjitha deklarimeve para ILDKPKI-së dhe në deklaratën “vetting”, të bëra nga unë dhe ish-bashkëshortja ime, znj. E. Ll., lidhur me përdorimin e këtij automjeti sipas “Kontratës së huapërdorjes” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2011, rezulton se është përdorur nga ne vetëm për udhëtimet jashtë shtetit. Përdorimi i automjetit jashtë shtetit kërkonte patjetër një “autorizim” nga pronari apo kontratë huapërdorjeje, përndryshe nuk mund të kaloje kufirin shtetëror. Arsyeya e përdorimit jashtë shtetit ka qenë se automjeti ishte më i sigurt nga pikëpamja teknike dhe ne në atë kohë, nuk dispononim automjet. Në muajin gusht 2012, unë dhe ish-bashkëshortja ime kemi blerë me anë të kontratës së qirasë financiare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.08.2012, automjetin tip “Citroen”, me targë {***}, të cilin unë e kam përdorur edhe për udhëtime jashtë shtetit. Por, automjetin, tip “Audi”, në pronësi të babait tim, z. R. H., me sa më kujtohet, kemi vazhduar ta përdorim edhe disa herë të tjera për udhëtime jashtë shtetit, për shkak të sigurisë që ofronte, pasi kemi udhëtuar edhe me fëmijët tanë të mitur. Më rezulton se im atë nuk ka pasur në pronësi asnjë automjet tjetër në atë periudhë dhe ka vijuar ta përdorë për nevojat e tij automjetin me targë {***}, derisa e ka shitur automjetin me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.07.2018.

75. Në shqyrtim të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues, në kuadër të arritjes së një vendimi të drejtë dhe objektiv lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit duket se ka qenë pronari *de facto* i automjetit, tip “Audi”, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës⁴⁶, pasi mori në konsideratë se:

i. përdorimi i automjetit në pronësi të babait të tij është regjistruar në regjistrat publikë, sipas kontratës së huapërdorjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2011, redaktuar nga noterja publike M. Ç.;

ii. subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të drejtën e përdorimit të automjetit në pronësi të babait të tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në mënyrë të plotë e të saktë, duke përmbushur detyrimin për deklarim, sipas kërkesave të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kërkesave të formularit të deklarimit të pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit;

iii. pagesa për blerjen e automjetit është kryer nga z. R. H. me transfertë bankare transferuar shumën 37.000 USD në llogari të z. B. dhe znj. M. B., shitësit e automjetit në ShBA;

iv. z. R. H., babai i subjektit të rivlerësimit, huan për blerjen e automjetit, në vitin 2011, e ka marrë në rrugë bankare nga z. A. H. dhe znj. M. B., me përshkrim të transfertës bankare “për blerjen e makinës”, ashtu siç verifikohet edhe nga të dhënat e llogarisë së tij bankare;

v. z. R. H., në kohën e blerjes së automjetit tip “Audi” nuk pasur automjet tjetër në pronësi, siç është konfirmuar edhe nga të dhënat e përcjella në Komision nga DPSHTRr-ja;

vi. fakti se automjeti është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit me anë të kontratës së blerjes, datë 20.04.2011, është regjistruar në emër të tij më datë 01.07.2011 dhe në datë 07.07.2011, i është dhënë në përdorim edhe subjektit të rivlerësimit, nuk mund të shërbejë si rrethanë për të ngritur një dyshim të arsyeshëm se kjo pasuri i përket *de facto* subjektit të rivlerësimit. Ky vlerësim është bazuar në kontekstin e marrëdhënies së posaçme prind-fëmijë, mes babait e djalit, i cili natyrshëm justifikon dhënien në përdorim të automjetit;

vii. automjeti është përdorur nga subjekti i rivlerësimit për udhëtimet familjare jashtë shtetit. Sipas të dhënave të sistemit TIMS, rezultoi se subjekti i rivlerësimit bashkë me familjen e tij, në harkun kohor prej 5 vjetësh, ka kryer rreth 24 udhëtime jashtë vendit me këtë mjet;

viii. nga aktet e hetimit administrativ, nuk rezultoi dokumentacion provues se ky automjet është përdorur nga subjekti i rivlerësimit edhe për udhëtime brenda vendit. Pajisja me policë sigurimi nuk mund të shërbejë si rrethanë e vetme, për të provuar se automjeti është përdorur

⁴⁶ Neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “5.[...]. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

në mënyrë permanente brenda vendit, pasi pajisja me të është domosdoshmëri për udhëtimet jashtë vendit, por edhe për pjesën e udhëtimit brenda vendit, nga vendbanimi deri në pikën e kalimit kufitar;

ix. subjekti i rivlerësimit ka pasur automjete në pronësi – deri në datë 29.10.2011, ka pasur në pronësi automjetin tip “Daimler Chrysler” dhe më datë 16.08.2012, së bashku me bashkëshorten, kanë blerë automjetin tip “Citroen”;

x. nga të dhënat e policës së sigurimit, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e përdoruesit të mjetit;

xi. në datën 28.03.2014, subjekti i rivlerësimit ka derdhur shumën prej 254.170 lekësh në llogari të “{***}” ShPK, me përshkrimin: “Gerd Hoxha derdh në llogari të “{***}” ShPK shërbime për makinë – automjet për R. H.”⁴⁷, duke treguar kujdes në evidentimin se pagesa është kryer për llogari të z. R. H., babait të tij;

xii. z. R. H. ka shitur automjetin, tip “Audi”, me anë të kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.07.2018, në shumën 15.000 euro, shumë e cila, sipas deklaramentit të palëve në këtë kontratë, do të likuidohet nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria e blerësit të llogaria e shitësit. Nga verifikimi i të dhënave bankare të llogarisë së z. R. H. në BKT, rezultojnë se në datë 13.08.2018, është derdhur shuma prej 14.960 eurosh, shumë e cila ka vazhduar të qëndrojë në këtë llogari, të paktën deri më 08.03.2019, datë e përcjelljes së informacionit të të dhënave bankare të z. R. H., nga BKT-ja në Komision;

xiii. subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja e tij, znj. E. Ll., nuk kanë gjykuar çështje me palë pjesëmarrëse në gjykim z. A. H. dhe znj. M. B., të cilët i kanë dhënë huan z. R. H. për blerjen e automjetit, sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë

– arriti në përfundimin se, për shkak të fakteve dhe rrethanave specifike si më sipër trajtuar, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit konsiderohen të besueshme dhe bindëse, për sa kohë e gjithë dinamika e veprimeve të kryera nga babai i tij në lidhje me këtë pasuri, e shpërndan subjektin e rivlerësimit nga marrëdhëniet e pronësisë me këtë send. Për rrjedhojë, trupi gjyqësor vlerësoi se nuk u verifikuan e provuan fakte apo rrethana që mund të ngrenë dyshime të arsyeshme për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurisë në përdorim të subjektit të rivlerësimit, të cilat do ta vendosnin atë në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, duke e gjetur të pabazuar pretendimin e Komisionerit Publik për të kundërtën.

76. Në analizë të marrëdhënies së përdorimit të automjetit, tip “Audi”, nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjyqësor vlerëson se Komisioni dhe Komisioneri Publik kanë konstatuar saktë ekzistencën e një marrëdhënieje përdorimi të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 2011-2016, por nuk i kanë dhënë një kualifikim kësaj marrëdhënieje, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që do të çonte subjektin e rivlerësimit në detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, sipas këtij parashikimi ligjor. Trupi gjyqësor vëren se Komisioneri Publik, në ankim dhe në parashtrimet gjatë gjyqimit në Kolegj, kërkimin e tij për rivlerësim të fakteve dhe rrethanave mbi burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë automjet, tip “Audi”, në përdorim, e ka mbështetur në pretendimin se eventualisht, subjekti i rivlerësimit ka qenë pronari *de facto* i kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Në shqyrtim e analizë të këtij shkakimi, trupi gjyqësor çmoi të marrë në konsideratë jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, lidhur me

⁴⁷ Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se pagesa nga ana e tij, është bërë për lehtësi veprimi, në kuadrin e marrëdhënies babë-bir. Shuma e parave të paguara nga ai i është dhënë nga babai, z. R.H., për t'i derdhur në llogarinë e “{***}” ShPK, për likuidimin e një tarife shërbimesh për makinë e tij me targë {***}. Ky fakt është shënuar nga ai gjatë kryerjes së këtij veprimi.

detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të prindërve në përdorim të tyre, argument ky i sjellë në mbështetje të pretendimeve të tij edhe nga subjekti i rivlerësimit gjatë parashtrimeve në Kolegj. Në vendimin nr. 7, datë 24.06.2020, në paragrafin 94 të tij [e në vendime të tjera⁴⁸], Kolegji ka arsyetuar se: *lidhur me përdorimin prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, të apartamentit të babait të tij, z. M. K., pa pagesë qiraje, trupi gjykues, edhe pse mban në konsideratë faktin që mbështetja që i është dhënë subjektit të rivlerësimit nga babai i tij, z. M. K., si më sipër, mund të trajtohej teorikisht si një përfitim monetar (shumë e pashpenzuar për qëllime qiraje banimi) dhe, si rrjedhojë, do të mund të vendoste palët në një marrëdhënie interesi pasuror sipas parashikimeve të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se nëse gjatë kontrollit të kësaj pasurie, nuk arrihet në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasurinë (duke qenë se për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare, dyshimi për konflikt të mundshëm interesi nuk ekziston), atribuimi i mungesës së burimeve të ligjshme të babait të subjektit, për të justifikuar krijimin e pasurisë së paluajtshme, apartament me sip. 135 m² dhe dy garazhe me sip. 18 m², subjektit të rivlerësimit, në kuadër të lidhjes që ekziston mes tyre për përdorim të përbashkët të banesës, pa qira, do të tejkalonte objektin e procesit të rivlerësimit.*

77. Mbështetur në përfundimin e arritur në paragrafin 75, më sipër në këtë vendim, se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës në raport me pasurinë automjet, tip “Audi Q7”, në pronësi të babait të tij, trupi gjykues vlerësoi se përdorimi i kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, si një marrëdhënie huapërdorjeje, del jashtë kategorisë së marrëdhënieve të cilat do ta vendosnin babain e subjektit në statusin e personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, ky fakt nuk mund të ngarkojë subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë në përdorim, pasi do të tejkalonte objektin e procesit të rivlerësimit.

78. Pavarësisht se trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë automjet tip “Audi” në përdorim të tij, me qëllim shterimin e shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, vendosi të verifikojë shkakun e ankimit të Komisionerit Publik lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për të blerë këtë pasuri, në vitin 2011.

78.1 Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se Komisioni në vendim, lidhur me justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të këtij apartamenti, ka kryer analizën financiare të babait të subjektit të rivlerësimit, duke përfshirë në të të ardhurat e krijuara nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ato të krijuara nga motrat e tij, znj. I. H. dhe znj. P. H., sipas përbërjes familjare në vite⁴⁹, si dhe në zërin e shpenzimeve janë përfshirë edhe shpenzimet e evidentuara për krijimin e pasurive të tjera nga babai i subjektit të rivlerësimit.

78.2 Në kundërshtim të analizës financiare të kryer nga Komisioni, Komisioneri Publik ka pretenduar se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të motrës së tij, znj. I. H., nuk duhen të përfshiheshin në mesin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, babait të tij, për blerjen e pasurisë automjet, tip “Audi”, referuar deklarimeve të z. R. dhe znj. A. H., si dhe

⁴⁸ Vendimet e Kolegjit nr. 8/2020 (JR), datë 25.06.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka; nr. 21/2020 (JR), datë 10.09.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Roland Jaupaj; nr. 4/2021 (JR), datë 09.02.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Eugen Beçi; nr. 24/2021 (JR), datë 28.07.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Luan Hasneziri dhe nr. 10/2022 (JR), datë 14.04.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Patri Islamaj etj.

⁴⁹ Znj. I. H. është larguar nga trangu familjar në vitin 2010, ndërsa znj. P. H. në vitin 2012.

deklarimeve e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi kursimet e deklaruara deri në fund të vitit 2003.

78.3 Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar pretendimin e Komisionerit Publik si të pabazuar, duke argumentuar se Komisioneri Publik ka interpretuar gabim deklaratimet e prindërve të tij, pasi vërtet ata janë shprehur se kanë mbuluar shpenzimet e fëmijëve të tyre, duke i lejuar ata të kursenin sa më shumë, por kjo nuk ka nënkuptuar që fëmijët tashmë të punësuar të mos kontribuonin në familje për shpenzimet vetjake. Pjesën tjetër të të ardhurave secili nga fëmijët e ka kursyer, në shumat e deklaruara në deklaratat periodike të interesave. Për këtë arsye, në analizën financiare të kryer për të verifikuar mundësinë e krijimit të pasurisë automjet, tip “Audi Q7”, duhet të përfshihen të ardhurat e tij dhe të dy motrave të tij, znj. P. P. dhe znj. I. K., pasi ata, në periudhën e krijimit të pasurisë, kanë qenë pjesëtarë të trungut familjar.

79. Për të konkluduar, në lidhje me mundësinë financiare të babait të subjektit, në cilësinë e kryefamiljarit, trupi gjykoes analizoi shkaqet e ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet shkresore në cilësinë e provës të administruara në këtë çështje, duke konstatuar se:

79.1 Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.09.2020, z. R. e znj. A. H. kanë deklaruar se: *Më datë 06.09.2010, znj. I. H. ka lidhur martesë dhe është shkëputur trung më vete. Më datë 02.03.2011, z. Gerd Hoxha është shkëputur nga trungu familjar dhe ka dalë trung më vete. Më datë 10.05.2012, znj. P. H. është shkëputur trung më vete. Deri në periudhën e shkëputjes së secilit prej fëmijëve tanë, ekonomia familjare ka qenë e përbashkët. [...] Fëmijët tanë kanë ndjekur shkollën e lartë dhe specializimet përkatëse pas përfundimit të saj. Për pasojë, shpenzimet e tyre (fjetje, ushqim, mjete shkollore etj.) përballoheshin nga ne të dy, duke i lejuar që të kursenin sa më shumë të ardhura nga punësimi i tyre në punë të ndryshme gjatë periudhës së shkollës dhe më pas, me qëllim përdorimin e këtyre të ardhurave në momentin e daljes si familje më vete të secilit prej tyre. [...] Referuar z. Gerd Hoxha, deklarojmë se ai ka punuar në punë të ndryshme, nga periudha 1995 deri 2000. Deri në muajin nëntor të vitit 2003, shpenzimet e tij përballoheshin nga ne. [...] deri në muajin shtator 2010, shpenzimet e vajzës sonë, znj. I. H., përballoheshin nga ne prindërit. Znj. I. H. ka siguruar të ardhura nga puna e saj në sektorë privatë e shtetërorë, si më poshtë vijon [...]. Deri në muajin maj 2012, shpenzimet e vajzës sonë, znj. P. H. përballoheshin nga ne prindërit. Znj. P. H. ka siguruar të ardhura nga puna e saj në sektorë privatë e shtetërorë, si më poshtë [...]. Deklarojmë se të ardhurat tona ndër vite kanë qenë më se të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës, sigurimin e apartamentit të banimit dhe automjetit dhe përbëhen nga të ardhurat tona të fituara me punë, që prej fillimit të marrëdhënieve të punës në vitin 1973, sipas dokumentacionit përkatës, si vijon [...].*

79.2 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, lidhur me mundësinë financiare të babait të tij për të krijuar këtë pasuri, subjekti ka deklaruar: *Konkretisht, në tabelën dhe analizën e Komisionit mungojnë dhe nuk janë përfshirë të ardhurat e ligjshme dhe të tatuara të motrës sime I. H. për periudhën 2006 – dhjetor 2010, periudhë në të cilën ajo ka qenë pjesë e trungut familjar, në shumën prej 2.079.124 lekësh, të ardhurat e ligjshme dhe të tatuara të motrës sime P. H. (P.) në shumën prej 409.860 lekësh, për sa kohë ajo ka qenë pjesë e trungut familjar të familjes së tim eti. Vlera totale e të ardhurave të ligjshme të pallogaritura, në tabelën përkatëse, është 2.488.984 lekë, vlerë e cila [...] sjell një balancë pozitive.*

Në deklaratat periodike të interesave, në vijim [deri në vitin 2011 kur ka filluar bashkëjetesën me znj. Ll., dhe deri me largimin nga trungu familjar për shkak të lidhjes së martesës në vitin 2012], subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash*.

80. Në mbështetje të situatës faktike të pasqyruar më sipër, si dhe në interpretim të deklarimeve të prindërve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se qasja e tyre në lidhje me përballimin e shpenzimeve të fëmijëve lidhet kryesisht me periudhën e arsimimit të tyre. Lidhur me periudhën *më pas*, trupi gjykues çmoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit, kanë nënkuptuar se, në kushtet e jetesës së përbashkët, ata kanë përballuar shpenzimet e jetesës së familjes së tyre, përfshirë dhe të tre fëmijëve të punësuar, me paga mbi nivelin mesatar, por duke u lënë atyre mundësinë të kursejnë sa më shumë me qëllim përdorimin e tyre në momentin e krijimit të familjes së tyre, duke listuar të ardhurat për secilin nga fëmijët, si dhe të ardhurat e tyre. Listimi i të ardhurave të fëmijëve, si dhe deklarimi se u kanë lënë mundësi atyre të kursejnë sa më shumë, krijon bindjen se fëmijët, tashmë madhorë dhe me burime të mjaftueshme, shpenzimet bazike të jetesës i kanë bashkuar me të ardhurat e prindërve në kuadër të jetesës së përbashkët, ndërsa pjesën tjetër e kanë kursyer. Kjo logjikë arsyetimi përputhet edhe me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike, lidhur me kursimet në *cash*, të cilat konstatohet të jenë në vlera që rrjedhin nga diferenca mes të ardhurave dhe shpenzimeve të mundshme, të kryera në vitet përkatëse. Deklarimin e prindërve të subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e tyre ndër vite kanë qenë më se të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës, sigurimin e apartamentit të banimit dhe automjetit dhe përbëhen nga të ardhurat e tyre të fituara me punë, trupi gjykues e vlerësoi në harmoni me gjithë çfarë kanë shprehur ata në pjesët e tjera të deklaratës noteriale lidhur me listimin e të ardhurat e tyre dhe të fëmijëve të tyre, si dhe përballimin e shpenzimeve të jetesës, duke çmuar se ky deklaram ka për qëllim të argumentojë se në jetesën e përbashkët, kanë kontribuar të gjithë anëtarët e familjes, sipas përbërjes së trungut familjar. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se është e drejtë analiza financiare e kryer nga Komisioni mbi mundësinë e babait të subjektit të rivlerësimit për të blerë pasurinë automjet, tip “Audi Q7”, sipas së cilës në të ardhurat e familjes H., janë përfshirë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të motrave të tij, znj. P. dhe znj. I. H., por duke zbritur kursimet në *cash* të mundshme për t’u identifikuar nga deklaratimet në deklaratat periodike të interesave, përkatëse⁵⁰, deri në vitin 2010. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i Komisionerit Publik nuk qëndron, pasi babai i subjektit të rivlerësimit, në kuadër të regjimit të përbashkët familjar, ka rezultuar me mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për të blerë pasurinë automjet, tip “Audi Q7”.
81. Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues konstatoi që subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë të pasurisë automjet, tip “Audi Q7”, në përdorim të tij, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
82. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit për to, në mbështetje të konkluzioneve të arritura, trupi gjykues, në bazë të autoritetit diskrecional për zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit e kalon testin e standardit kushtetues të provimit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe gjithashtu gjendet edhe në kushtet e parashikuara edhe nga neni 59, pika 1,

⁵⁰ Znj. P. H. ka qenë zyrtar deklarues pranë ILDKPKI-së, ndërsa për znj. I. H. nuk identifikohen kursime për shkak se nuk ka qenë ndonjëherë subjekt i deklaramit të interesave privatë pranë ILDKPKI-së.

shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 , duke arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

83. Komisioneri Publik ka kundërshtuar vendimin e Komisionit nr. 393, datë 03.06.2021, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke parashtruar në ankim se, referuar fakteve dhe rrethanave të prezantuara në dy gjetjet dhe mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar gjatë hetimit administrativ në Komision, përfundimi i arritur nga ky i fundit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm, pasi, bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve apo në një vlerësim tërësor të çështjes, aplikimi i nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret, nuk është plotësisht i bazuar. Sipas Komisionerit Publik, në arsyetimin e Komisionit mungon vlerësimi nëse, për rastin konkret, gjen zbatim neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
84. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstatoi si vijon.
85. Gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar nr. {***} prot., datë 13.01.2020, lidhet me vlerësimin nëse, në mbledhjen e KLD-së⁵¹ së zhvilluar më datë më 11 tetor 2018, në votimin për marrjen e vendimit, me anë të të cilit iu dha magjistratit Gj. Gj. leje e posaçme prindërore me kohëzgjatje nga data 1 nëntor 2018 deri më 31 tetor 2020, qasja e subjektit të rivlerësimit me sjelljen e tij aktive apo atë pasive, ka treguar profesionalizëm që nuk do të cenonte besimin e publikut te gjyqësori.
- Vëzhguesi ndërkombëtar ka konkluduar në gjetjet si vijojnë.
- i. Ekzistencë e një standardi ligjor sipas interpretimit të orientuar nga Kushtetuta të nenit 18 të ligjit 8811/2001 (që në atë kohë ka qenë në fuqi), i ndryshuar, duke pasur parasysh nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e liron secilin magjistrat nga përgjegjësia që t’i bëhet vlerësim negativ, në bazë të pikës 5 të nenit 61 të ligjit të “vetting-ut”, sa herë që po këta magjistratë kanë miratuar një vendim të KLD-së në shkelje flagrante të kuadrit ligjor përkatës, apo që kanë marrë pjesë në një votim që ka kontribuar në nxjerrjen e një vendimi të tillë.*
- ii. Shkelje flagrante, në procesin që e çoi KLD-në, më datë 11 tetor 2018, t’i jepte Gj. Gj. leje për periudhën nga 1 nëntor 2018 deri në 31 tetor 2020 dhe posaçërisht, shkeljet flagrante dhe të hapura të dispozitave të pikës 6 të nenit 22, pikës 2 të nenit 24 dhe pikës 2 të nenit 25 të ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar, siç ka qenë në fuqi në atë kohë, si dhe të pikës 2 të nenit 24 të Ligjit për Statusin, për shkaqet e shprehura në këtë dokument.*
- Shkeljet e dukshme që janë përshkruar në këtë gjetje, duhet të marrin vlerësim negativ nga Komisioni për sa i përket subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha, i cili mori pjesë në marrjen e vendimit, me të cilin u miratua kërkesa për leje e Gj. Gj., dhe mori pjesë në mënyrë aktive në diskutime dhe në rezultatin e mbledhjes së KLD-së, së datës 11 tetor 2018.*
- Një vendim i marrë nga autoriteti më i lartë, i ngarkuar me përfaqësimin e gjyqësorit në kohën e ngjarjes dhe që nga shumica dërrmuese e popullsisë konsiderohej se i takonte që – ashtu si edhe institucione të tjera publike – të vendoste standardin e sundimit të ligjit në Shqipëri, për sa i përket ligjshmërisë.*
- Në rastin konkret, nuk ka ndodhur një gjë e tillë dhe përkundrazi, subjekti i rivlerësimit Gerd Hoxha ka kontribuar me sjelljen e tij në cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe*

⁵¹ Organ në të cilin subjekti i rivlerësimit ishte anëtar.

për pasojë, një situatë e tillë duhet të merret parasysh nga Komisioni, në përputhje me pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

86. Më datë 20.01.2020, vëzhguesi ndërkombëtar paraqiti në Komision gjetjen nr. {***} prot., datë 20.01.2020. Gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar lidhet me vlerësimin nëse, në mbledhjen e KLD-së së zhvilluar më datë 10 shkurt 2017, në votimin për marrjen e vendimit, me anë të të cilit u rrëzua propozimi i bërë nga ministri i atëhershëm i Drejtësisë, për procedim disiplinor të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, z. P. A. , qasja e subjektit të rivlerësimit, me sjelljen e tij aktive apo atë pasive, ka treguar profesionalizëm që nuk do të cenonte besimin e publikut te gjyqësori.

Vëzhguesi ndërkombëtar ka konkluduar në gjetjet si vijojnë.

i. *Ekzistencë e një standardi ligjor sipas interpretimit të orientuar nga Kushtetuta të nenit 18 të ligjit 8811/2001 (që në atë kohë ka qenë në fuqi), i ndryshuar, duke pasur parasysh nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e liron secilin magjistrat nga përgjegjësia që t’i bëhet vlerësim negativ, në bazë të pikës 5 të nenit 61 të ligjit të “vetting-ut”, sa herë që po këta magjistratë kanë miratuar një vendim të KLD-së në shkelje flagrante të kuadrit ligjor përkatës, apo kanë marrë pjesë në një votim që ka kontribuar në nxjerrjen e një vendimi të tillë.*

ii. *Mungesa e përgjegjësive penale për një veprim të parashikuar në nenin 257/a të Kodit Penal, nuk e ndalon KLD-në që të vlerësojë ekzistencën e një shkeljeje disiplinore në bazë të legjislacionit në fuqi dhe se procedimet disiplinore dhe ato penale mund të trajtohen në mënyrë autonome (me kusht që elementet e krimit dhe/ose të shkeljes disiplinore të vërtetohen në procedimin përkatës).*

iii. *Ligji i zbatueshëm i asaj kohe për vlerësimin e kërkesës së ministrit të Drejtësisë, nuk parashikonte asnjë nënshtrim të hetimit disiplinor me qëllim vërtetimin e shkeljeve disiplinore të përshkruara në shkronjën “ç” të pikës 2 të nenit 32 të ligjit 9877/2008, që ka qenë atëherë në fuqi – dhe dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në fund – për ekzistencën e përgjegjësive penale për të njëjtat veprime që përshkruhen në nenin 257/a të Kodit Penal të Shqipërisë, që ishte i zbatueshëm për atë çështje, siç ishte në fuqi atëherë.*

iv. *Elementet për vlerësimin e ekzistencës së shkeljes disiplinore që përshkruhen në shkronjën “ç” të pikës 2 të nenit 32 të ligjit 9877/2008, janë të ndryshme nga elementet për të vlerësuar ekzistencën e krimit të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal të Shqipërisë dhe se, në veçanti, shkronja “ç” e pikës 2 të nenit 32 të ligjit të mëparshëm 9877/2008 nuk parashikon, si parakusht, ekzistencën e ndonjë mase të mëparshme administrative (si për shembull, masë disiplinore nga KLD-ja apo gjoba të vendosura nga organe të tjera administrative – si ILDKPKI-ja).*

Shkeljet e dukshme që janë përshkruar sa më sipër, duhet të vlerësohen negativisht nga Komisioni në lidhje me subjektin e rivlerësimit Gerd Hoxha. Ai jo vetëm ka marrë pjesë në vendimin që ka rrëzuar kërkesën e ministrit të Drejtësisë, por ka argumentuar në mënyrë aktive me arsye të pabazuara ato përfundime, siç rezulton nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i datës 10 shkurt 2017.

Vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit se, me sjelljen e tij, subjekti i rivlerësimit Gerd Hoxha ka kontribuar në mënyrë aktive për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe, si pasojë, një situatë e tillë duhet të merret parasysh nga Komisioni në përputhje me pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

87. Komisioni, në vendim, lidhur me gjetjen nr. {***} prot., datë 13.01.2020 dhe atë me nr. {***} prot., datë 20.01.2020, të vëzhguesit ndërkombëtar, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e shkeljeve që e bëjnë të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e tij si magjistrat, por veprimtaria e subjektit të rivlerësimit në funksionin e tij si anëtar i KLD-së për këto dy raste, brenda një afati 5-vjeçar, në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të

ligjit nr. 84/2016, duhet të jetë objekt i një hetimi të plotë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përgjegjës për hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj gjyqtarit dhe gjithë veprimtarisë së ushtruar prej tij në funksion të këtij statusi, për të arritur në një konkluzion në lidhje me këto aspekte të punës së këtij magjistrati.

88. Në kundërshtim të këtij përfundimi të Komisionit, Komisioneri Publik ka pretenduar në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, se referuar fakteve dhe rrethanave të prezantuara në gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, në arsyetimin e Komisionit mungon vlerësimi nëse për rastet konkrete, gjen zbatim neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
89. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet para Kolegjit, argumentoi se pretendimet e vëzhguesit ndërkombëtar e si pasojë edhe ato të Komisionerit Publik, janë të pabazuara, duke shpjeguar në mënyrë të përmbledhur:

89.1 Për gjetjen nr. {***} prot., datë 13.01.2020:

a) Çështja e shtruar për zgjidhje, nëse ka pasur veprimtari të kufizuar KLD-ja nga data 08.10.2016 e në vijim, ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), është bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 34, datë 10.04.2017, ka vlerësuar se KLD-ja, ashtu si edhe organet e tjera ekzistuese kushtetuese, do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre deri në konstituimin e plotë të organeve të reja kushtetuese dhe, në këtë kuptim, zbatimi i neneve 160/1 dhe 173/1 të ligjit, duhet të jetë në përputhje të plotë me këtë interpretim të gjykatës, në respekt të frymës së Kushtetutës. Ndodhur në këto kushte, në çështjen konkrete, KLD-ja, deri në krijimin e KLGj-së, ka qenë e detyruar të mbajë në konsideratë interpretimin pajtues të bërë nga Gjykata Kushtetuese.

b) Lidhur me çështjen e shtruar për zgjidhje nëse ka qenë në fuqi neni 24 i ligjit nr. 96/2016 në kohën kur është dhënë vendimi i KLD-së, nga përmbajtja e nenit 169 të ligjit nr. 96/2016, rezulton se vetëm pjesa II, kreu III i këtij ligji, për pagat dhe për përfitime të tjera, është i zbatueshëm për magjistratin, jo më herët se 1 janar 2019. Në pjesën II, kreu III, bëjnë pjesë vetëm nenet nga 11 deri 22, ndërsa nenet e tjera ku bën pjesë dhe neni 24 i ligjit nr. 96/2016, kanë qenë të zbatueshme që me hyrjen në fuqi të këtij ligji, më 22.11.2016. Kjo për faktin se ligji nr. 96/2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 208, më 7 nëntor 2016. Afati 15-ditor i hyrjes në fuqi të ligjit pas botimit në Fletoren Zyrtare, është plotësuar në datën 22.11.2016.

c) Leja prindërore e dhënë magjistratit Gj. Gj. me vendimin nr. {***}, datë 11.10.2018, të KLD-së është konfirmuar dhe me vendimin nr. {***}, datë 5.6.2019, të KLGj-së, duke pranuar kërkesën e tij, për përjashtimin tërësisht nga ushtrimi i veprimtarisë gjyqësore dhe si anëtar i Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, për periudhën 2-vjeçare të kohëzgjatjes së lejes prindërore. Në rastin konkret, KLGj-ja ka arritur në përfundimin se KLD-ja ka vepruar drejt në akordimin e lejes prindërore, madje sipas arsyetimit të saj, ajo nuk mund të refuzohej edhe në kushtet kur cenohej funksionaliteti i gjykimit. Përpara se t'i akordohej leja prindërore magjistratit Gj. Gj., nga KLD-ja, bazuar në nenin 24 të ligjit nr. 96/2016, janë miratuar disa vendime për dhënie leje prindërore magjistratëve. Kjo tregon se magjistrati Gj. Gj. nuk është favorizuar nga KLD-ja dhe nuk kishte asnjë arsye pse të diskriminohej në raport me magjistratët e tjerë vetëm për faktin se ka qenë anëtar i KLD-së, pasi kjo do të binte në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës. Leja prindërore për magjistratin Gj. Gj. është dhënë në zbatim korrekt të ligjit, konfirmuar edhe me vendimin e KLGj-së nr. 72, datë 20.05.2019, “Mbi lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga KLGj”, si dhe me vendimin nr. 81, datë 05.06.2019, të KLGJ-së.

ç) Më datë 11.10.2018, është thirrur mbledhja e jashtëzakonshme nga Presidenti i Republikës, duke qenë se duhej të komandohej një kryetar për Gjykatën e Apelit Korçë. Në këtë mbledhje, pasi është komanduar kryetari i Gjykatës së Apelit Korçë, Presidenti i Republikës, në cilësinë e kryetarit të KLD-së, ka qenë dakord që të shqyrtohej në rendin e ditës kërkesa e magjistratit Gj. Gj. për leje prindërore dhe nuk ka pasur asnjë kontestim lidhur me rendin e ditës. E njëjta praktikë është ndjekur disa herë nga KLD-ja. Rendi i ditës në KLD ka qenë kompetencë ekskluzive e Presidentit të Republikës, përfshi këtu edhe rastet e mbledhjeve të jashtëzakonshme. Nëse ky i fundit nuk është dakord me futjen e një çështjeje në rendin e ditës, atëherë është e nevojshme të votohet nga 2/3 e anëtarëve për të futur një çështje tjetër. Në rastin e magjistratit Gj. Gj., sikurse rezulton nga procesverbali i mbledhjes, Presidenti i Republikës ka qenë dakord që të futet në rendin e ditës kërkesa për leje prindërore e magjistratit Gj. Gj. dhe nuk ka pasur kontestime për këtë. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të KLD-së, nuk ka pasur asnjë indicie që kjo mbledhje të ishte bërë vetëm me qëllim që magjistratit Gj. Gj. t'i akordohej leje prindërore.

89.2 Për gjetjen nr. {***} prot., datë 20.01.2020:

89.2.1 Nisur nga rrethanat e faktit të konstatuara rreth një vit e gjysmë pas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për shkarkimin e gjyqtarit P. A., për shkaqe procedurale dhe kushtetuese, subjekti i rivlerësimit ka mbështetur votën kundër kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë, për shkak se me vendim të formës së prerë, ishte arritur në përfundimin se nuk ekzistonin elementet objektive e subjektive të veprave penale “Refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal, dhe në bazë të neneve 143, 146/7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 31; nenit 32, pika 1, shkronja “a”, pika 2, shkronja “ç”; nenit 33, pika 1, pika 2, shkronja “d” e ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk mund të pranohej kërkesa e ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore, pasi KLD-ja do të gjendej në kushtet e kryerjes së shkeljeve procedurale që do të passillnin prishjen e vendimit të saj nga Gjykata e Lartë, sikundër ka ndodhur edhe në raste të tjera. Subjekti i rivlerësimit, në diskutimin dhe më pas në dhënien e votës së tij kundër kërkesës së ministrit të Drejtësisë, është mbështetur në faktet e konstatuara se:

- përmbajtja e kërkesës së ministrit të Drejtësisë për gjyqtarin P. A. ishte pothuajse kopje e njëjtë, me informacionin/kallëzimin e paraqitur nga ILDKPKI-ja dhe Ministria e Drejtësisë nuk kishte kryer asnjë veprim hetimor administrativ shtesë në lidhje me rastin në fjalë;
- nuk rezultoi që ILDKPKI-ja të kishte marrë më parë masa disiplinore për shkeljet e konstatuara nga vetë ky organ, por kishte depozituar kallëzimin penal dhe kishte njoftuar Ministrinë e Drejtësisë për marrjen në konsideratë të këtyre shkeljeve;
- me vendimin, datë 18.1.2016, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. {***}, viti 2015. Nga materialet e vëna në dispozicion nga KLD-ja dhe nga përgjigjet e gjyqtarit P. A., rezultoi se ky vendim nuk është ankimuar nga ILDKPKI-ja dhe ka marrë formë të prerë, çka do të thotë se kallëzuesi-ILDKPKI-ja është pajtuar me vendimin e pushimit të marrë nga prokuroria;
- me vendimin nr. {***}, datë 04.07.2016, mbi bazën e ankimit të z. P. A., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka lënë në fuqi vendimin e datës 18.01.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan “Për pushimin e çështjes penale nr. {***}, viti 2015”. Për pasojë, plotësoheshin kushtet e “gjësë së gjykuar”, për shkak të një vendim gjyqësor të formës së prerë, i cili nuk mund të vihet në diskutim nga asnjë organ tjetër shtetëror;

- subjekti i rivlerësimit ka ndarë të njëjtin qëndrim me vëzhguesin ndërkombëtar, lidhur me faktin se mungesa e përgjegjësisë penale për një veprim të parashikuar në nenin 257/a të Kodit Penal, nuk e ndalonte KLD-në që të vlerësonte ekzistencën e një shkeljeje disiplinore në bazë të legjislacionit në fuqi dhe se procedimet disiplinore dhe ato penale mund të trajtoheshin në mënyrë autonome (me kusht që elementet e krimit dhe/ose të shkeljes disiplinore të vërtetohen në procedimin përkatës). Sipas subjektit të rivlerësimit, trajtimi autonom i shkeljes penale që passjell vërtetimin e shkeljes disiplinore të kryer nga magjistrati, është i zbatueshëm vetëm në rastet e parashikuara nga neni 104, shkronja “ç” e ligjit nr. 96/2016.

89.2.2 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi shkakun e ankimit të Komisionerit Publik të mbështetur në gjetjet e vëzhguesit kombëtar, duke argumentuar se pretendimet e Komisionerit Publik lidhen me vlerësimin e provave sipas procedurës ligjore të zhvilluar nga KLD-ja, si dhe interpretimit të ligjit material penal për zgjidhjen në themel të çështjes penale në ngarkim të magjistratit P. A., duke i kërkuar trupit gjykues të Kolegjit të bëjë një vlerësim që del jashtë sferës së objektit të kontrollit të organeve të rivlerësimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016.

89.2.3 Në vlerësimin e konkluzioneve të gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, duhen mbajtur në konsideratë edhe dy vendime të mëparshme të Komisionit, përkatësisht vendimi nr. 267, datë 24.06.2020, për subjektin e rivlerësimit P. Ç. dhe vendimi nr. 288, datë 06.08.2020, për subjektin e rivlerësimit R. H.. Për këto subjekte rivlerësimi, të cilët kanë marrë pjesë në mbledhjen e KLD-së së datës 10 shkurt 2017 e kanë votuar kundër propozimit të bërë nga ministri i atëhershëm i Drejtësisë, për procedim disiplinor të gjyqtarit P. A., Komisioni ka vendosur konfirmimin në detyrë, duke mos e konsideruar votën e tyre si cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Për këto vendime, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit nuk ka bërë rekomandim dhe Komisioneri Publik nuk ka ushtruar ankim. Mungesa e rekomandimit nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe e ankimit nga ana e Komisionerit Publik konstatohet edhe në rastin e vendimit të Komisionit nr. 409, datë 30.06.2021, për subjektin e rivlerësimit K. A., i cili ka qenë prokurori i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan që marrë vendimin e datës 18.01.2016, “Për pushimin e çështjes penale nr. {***}, viti 2015”, në ngarkim të gjyqtarit P. A..

89.3 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi shkakun e ankimit të Komisionerit Publik të mbështetur në dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, duke argumentuar gjithashtu se vendimi nr. {***} prot., datë 29.03.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”) “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të rastit të paraqitur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për magjistratin Gerd Hoxha, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, ka rrëzuar çështjet e ngritura nga Komisioneri Publik në ankimin e tij, në mbështetje të dy gjetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si organi kompetent i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 96/2016 e ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka arritur në konkluzionin se gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar nuk janë të sakta e të bazuara në prova dhe në ligj, pasi subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të KLD-së, me veprimet apo mosveprimet e tij, nuk ka kryer asnjë shkelje disiplinore dhe nuk ka kontribuar në asnjë moment në cenimin e besimit të publikut tek institucionet e gjyqësorit.

90. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, në shqyrtimin e shkakut të ankimit lidhur me kontrollin dhe vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, me fokus të veçantë vlerësimin e konkluzioneve të gjetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar, të cilat janë bërë pjesë e ankimit të Komisionerit Publik, pasi analizoi aktet e fashikullit të përcjellë nga Komisioni dhe aktet e administruara gjatë gjykimit në Kolegj, konstatoi faktet dhe rrethanat si më poshtë.

90.1 Nga verifikimi i akteve⁵², të cilat vëzhguesi ndërkombëtar ia ka bashkëlidhur gjetjes nr. {***} prot., datë 13.01.2020, e cila lidhet me qasjen e subjektit të rivlerësimit në mbledhjen e KLD-së së zhvilluar më datë 11 tetor 2018, në votimin për marrjen e vendimit, me anë të të cilit iu dha magjistratit Gj. Gj. leje e posaçme, me kohëzgjatje nga 1 nëntor 2018 deri në 31 tetor 2020, u konstatua se:

90.2 KLGj-ja, në shkresën nr. {***} prot., datë 11.12.2019, drejtuar Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, në lidhje me mbledhjen e KLD-së së zhvilluar më datë 11 tetor 2018, është shprehur se: [...] *Mbledhja është organizuar në mënyrë të shpejtë, në kushtet kur Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më datë 10.10.2018, ka njoftuar se ka vendosur shkarkimin e gjyqtarës së Gjykatës së Apelit, Korçë, znj. E. P., e cila ushtronte dhe funksionin drejtues pranë kësaj gjykate. [...] Bazuar në ligjin nr. 8811/2001, i ndryshuar, konkretisht në nenin 11, Presidenti i Republikës është kryetari i KLD-së dhe është ky autoritet, i cili thërriste dhe drejtonte mbledhjen e KLD-së dhe kujdesej për zbatimin e ligjit gjatë zhvillimit të mbledhjes dhe për marrjen e vendimeve [...].*

90.3 Me shkresën “Kërkesë”, me lëndë: “Mbi dhënien e lejes për periudhën 01.11.2018 deri më 31.10.2020”, z. Gj. Gj. i është drejtuar kryetarit të KLD-së. Kjo shkresë në fund mban datën 10.10.2018 dhe nënshkrimin e z. Gj. Gj.. Kërkesa mban vulën e protokollit të KLGj-së, me nr. {***} prot., datë 11.10.2018. Me shkresën nr. {***} prot., datë 11.10.2018, drejtuar KLD-së, kryetari i Gjykatës së Apelit, z. H. D., ka dhënë miratimin që gjyqtarit Gj. Gj. t’i akordohet leje prindërore për një periudhë 2-vjeçare.

90.4 Nga procesverbali i mbledhjes së KLD-së, “Mbledhje e jashtëzakonshme, mbajtur më datë 11.10.2018”, rezulton se z. Gj. Gj. është shënuar si i pranishëm në mbledhje dhe nga vijimi i shënimeve në procesverbal, nuk arrihet të evidentohet nëse ai është larguar apo jo nga mbledhja në momentin e diskutimit dhe votimit të çështjes që lidhej me të.

90.5 Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni për sa i përket gjetjes nr. {***} prot., datë 20.01.2020, e cila lidhet me qasjen e subjektit të rivlerësimit në mbledhjen e KLD-së së zhvilluar më datë 10 shkurt 2017, në diskutimin e votimin për marrjen e vendimit, me anë të të cilit u rrëzua propozimi i bërë nga ministri i atëhershëm i Drejtësisë, për procedim disiplinor të gjyqtarit P. A., pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, u konstatua se:

a) me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 28.09.2015, ministri i Drejtësisë, z. N. N., ka paraqitur në KLD kërkesë për procedimin disiplinor të gjyqtarit P. A., gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, në bazë të shkresës nr. {***} prot., datë 09.06.2015, të ILDKPKI-së;

b) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, mbi bazën e kallëzimit të ILDKPKI-së, ka regjistruar procedimin penal nr. {***} të vitit 2015, për veprat penale “Refuzim për deklaram, mosdeklarim, fshehja ose deklarimi i remë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal, në ngarkim të z. P. A.;

c) me vendimin e datës 18.01.2016, prokurori i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. K. A., ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. {***}, viti 2015, pasi ka arritur në përfundimin se me gjithë hetimet e kryera, nuk u bë e mundur të provohet se faktet objekt hetimi përbëjnë vepra penale të parashikuara nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal, për shkak të mosplotësimit të elementeve objektive e subjektive të tyre. Ky vendim nuk është ankimuar nga ILDKPKI-ja dhe ka marrë formë të prerë;

⁵² Këto akte i janë vënë në dispozicion vëzhguesit ndërkombëtar me shkresat e KLGj-së nr. {***} prot., datë 06.12.2019 dhe {***} prot., datë 18.12.2019.

ç) me vendimin nr. {***}, datë 04.07.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka lënë në fuqi vendimin, datë 18.01.2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan “Për pushimin e çështjes penale nr. {***}, viti 2015”.

d) në mbledhjen e KLD-së, datë 10.02.2017, referuar procesverbalit të saj, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të KLD-së, ka diskutuar në lidhje me kërkesën e ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit P. A., duke mbajtur qëndrim në diskutimin e votimin për marrjen e vendimit, me anë të të cilit u rrëzua propozimi i bërë nga ministri i atëhershëm i Drejtësisë, për procedim disiplinor të gjyqtarit P. A., pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

90.6 Nga verifikimi i vendimit nr. {***} prot., datë 29.03.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”) “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të rastit të paraqitur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për magjistratin Gerd Hoxha, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, rezulton se ILD-ja, në këtë vendim, ka arsyetuar se, *në rastin konkret, nga të dhënat e parashtruara në gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe dokumentacioni i paraqitur, nuk jepet asnjë e dhënë qoftë edhe indicie që të krijojnë dyshimin e arsyeshëm se vlerësimi nga anëtarët e ish-KLD-së, ku përfshihet edhe magjistrati Gerd Hoxha, të jetë përtej bindjes së tyre të brendshme, e garantuar si një vlerë themelore në nenin 3 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, vlerësohet se pretendimet në gjetjen në fjalë nuk përfshihen në natyrën e shkeljeve disiplinore të parashikuara në nenin 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës dhe nenin 120, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, nga shqyrtimi fillestar, rezulton se, në rastin konkret, janë pretenduar dhe paraqitur fakte të qarta dhe të mjaftueshme, si dhe janë shoqëruar me prova, por të cilat nuk i krijojnë ILD-së një dyshim të arsyeshëm, i cili justifikon fillimin e hetimit disiplinor sipas kërkesave të nenit 122, pika 1, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës dhe nenit 101, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*

91. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues vlerësoi si vijon.

*Në lidhje me pretendimet e Komisionerit Publik mbështetur në konkluzionet e gjetjes nr. {***} prot., datë 13.01.2020 të vëzhguesit ndërkombëtar*

91.1 Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik, sipas të cilit shkelja e pretenduar e kryer nga subjekti i rivlerësimit, ashtu siç është cituar në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar nr. {***} prot., datë 13.01.2020, në vendimmarrjen me të cilën KLD-ja, më datë 11 tetor 2018, i dha z. Gj. Gj. leje prindërore për periudhën nga data 1 nëntor 2018 deri më 31 tetor 2020, është shkelje flagrante e pikës 6 të nenit 22, pikës 2 të nenit 24 dhe pikës 2 të nenit 25 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8811/2001”), siç ka qenë në fuqi në atë kohë, si dhe të pikës 2 të nenit 24 të ligjit nr. 96/2016, duke cenuar kështu besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues vëren se shkeljet e pretenduara të parashikimeve të neneve⁵³ të ligjit nr. 8811/2001,

⁵³ Neni 22, “Rendi i ditës”:

“1. Rendi i ditës së mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë vendoset nga kryetari. Në rendin e ditës përfshihen çështje të cilat, sipas ligjit, janë detyrë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Të drejtën për të kërkuar shqyrtimin e çështjeve në rendin e ditës së mbledhjes të Këshillit të Lartë të Drejtësisë e kanë zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ministri i Drejtësisë dhe 5 anëtarë të tjerë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

lidhen me normat procedurale të funksionimit të KLD-së, siç janë mënyra e organizimit dhe e administrimit të mbledhjes, të cilat janë kompetencë e drejtuesit të mbledhjes në një organ kolegjal, por që mund të diskutohen edhe prej anëtarëve të këtij organi. Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjyqimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime, duke e lidhur mungesën e votimit për futjen e çështjes së dhënies së lejes prindërore magjistratit Gj. Gj. në rendin e ditës së mbledhjes së KLD-së, me faktin se asnjë nga anëtarët e pranishëm në mbledhje nuk ka kontestuar këtë shtesë në rendin e ditës dhe se një mënyrë e tillë organizimi e mbledhjes, ishte praktikë e pranuar në KLD. Në analizë të pretendimeve të mësipërme, trupi gjykues vëren se neni 22, pika 6 e ligjit nr. 8811/2001 ka parashikuar një procedurë të veçantë për të marrë në shqyrtim çështje që nuk janë të përfshira në rendin e ditës së mbledhjes së KLD-së, procedurë e cila kërkon vendimmarrjen me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve. Në rastin konkret, nga verifikimi i procesverbalit të mbledhjes së KLD-së së datës 18.01.2018, rezulton se çështja e dhënies së lejes prindërore për magjistratin Gj. Gj. nuk ka qenë një çështje e përfshirë në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se shqyrtimi i çështjeve në mbledhjet e zhvilluara në një organ kolegjal do të duhet të kryhet konform rregullave procedurale të përcaktuara në ligj apo rregulloret përkatëse. Argumenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit se mungesa e kontestimeve për futjen e çështjes në rendin e ditës ka bërë të panevojshëm votimin dhe se kjo ka qenë një praktikë e ndjekur disa herë nga KLD-ja, nuk u vlerësua bindës nga trupi gjykues, pasi zbatimi i normave procedurale është një detyrim që duhet ndjekur e aq më tepër në rastin kur organi kolegjal është autoriteti shtetëror përgjegjës për kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve, zbatimi i procedurave ligjore merr rëndësi të veçantë.

91.2 Komisioneri Publik ka pretenduar se neni 24, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 nuk ka qenë i zbatueshëm në kohën e dhënies nga KLD-ja të vendimit për dhënien e lejes prindërore gjyqtarit Gj. Gj., pasi ishte një dispozitë që nuk kishte hyrë ende në fuqi. Në lidhje me këtë pretendim të Komisionerit Publik, trupi gjykues vëren se në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, referohet se: *Dosja që vëzhguesi ndërkombëtar ka marrë nga KLD-ja më datë 11 dhjetor 2019, përmban*

3. Çështjet e rendit të ditës të kërkuara nga ministri i Drejtësisë shqyrtohen në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

4. Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës bëhet me shkrim, jo më vonë se 2 ditë përpara datës së njoftimit.

5. Rendi i ditës u shpërndahet anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë së bashku me njoftimin për thirrjen e mbledhjes.

6. Përrjashtimisht, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të marrë në shqyrtim dhe të vendosë për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës”.

Neni 24, “Votimi i detyrueshëm”:

“Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar në kuptimin e nenit 37 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nuk mund të abstenojnë”.

Neni 25, “Forma e votimit”:

“1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë i merr vendimet me votim të hapur. Në rastet e votimit për çështje që lidhen me anëtarë të tij, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, mund të vendosë marrjen e vendimeve me votim të fshehtë.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që janë në kushtet e pengesës ligjore, nuk marrin pjesë në diskutimin dhe në votimin e çështjes përkatëse të rendit të ditës.

3. Ministri i Drejtësisë nuk merr pjesë në votim në rastet e procedimeve disiplinore të nisura prej tij, ndërsa Presidenti i Republikës nuk merr pjesë në votim në rastet e propozimeve për emërim të gjyqtarëve.

4. Drejtuesi i mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë voton i fundit”.

*një vendim të datës 11 tetor 2018 (e njëjta datë me datën e mbledhjes së KLD-së), në të cilën kryetari i Gjykatës së Apelit të Tiranës, gjyqtari Hysni Demiraj, ka miratuar kërkesën e parashtruar nga magjistrati Gj. Gj. për leje prindërore. Megjithatë, nuk ka prova shkresore të besueshme që Gj. Gj. ta ketë përfutur këtë vendim përpara se t'i parashtronte kërkesën KLD-së. Por, kjo kërkesë (nr. {***} prot., dt. 11 tetor 2018) mbante datën 10 tetor 2018, një ditë përpara datës së miratimit të dhënë nga (tashmë ish-) kryetari D. (11 tetor 2018). Madje as nuk është e sigurt nëse miratimi i kryetarit D. ka ndodhur efektivisht më herët se data 11 tetor 2018, pasi nuk ka numër të besueshëm protokollit nga Gjykata e Apelit e Tiranës, që do të mund të tregonte datën e marrjes së vendimit; në pjesën e sipërme majtas të dokumentit të nënshkruar nga (tashmë ish-) kryetari D., shënohet “nr. {***} prot.”, një formulim i cili përdoret për t’iu referuar shkresave që u shtohen ex-post numrave të protokollit të një dite të caktuar. Për pasojë, rezulton qartë ekzistenca edhe e shkeljes së pikës 2 të nenit 24 të ligjit nr. 96/2016 në procesin që çoi KLD-në të miratonte kërkesën e Gj. Gj., drejtuar KLD-së më 10 tetor 2018.*

Nga verifikimi i shkresës nr. {***} prot., datë 11.10.2018, drejtuar KLD-së, me anë të së cilës kryetari i Gjykatës së Apelit, z. H. D., bazuar në nenin 24, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, ka dhënë miratimin që gjyqtarit Gj. Gj. t’i akordohet leje prindërore për një periudhë 2- vjeçare, trupi gjykues konstatoi se kjo shkresë ka ekzistuar dhe gjendet në dosjen e vendimmarrjes së KLD-së. Në kuptim të parashikimit të nenit 24, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: *Leja e veçantë miratohet nga kryetari i gjykatës ose prokurorisë. Këshillat miratojnë lejen prindërore, pasi kanë marrë mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë*, trupi gjykues vlerëson se është e rëndësishme ekzistenca e miratimit të lejes së veçantë nga kryetari i gjykatës përpara se të merret vendimi nga KLD-ja për miratimin e saj. Në rastin konkret, data e miratimit të lejes nga kryetari i gjykatës mban datën 11.10.2018 dhe kërkesa e z. Gj. Gj. për dhënien e lejes, drejtuar KLD-së, është regjistruar në protokollin e kësaj të fundit në të njëjtën datë. Fakti që z. Gj. ka nënshkruar kërkesën e sipërcituar më datë 10.10.2018, nuk merr përparësi krahasuar me datën e regjistrimit të kësaj kërkesë në protokollin e KLD-së⁵⁴. Për pasojë, pretendimi i parashtruar nga Komisioneri Publik nuk bind trupin gjykues për shkelje të nenit 24, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, nga ana e KLD-së.

*Në lidhje me pretendimet e Komisionerit Publik mbështetur në konkluzionet e gjetjes nr. {***} prot., datë 20.01.2020, të vëzhguesit ndërkombëtar*

91.3 Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik, sipas të cilit, në vendimmarrjen me të cilën KLD-ja rrëzoi propozimin e bërë nga ministri i atëhershëm i Drejtësisë, për procedim disiplinor të z. P. A., gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në mënyrë aktive me arsye të pabazuara se gjyqtari në fjalë nuk mund të ngarkohej me përgjegjësi disiplinore, duke cenuar kështu besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues vëren si vijon. Pretendimi i Komisionerit Publik mbështetet në një interpretim të ndryshëm të kuadrit ligjor të kohës, për sa i përket korrelacionit mes përgjegjësisë penale dhe asaj disiplinore ndaj veprimeve apo mosveprimeve të kryera nga një magjistrat, krahasuar me qëndrimin që ka mbajtur subjekti i rivlerësimit në diskutimin e tij në mbledhjen e KLD-së së datës 10.02.2017, siç rezulton nga procesverbal i mbledhjes, në të cilën është shprehur se: *Sa i përket thelbit, më rezulton se kërkesa e ministrit për shkarkimin e gjyqtarit P. A., është bërë në shtator të 2015-ës. Në atë kohë, nuk ishte marrë ende vendimi i pushimit të çështjes, që është i datës 18 janar 2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i lënë në fuqi me të njëjtin arsyetim, më datë 04.07.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Edhe në raste të tjera, kur jemi ndodhur përpara këtij fakti, unë kam mbajtur qëndrimin që është ndoshta në të paktat*

⁵⁴ Sipas shënimit në procesverbal, mbledhja e KLD-së për shqyrtimin e çështjes së miratimit të lejes prindërore për z. Gj. Gj., është mbajtur në orën 18:18, më datë 11.10.2018.

raste kur elementet e faktit, veprimet apo mosveprimet e subjektit të procedimit penal apo të procedimit administrativ, janë njësoj si për aspektin penal, ashtu edhe për aspektin administrativ. Do të thotë që, në qoftë se nuk ekzistojnë elemente të shkeljes së ligjit në aspektin penal, të veprës penale, nuk mund të flasim për shkelje të ndonjë dispozite të ligjit administrativ. Duke iu referuar përmbajtjes së Kodit Penal, neni 257/a, "Refuzim, deklarim, mosdeklarim, fshehje e të ardhurave apo pasurisë", thotë: "Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë, interesave privatë të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale". Në këtë rast, nuk kemi as masë administrative. Do të thotë që prokuroria ka hetuar dhe nuk ka gjetur asnjë element që veprimtaria e subjektit P. A. të ketë shkelje të ligjit penal. E them në këtë rast, nuk jemi si në rastet e tjera kur një shkelje, një veprim i kundërligjshëm mund të jetë vepër penale, por ndërkohë është shkelje administrative apo një fakt/rrethanë e parashikuar nga ligji "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", atëherë dhe ligji "Për statusin e gjyqtarit" tani, si një veprim i cili do të ndëshkohet administrativisht. [...] Në kushtet kur kemi një vendim të formës së prerë që thotë se nuk ka elemente të veprës penale, nuk mund të flasim për përgjegjësi administrative. Madje në disa raste, dhe organet ndërkombëtare, ku ne referohemi shpesh (Komisioni i Venecias apo Rrjeti i Këshillave Gjyqësore), thotë që procesi disiplinor është i ngjashëm me atë penal dhe parimet janë njësoj dhe nuk mund të ketë ndëshkime dy herë për të njëjtën gjë. Apo në qoftë se kemi vendim pushimi në një rast, nuk mundet t'i kundërvihemi rastit tjetër. Në rastin konkret, ne jemi përpara faktit ku jemi të detyruar ta rrëzojmë kërkesën e ministrit të Drejtësisë, pasi ajo kërkesë nuk i përgjigjet kohës, nuk është në përputhje me realitetin e tanishëm, është bërë në një kohë kur nuk kishte një vendim penal. Ndërkohë, kemi një vendim i cili ka ardhur disa muaj më prapa. Jemi në këto kushte, ku edhe organi që ka bërë kallëzimin, nuk ka bërë ankim. Kështu që, unë mendoj që duhet rrëzuar dhe kjo do jetë edhe vota ime.

Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues vëren se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka qenë një organ kolegjal dhe subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të këtij organi, duke marrë pjesë në procesin e diskutimit dhe atë vendimmarrës lidhur me një çështje të rendit të ditës, nuk ka pasur një pozitë të veçantë apo raport të ndryshëm me anëtarët e tjerë pjesëmarrës në mbledhje. Ai ka ushtruar funksionin duke mbajtur qëndrimin e tij, bazuar në interpretimin e normave juridike në fuqi, në raport me faktet e rrethanat e çështjes konkrete të shtruar për diskutim. Në këtë kontekst të situatës faktike, trupi gjykues nuk i gjen të drejta pretendimet e Komisionerit Publik, për sa kohë implikojnë drejtpërdrejt bindjen e brendshme e logjikën e subjektit të rivlerësimit mbi vlerësimin e rrethanave e fakteve në çështjen konkrete, në interpretimin e normave penale dhe administrative, lidhur me themelin e çështjes dhe korrektesinë e vendimmarrjes së KLD-së, duke zëvendësuar interpretimin ose logjikën e anëtarit të këtij organi, pra me atë aspekt të aftësive që nuk mund të vlerësohet si matës i aftësive të tij profesionale.

91.4 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në vlerësimin e pretendimeve të Komisionerit Publik e konkluzioneve të gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, duhen mbajtur në konsideratë edhe vendime të mëparshme të Komisionit, përkatësisht vendimi nr. 267, datë 24.06.2020, për subjektin e rivlerësimit P. Ç. dhe vendimi nr. 288, datë 06.08.2020, për subjektin e rivlerësimit R. H., vendime të cilat kanë konfirmuar në detyrë subjektet përkatëse e nuk janë kundërshtuar as nga vëzhguesit ndërkombëtarë e as nga Komisioneri Publik, megjithëse subjektet e rivlerësimit kanë qenë anëtarë të KLD-së e kanë marrë pjesë e kanë votuar kundër kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit P. A., trupi gjykues, nga verifikimi i vendimeve të Komisionit, si dhe nga procesverbali i mbledhjes së KLD-së së datës 10.02.2017, vëren se qëndrojnë konstatimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson të

nënvizojë qëndrimin e konsoliduar në jurisprudencën e tij se Kolegji, brenda juridiksionit dhe kompetencës së tij kushtetuese, shqyrton ankimin vetëm për shkaqet e pretenduara, të cilat lidhen me vendimin e Komisionit objekt ankimi dhe jo me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendime të tjera për subjekte të tjera rivlerësimi, në përputhje edhe me nenin 10 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton: “Gjykata mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor”. Nuk është roli i Kolegjit, madje edhe në rastet që në pamje të parë duken të krahasueshme ose të ngjashme, në lidhje me rrethanat e faktet e paraqitura në to, të krahasojë vendimet e ndryshme të dhëna nga Komisioni, apo qëndrimin e vëzhguesit ndërkombëtar apo Komisionerit Publik në raport me to, për subjekte të ndryshme.

92. Pavarësisht arsytimit të mësipërm, i cili ishte i kushtëzuar nga nevoja për t’u dhënë përgjigje shkaqeve të ankimit të parashtruara nga Komisioneri Publik, trupi gjykues vlerësoi se është detyrë e tij të identifikojë kryesisht, nëse çështjet e ngritura në shkaqet e ankimit, bëjnë pjesë në sferën e juridiksionit dhe kompetencën e Kolegjit, në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar.

92.1 Në rastin në shqyrtim, trupi gjykues vëren se pretendimet e ngritura nga Komisioneri Publik, mbështetur në gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, kanë të bëjnë me vlerësimin e qëndrimeve të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionit të anëtarit të KLD-së, në dy vendimmarrje të këtij organi kolegjal.

92.2 Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se neni 179 i Kushtetutës, në pikat 3 dhe 4 të tij përcakton rrethin e subjekteve të cilët do t’i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, duke listuar të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme, si dhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet, nëse paraqesin kërkesë për t’iu nënshtroar këtij procesi.

Neni E i Aneksit të Kushtetutës, në pikën 1 ka përcaktuar qëllimin e kryerjes së vlerësimit të aftësive profesionale, i cili është identifikimi i atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Objekti i kontrollit, vlerësimit të aftësive dhe kriteret e vlerësimit profesional janë përcaktuar në pikën 2 të këtij neni. Elementet e kontrollit dhe të vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit, janë ndarë sipas dy kategorive profesionale: së pari, gjyqtarët, këshilltarët ligjorë ose ndihmësit ligjorë dhe, së dyti, prokurorët. Nga pikëpamja e kriterëve, dispozita ka vendosur çështjet kryesore që i nënshtrohen vlerësimit, sipas të cilit vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë ose ndihmësit ligjorë, përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj.

Ligji nr. 84/2016, në nenin 44 të tij ka parashikuar se subjektet e rivlerësimit vlerësohen sipas rastit për: i) cilësi të pranueshme apo të papranueshme në punë; ii) gjykim të drejtë apo të dobët; iii) respektim apo mosrespektim të të drejtave të palëve ose viktimave; si dhe iv) të qenit eficient dhe efektiv në masë të pranueshme apo të qenit joefektiv, për të mbërritur përfundimisht në kualifikimin “i aftë”, “me mangësi” apo “i papërshtatshëm”.

Sipas nenit 42, pika 1 e ligjit të sipërcituar, burimet mbi të cilat vlerësohen subjektet e rivlerësimit, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët merren nga burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e

gjqtarëve, ndërkohë që procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm⁵⁵.

Sipas nenit 71 të ligjit nr. 96/2016, vlerësimi kryhet sipas këtyre kriterëve: a) aftësive profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; b) aftësive organizative; c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Në nenet 72-76 të ligjit të sipërcituar, janë elaboruar kriteret e vlerësimit të magistratit, në secilin prej elementeve përbërëse të tyre. Në nenin 77 të këtij ligji, renditen burimet e vlerësimit të magistratëve, të cilët lidhen me dokumente dhe të dhëna që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrës së magistratit e me ngritjen profesionale të tij në funksion të dhënies së drejtësisë.

92.3 Në analizë të përmbajtjes së kuadrit ligjor të analizuar, trupi gjykues vlerësoi se kriteret mbi bazën e të cilave kryhet vlerësimi i aftësisë profesionale për gjyqtarët, kanë të bëjnë me vlerësimin e gjyqtarëve të caktuar në një pozicion në gjykatë, të cilët kanë ushtruar detyrën e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit të përcaktuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vlerësimi i aftësisë profesionale të gjyqtarit nuk mund të kryhet edhe për funksionin që ai ka ushtruar në një pozicion tjetër, si ajo e anëtarit të KLD-së, pasi vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtarit në këtë funksion, nuk ka qenë qëllimi i ligjit nr. 84/2016 dhe as ai i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar. Vlerësimi profesional sipas këtij kuadri ligjor, kryhet mbi punën që kanë kryer magistratët dhe që evidentohet në të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që gjendet në dosjet e punëve të magistratëve. Kjo mënyrë vlerësimi është konstatuar dhe pranuar edhe nga Komisioni i Venecias, i cili në mendimin e ndërmjetëm, dhënë gjatë procesit të përgatitjes së amendamenteve kushtetuese⁵⁶, ka vënë në dukje lidhur me vlerësimin e magistratëve se: *nga drafti, duket sikur kjo duhet bazuar në punën faktike që është kryer nga personi që vlerësohet.*

Në këtë kuptim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit për vendimmarrjet si ish-anëtar i KLD-së, tejkalon juridiksionin dhe kompetencën e Kolegjit, në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar. Kolegji analizon faktin dhe rrethanën përkatëse në raport me legjislacionin e zbatueshëm në atë përmasë që ka ndikim mbi procesin e rivlerësimit të magistratëve, të parashikuar nga neni 179/b i Kushtetutës dhe Aneksi i saj, çka përbën juridiksionin e tij kushtetues. Veprimi i Kolegjit brenda kornizës kushtetuese dhe ligjore, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është detyrim i vlerësuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin nr. 15/2010, thekson ndër të tjera në arsyetimin e saj se: *Parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas të drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative, se çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkualuar kufijtë e përcaktuar prej tyre dhe, në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore.*

92.4 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, në thelb, kanë të bëjnë me çështje, zgjidhja e të cilave nuk i përket juridiksionit dhe kompetencës së Kolegjit, për rrjedhojë nuk legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet e ngritura.

93. Në lidhje me shkakun e ankimit të parashtruar nga Komisioneri Publik, në mbështetje “Mendimit me shkrim” nr. {***} prot., datë 11.11.2019, të vëzhguesit ndërkombëtar, të

⁵⁵ *Jurisprudenca e Kolegjit: vendimi nr. 21/2019 (JR), datë 13.09.2019.*

⁵⁶ *Opinion i ndërmjetëm “Mbi projektndryshimet kushtetuese për gjyqësorin e Shqipërisë” CDL-AD (2015) 045, paragrafi 123.*

administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se vëzhguesi ndërkombëtar, në konkluzionet e tij, është bazuar në analizën e përmbajtjes së raportit të vlerësimit profesional të KLGj-së, në lidhje me dosjen gjyqësore nr. 1 të çështjeve të shortuara, e cila i përket çështjes penale nr. {***} regjistri themeltar, datë 26.10.2011 regjistrimi, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër të pandehurave M. K. dhe A. A. (H.), të akuzuara për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 26.12.2013.

94. Vëzhguesi ndërkombëtar ka referuar në mënyrë të përmbledhur se:

U deshën 47 (dyzet e shtatë) seanca gjyqësore për të përfunduar këtë çështje, në periudhën që nga 13 dhjetori 2011 deri në 26 dhjetor 2013. Shumë seanca janë shtyrë për arsye të mosnjoftimit të duhur të palëve apo të dëshmitarëve në proces ose sepse subjekti i rivlerësimit ka pasur seancë tjetër gjyqësore ose angazhime të tjera (seminare, takime, workshope etj.).

Raporti i aftësisë profesionale për këtë subjekt, përveçse përmend se kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar 9 muaj, që është afati i përcaktuar ligjor sipas shtojcës 1 të Sistemit të Vlerësimit, thekson se njoftimet nuk janë parë/kontrolluar siç duhet, duke bërë që seancat të shtyhen.

[...] Raporti i aftësive profesionale referon se “veprimet procedurale për organizimin e procesit, sidomos ato lidhur me njoftimin e palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, nuk janë dokumentuar rregullisht [...] dhe fakti që asnjë nga seancat nuk është dokumentuar nga regjistrimet audio, ashtu siç kërkohet ligjërisht nga neni 115 i Kodit të Procedurës Penale”. Nuk referohet askund në raportin e aftësive profesionale që nuk ka qenë i mundur regjistrimi audio i seancave gjyqësore.

[...] Raporti i aftësive profesionale thekson se “kjo çështje është regjistruar në gjykatë më datë 26.10.2011. Nuk ka të dhëna për caktimin e saj me short dhe se si ajo iu caktua Gerd Hoxhës. Ky fakt, që shpjegon se si caktohen çështjet dhe se si ky rast veçanërisht iu caktua subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha, duhet të hetohet më tej nga Komisioni, në mënyrë që të përjashtohet çdo mundësi për caktim arbitrar të çështjes këtij subjekti rivlerësimi dhe/apo ndonjë përgjegjësi të mëtejshme të subjektit të rivlerësimit në këtë rast.

Mendimi i vëzhguesit ndërkombëtar është që, për sa i përket çështjes nr. 1 të shortuar, ndodhemi përpara ekzistencës së “gabimeve thelbësore dhe serioze” të kryera nga subjekti i rivlerësimit Gerd Hoxha, [...] të cilat duhet të çojnë Komisionin të konkludojë në lidhje me mosekzistencën e kriterëve të parashikuara nga neni 59, pika l, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, interpretuar së bashku me nenin E, pika 5 e Aneksit.

95. Komisioni, në vendim, ka arsyetuar në lidhje me konkluzionet e mendimit të vëzhguesit të ONM-së, duke u shprehur: *Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato janë bindëse dhe, për rrjedhojë, në lidhje me dosjen nr. 1, konstaton se subjekti ka arritur të provojë bindshëm të gjitha pasaktësitë e konstatuara nga ana e KLGj-së. Nga provat e administruara, duke i krahasuar me ato që gjenden në dosjen e vlerësimit profesional nga ana e KLGj-së, konstatohet se kjo e fundit nuk është e plotë, pasi nuk ka të përfshirë të gjitha volumet, të cilat janë vënë në dispozicion nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit, si dhe me dorëzimin me vonesë të vendimit, Komisioni vlerëson se nga ana e subjektit, është provuar që këto vonesa kanë ardhura si pasojë e ngarkesës së madhe të tij në punë, kompleksitetit të çështjes, shtyrjes së seancave nga palët në proces, si dhe shtyrjes së disa seancave për shkaqe që lidhen me impenjime të tjera të tij, për të cilat subjekti duhej të ishte treguar më i kujdesshëm për të shmangur përplasjen e datave. Nga vëzhgimi i dosjes gjyqësore, rezulton se subjekti ka marrë të gjitha masat për njoftimin e palëve. Pavarësisht vonesave të krijuara në lidhje me kohën e gjykimit, si dhe të zbardhjes së vendimit, Komisioni vlerëson se ato nuk mund të konsiderohen si shkaqe për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit ndaj subjektit të rivlerësimit, për sa kohë nuk janë shkaktuar për mungesë të organizimit të punës nga ana e subjektit. Në përfundim, Komisioni vlerëson se në*

lidhje me dosjen nr. 1, nuk gjenden “gabime thelbësore dhe serioze”, siç përcaktohet nga pika 54 e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, datë 18.1.2017.

96. Në kuadër të shqyrtimit të fakteve e rrethanave në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues konstatoi se në raportin e KLGj-së për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha, me nr. {***} prot., datë 25.06.2019, evidentohen konkluzionet e pasqyruara në mendimin me shkrim të vëzhguesit ndërkombëtar, lidhur me dosjen gjyqësore nr. 1 të përzgjedhur me short – çështja penale nr. {***} regjistri themeltar, datë 26.10.2011 regjistrimi, që i përket kërkesës Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurve: A. A. dhe M. K., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 26.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (në vijim “çështja nr. {***}, datë 26.10.2011”).

Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në lidhje me konstatimet e raportit të KLGj-së dhe konkluzioneve të mendimit me shkrim të vëzhguesit ndërkombëtar. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar argumentet e tij, të mbështetura në dokumentacionin e paraqitur bashkëlidhur shpjegimeve. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, ka parashtruar të njëjtat argumente, të cilat shtjellohen në vijim.

96.1 Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se nuk ka të dhëna se si çështja nr. {***}, datë 26.10.2011, iu caktua subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në përgjigje të kërkesës për informacion të Komisionit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresat nr. {***} prot., datë 13.12.2019 dhe nr. {***} prot., datë 20.11.2019 ka informuar se: *Dosja penale në ngarkim të shtetasve M. K. dhe A.T. (H.) është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 26.10.2011 dhe po brenda kësaj date është regjistruar në regjistrin përkatës. Në datë 27.10.2011, i është nënshtruar shortit elektronik nëpërmjet sistemi Ark-IT dhe shorti ka caktuar gjyqtar subjektin e rivlerësimit. Evidentimi i shortit elektronik bëhet nëpërmjet listës së datës respektive të prodhuar nga vetë sistemi. Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përcjellë “Listën e shortit të datës 27.10.2011”, në të cilën, në faqen e dytë, me nr. rendor 26, figuron e hedhur në short dosja penale në ngarkim të shtetasve M. K. dhe A.T. (H.), me gjyqtar Gerd Hoxha. Nga sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se nga të dhënat e përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton qartësisht se çështja nr. {***}, datë 26.10.2011, i është caktuar subjektit të rivlerësimit me short.*

96.2 Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar afatin 9-mujor, të përcaktuar në shtojcën 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, dhe kjo për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk ka kontrolluar, supervizuar gjendjen/statusin e njoftimeve përkatëse përpara seancës gjyqësore, trupi gjykues konstatoi se, në raportin e vlerësimit profesional të KLGj-së, në lidhje me dosjen gjyqësore nr. 1, e cila i përket çështjes penale nr. {***}, datë 26.10.2011 (në vijim “raporti i KLGj-së”), në të cilin është mbështetur dhe vëzhguesi ndërkombëtar në dhënien e mendimit me shkrim, lidhur me kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjes, referohet se nga 38 seanca gjyqësore joproduktive, 12 seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, 11 seanca për shkak të mungesës së prokurorit, 11 seanca për shkak të mungesës së dëshmitarëve dhe ekspertëve, si dhe 4 seanca për shkak të mungesës së gjyqtarit. Raporti i KLGj-së vijon më tej, duke cituar: *Në caktimin e seancave janë respektuar afatet ligjore. Nuk janë mbikëqyrur rregullisht aktet e njoftimit, duke sjellë shtyrjen e seancave. Në dosje nuk ka akte njoftimi për palët.*

96.2.1 Në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni në lidhje me mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe në kundërshtim të shkakut të ankimit gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar: *[...] 12 seanca gjyqësore janë shtyrë për mungesë të të*

pandehurave dhe të mbrojtësve të tyre, e barabartë me më shumë se 6 muaj periudhë kohore. Një nga parimet bazë të sanksionuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Kushtetutë dhe Kodin e Procedurës Penale, është e drejta e çdo personi për t'u njohur me akuzën në ngarkim të tij dhe për t'i dhënë mundësinë të dëgjohet përpara një gjykate, nën praninë e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij apo të caktuar nga shteti dhe për të paraqitur edhe provat e tij. Shkelja e këtyre rregullave passjell rigjykimin e çështjes, e për pasojë, zvarritje në dhënien e drejtësisë dhe cenimin e besimit dhe të imazhit të drejtësisë në sy të publikut. [...] Megjithatë kur kam konstatuar se mungesa e të pandehurave apo mbrojtësve të tyre është e pajustificuar, kam proceduar me vijimin e gjykimit në mungesë dhe/apo me caktimin e mbrojtësve kryesisht për të garantuar ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e procesit penal. [...] Nga pesë dosjet e përzgjedhura me short, vetëm njëra prej tyre ka përfunduar tej afatit të parashikuar nga pika 5/a e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve.

96.2.2 Subjekti i rivlerësimit, në dhënien e shpjegimeve të rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, ka shpjeguar se dosja e çështjes penale nr. {***}, datë 26.10.2011, nuk është administruar e plotë nga KLGj-ja dhe e tillë është përcjellë në Komision. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit i ka vënë në dispozicion Komisionit dosjen e plotë të çështjes penale⁵⁷ objekt kontrolli, nga verifikimi i së cilës, trupi gjykues konstatoi se veprimet procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit që kanë të bëjnë me njoftimet e palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve janë dokumentuar dhe janë të pasqyruara në fashikullin përkatës, gjithsej 59 fletëthirrje dhe njoftime për të pandehurat, avokatët, dëshmitarët, ekspertët dhe prokurorin. Gjithashtu, rezultoi se ka pasur komunikim të subjektit të rivlerësimit me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, për zbatimin e rreth 15 urdhrave të gjyqtarit për njoftimin e të pandehurave, dëshmitarëve apo ekspertëve, për njoftimin e të cilëve megjithëse është lëshuar fletëthirrje, nuk janë paraqitur në gjykim.

Në rastet e mungesave të paarsyeshme të të pandehurave apo mbrojtësve të tyre, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka proceduar me vijimin e gjykimit në mungesë apo me caktimin e mbrojtësve kryesisht. Këto veprime evidentohen në seancat gjyqësore të datës 12.12.2012 dhe datës 28.06.2013, ku për shkak të mungesës së paarsyeshme të së pandehurës A. A. dhe avokatit të saj, është caktuar, kryesisht, avokate N. P., si dhe në seancën e datës 10.09.2013, në të cilën për shkak të mungesës së paarsyeshme të së pandehurës A. A. dhe avokatit të saj është caktuar kryesisht avokate M. R.⁵⁸.

Nga situata faktike e mësipërme e gjendjes së akteve në dosjen e çështjes nr. {***}, datë 26.10.2011, duke i ballafaquar ato dhe me përmbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore, trupi gjykues arriti në konkluzionin se konstatimi i raportit të KLGj-së lidhur me aktet e njoftimit, ka ardhur si pasojë e mungesës së këtyre akteve në dosjen e verifikuar nga KLGj-ja, pasi ajo nuk është administruar e plotë, për rrjedhojë grupi i punës së KLGj-së është gjendur në pamundësi të verifikimit të tyre. Trupi gjykues vlerësoi se gjendja e akteve të njoftimit në dosjen e plotë të përcjellë nga subjekti i rivlerësimit në Komision, provon faktin se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale në drejtim të njoftimit të palëve, për organizimin e procesit gjyqësor.

96.3 Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se shumë shtyrje dhe zvarritje të procesit gjyqësor kanë ardhur prej mosmenaxhimit të mirë të agjendës dhe kalendarit nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke bërë që të krijohen përplasje datash midis angazhimeve të tjera dhe datave të planifikuara për seancë gjyqësore, trupi gjykues konstatoi nga të dhënat e raportuara në raportin e KLGj-së se vetëm 4, nga 47 seanca gjyqësore gjithsej, dhe 38 shtyrje

⁵⁷ Gjykata e Lartë, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.05.2021, i ka vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit dosjen penale të çështjes nr. {***}, datë 26.10.2011.

⁵⁸ Këto të dhëna rezultojnë nga raporti i KLGj-së nr. {***} prot., datë 25.06.2019, për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

seancash gjyqësore kanë ndodhur për shkak të përplasjeve të datave të seancave gjyqësore me angazhimet e tjera të subjektit të rivlerësimit.

96.3.1 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe në kundërshtim të pretendimeve të Komisionerit Publik gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka parashtuar se: [...] Vetëm 4 nga 38 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkaqe të pavarura nga puna si gjyqtar, nga të cilat: seanca e datës 13.12.2011 është shtyrë, për shkak se, duke qenë pjesë e grupit të punës për ngritjen dhe funksionimin e Shërbimit të Provës [...] jam përzgjedhur për të trajnuar punonjësit e drejtësisë dhe të agjencive të zbatimit të ligjit, lidhur me dënimet alternative. [...] Si moderatore e këtij takimi ishte përcaktuar znj. A.B., gjyqtare në Gjykatën e Krimeve të Rënda, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Lartë. Për shkak të angazhimeve të saj të papritura, gjyqtarja më ka kërkuar, nëpërmjet e-mail-it të saj, që ta zëvendësoj, me qëllim evitimin e dështimit të këtij seminari trajnues mjaft të rëndësishëm; seanca e datës 20.02.2012, është shtyrë për shkak se gjykimi i çështjes pararendëse me të pandehur A. J. dhe të tjerë, ka zgjatur disa orë, tej kohës së parashikuar nga unë prej 1 ore, për shkak të pyetjes së dëshmitarëve [...]; seanca e datës 30.04.2012, është shtyrë për shkak se kam qenë i angazhuar në projektet e ndryshme, lidhur me reformimin e sistemit të drejtësisë në vend, kryesisht atij penitenciar dhe shërbimit të provës, pasi takimet për këtë qëllim zhvilloheshin ndonjëherë në mënyrë të paparashikuar; seanca e datës 30.04.2013 është shtyrë, pasi ish-KLD-ja kishte shpallur datën e konkursit për t'u emëruar si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Administrativ, e cila u krijua për herë të parë me ligjin nr. 49/2012 [...].

96.3.2 Bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet në mbështetje të pretendimeve të tij, si më poshtë.

- Korrespondencën e tij nëpërmjet postës elektronike me znj. A. B., e kryer midis datave 16.11.2011 dhe 20.11.2011, në të cilën shprehet nevoja e pjesëmarrjes së subjektit të rivlerësimit në cilësinë e moderatorit, në një trajnim për shërbimin e provës, i cili do të zhvillohej më datë 13.12.2011.

- Tabelën e regjistrimit të orareve të gjyqeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për datën 20.02.2012, sipas së cilës, në orën 12:30 ishte caktuar seanca gjyqësore për çështjen penale me të pandehur A. J., dhe në orën 13:30 ishte caktuar seanca gjyqësore për çështjen penale me të pandehur A. A., si dhe procesverbalin e seancës gjyqësore për çështjen penale me të pandehur A. J., sipas të cilit seanca gjyqësore, datë 20.02.2012, ka filluar në orën 12:35 dhe ka përfunduar në orën 15:20 të po kësaj date.

- Shkresën nr. {***} prot., datë 12.05.2021, të KLGj-së, me anë të së cilës i është përcjellë subjektit të rivlerësimit me kërkesë të tij, rezultati i provimit të organizuar në muajin prill 2013 nga KLD-ja, për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit është renditur i shtati.

96.3.3 Në analizë të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se shtyrjet e seancave gjyqësore për shkak të angazhimeve të tjera të subjektit të rivlerësimit, kanë qenë të justifikuara, por megjithatë ato mund të shmangeshin me një kujdes të shtuar të subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues çmon të theksojë se konkluzioni i mësipërm nuk mund të sjellë ndikim në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, pasi numri i seancave të shtyra për shkak të angazhimeve të tjera të tij është shumë i vogël krahasuar me numrin total të seancave gjyqësore joproductive në çështjen objekt kontrolli, por edhe nga pesë dosjet/çështjet gjyqësore të shortuara, vetëm për këtë çështje është konstatuar nga KLGj-ja se kohëzgjatja e gjykimit ka tejkalar afatin 9-mujor të përcaktuar në Aneksin 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve.

96.4 Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se asnjë nga seancat gjyqësore nuk është dokumentuar nga regjistrimet audio, ashtu siç kërkohet ligjërisht nga neni 115 i Kodit të

Procedurës Penale dhe nuk referohet askund në raportin e KLGj-së se nuk ka qenë i mundur regjistrimi audio, trupi gjykues vëren se në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni, si dhe në parashtrimet e tij në kundërshtim të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *Në nenin 115 të Kodit të Procedurës Penale parashikohen format, mjetet dhe mënyrat e mbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore. Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme që ka qenë në fuqi në vitet 2011 – 2013, por edhe dispozitës që është sot në fuqi, rezulton se regjistrimi audio nuk është i detyrueshëm por fakultativ, në bazë të mundësive objektive që ka gjykata ku ushtron detyrën gjyqtari i caktuar (ka të instaluar ose jo një sistem regjistrimi audio, nëse ky sistem është mjaftueshëm i instaluar në sallat e gjykimit për të përballuar regjistrimin audio të të gjitha seancave, nëse është eficient ose jo etj.), si dhe natyrës dhe kompleksitetit të proceseve që zhvillohen në këtë gjykatë. Në bazë të shkresës nr. {***} prot., datë 07.05.2019, të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se regjistrimi audio i seancave gjyqësore në Dhomën Penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar mbi bazën e urdhrin nr. {***} prot., datë 15.05.2013, të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vlen të theksohet se edhe në këtë periudhë kanë qenë të disponueshme vetëm 7 salla gjyqi për 15 gjyqtarë. Ndërkohë që, sipas urdhrin nr. {***} prot., datë 18.06.2014, të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur aplikimi i sistemit audio, duke shfrytëzuar sallat e gjyqit në Dhomën Penale, sipas një kalendari të caktuar, i cili duhet thënë se në shumë raste, nuk përputhej me nevojat e proceseve që zhvilloheshin në një ditë, në Dhomën Penale. Sa më sipër, qartazi arrihet në përfundimin se mosregjistrimi në audio i seancave gjyqësore të çështjes, ka ardhur si pasojë e mosekzistencës së një sistemi të tillë deri në datën 15.05.2013.*

96.4.1 Në mbështetje të shpjegimeve të tij mbi rezultatet e hetimit administrativ të paraqitura në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën nr. {***} prot., datë 07.05.2021, të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁵⁹, sipas së cilës: [...] *me urdhrin nr. {***} prot., datë 15.05.2013, është urdhëruar fillimi i regjistrimit audio të seancave gjyqësore të cilat zhvillohen në sallat e gjykimeve, me urdhrin nr. {***} prot., datë 15.05.2013, është vendosur regjistrimi audio i të gjitha seancave gjyqësore të cilat zhvillohen në sallat e gjykimeve pranë Dhomës Civile, ndërsa me urdhrin nr. {***} prot., datë 18.06.2014, është vendosur aplikimi i sistemit audio duke shfrytëzuar sallat e gjyqit në Dhomën Penale sipas një kalendari të caktuar. Gjithashtu, në përmbajtjen e shkresës referohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në periudhën 2011-2013, në Dhomën Penale të përbërë nga 15 gjyqtarë, ka pasur 7 salla gjykimi. Bashkëlidhur shkresës së referuar më sipër, gjenden urdhrat e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cituar në përmbajtjen e saj. Sipas pikës 3 të urdhrin nr. {***} prot., datë 15.05.2013, “Mbi fillimin e regjistrimit audio të seancave gjyqësore”, zhvillimi i të gjitha gjykimeve do të bëhet nëpër salla sipas kalendarit të shfrytëzimit të sallave, me përjashtim të rasteve kur sallat janë të zëna, raste të cilat detyrojnë gjyqtarët të motivojnë zhvillimin e seancave nëpër zyra.*

96.4.2 Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik, në raport me situatën faktike si më sipër dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vëren se neni 115 i Kodit të Procedurës Penale, sipas parashikimeve të kohës kur është gjykuar çështja, përcaktonte se:

⁵⁹ Subjekti i rivlerësimit, me anë të shkresës datë 05.05.2021, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me “Kërkesë për marrje informacioni”, në përgjigje të së cilës, kryetari i kësaj gjykate, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.05.2021, i ka përcjellë informacionin lidhur me fillimin e regjistrimit audio të seancave gjyqësore, numrin e sallave të pajisura me këtë sistem regjistrimi dhe numrin e gjyqtarëve të Dhomës Penale të kësaj gjykate, në periudhën 01.12.2011 - 31.12.2013.

1. Dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal.

2. Procesverbali përpilohet nga sekretari i gjykatës, në formë të plotë ose të përmbledhur, me stenotipi, me mjet tjetër teknik dhe, kur mungojnë këto mjete, me dorëshkrim.

3. Kur procesverbali përpilohet në formë të përmbledhur duhet të bëhet edhe riprodhimi fonografik dhe, po të jenë kushtet, edhe riprodhimi audioviziv kur është i domosdoshëm.

Ndërsa në udhëzimin e ministrit të Drejtësisë me nr. {***}, datë 15.06.2012, “Për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”⁶⁰, në nenin 26 përcaktohet se zbatimi i këtij udhëzimi nga secila gjykatë, fillon në momentin e përfundimit të instalimit të pajisjeve digjitale të regjistrimit audio në gjykatën përkatëse.

Në mbështetje të parashikimit ligjor të sipërcituar, i lexuar në harmoni edhe me përcaktimet e aktit nënligjor të ministrit të Drejtësisë dhe urdhrin nr. {***} prot., datë 15.05.2013, të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, trupi gjykues çmon se është i bazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se regjistrimi audio i seancave gjyqësore nuk ka qenë i detyrueshëm. Nga verifikimi i datave të procesverbaleve të seancave gjyqësore të çështjes objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi se seanca e parë gjyqësore është zhvilluar më datë 26.10.2011, ndërsa e fundit është zhvilluar më datë 26.12.2013. Në periudhën 7-mujore, nga data 15.05.2013, si datë e nxjerrjes së urdhrin të kryetarit të gjykatës për fillimin e funksionimit të sistemit audio, janë zhvilluar vetëm 14 seanca gjyqësore pa përdorimin e regjistrimit audio, siç rezulton nga procesverbalet gjyqësore. Në analizë të panoramës faktike dhe parashikimeve ligjore të pasqyruara më sipër, trupi gjykues çmoi të mbante në konsideratë se zhvillimi i gjykimeve në salla, bëhej sipas një kalendari të caktuar dhe në varësi të disponibilitetit të sallave, ashtu siç urdhërohej në aktin nënligjor të nxjerrë nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pasojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se mospërdorimi i regjistrimit audio në seancat gjyqësore të çështjes objekt kontrolli, ka ndodhur për shkaqe objektive, është i bazuar.

97. Në përfundim të shqyrtimit e analizës së këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, për pasojë nuk evidentohen veprime në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 96/2016, të tilla që të afektojnë vlerësimin e aftësive profesionale të kryer nga Komisioni, apo që çojnë në konkluzionin se, në vlerësimin tërësor të çështjes, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
98. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Gerd Hoxha ka arritur nivel të besueshëm në të tria kriteret e rivlerësimit dhe nuk ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, për pasojë ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerësoi se vendimi i Komisionit nr. 393, datë 03.06.2021, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

⁶⁰ Botuar në Fletore Zyrtare nr. 68, datë 20.06.2012, faqe 3267.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 06.07.2022.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi – kundër

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi - kundër

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me zgjidhjen e çështjes me vendimin nr. 27 (JR), datë 06.07.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha, por ndaj mendim ndryshe nga shumica lidhur me dy momente në arsyetimin e përdorur në vendim, për të cilat kam mbajtur të njëjtin qëndrim në çështje të ngjashme, gjatë shqyrtimit të tyre në Kolegj, e konkretisht:
2. Në paragrafin 37.2.1 të vendimit është analizuar koncepti i *dorëzansë*, duke konkluduar: [...], *Trupi gjykues vlerëson se fakti që subjekti i rivlerësimit ka qenë dorëzansë në kredinë e marrë nga znj. Ll., nuk e vendos atë në kushtet e detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve të shlyerjes së kësaj kredie, pasi marrëdhënia juridike e dorëzansë, ndonëse përfaqëson interesa pasurorë, nuk hyn në rrethin e marrëdhënieve të cilësuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të cilat vendosin detyrimin e subjektit të rivlerësimit për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive, qëndrim ky i mbajtur tashmë në jurisprudencën e Kolegjit [...].*
3. Pavarësisht marrëdhënieve të parashikuara në kuadër të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të cilat parashikojnë detyrimin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, *dorëzania* si një veprim juridik, në vlerësimin tim, gjen rregullim në nenin 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, referuar të cilit: *“Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.* Në këtë kuadër, çmoj se ekziston marrëdhënia e interesit pasuror mes subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha dhe subjektit Emporiki Bank ShA, pasi në *kontratën e kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2009*, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar në cilësinë e dorëzansës. *Dorëzania*, në kuptim të neneve 585 dhe 589 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, është një veprim juridik me të cilën dorëzansësi detyrohet t'i sigurojë kreditorit ekzekutimin e detyrimit të debitorit për aq sa detyrohet ky i fundit. Në kushtet kur dorëzania barazohet me kredimarrësin, ndaj mendim ndryshe me arsyetimin e përdorur në vendim për këtë çështje, pasi, në gjykimin tim, dorëzansësi në këtë rast, ngarkohet gjithashtu me detyrimin ligjor, ashtu si kredimarrësi, për të justifikuar mënyrën e shlyerjes së kredisë. Më tej, për sa i përket likuidimit të kredisë nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, jam me arsyetimin e përdorur nga shumica.
4. Në paragrafin 78 të vendimit, shkruhet specifikisht: *Pavarësisht se trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë automjet, tip “Audi”, në përdorim të tij, me qëllim shterimin e shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, vendosi të verifikojë shkakun e ankimit të Komisionerit Publik lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për të blerë këtë pasuri, në vitin 2011.*

Sa i takon përdorimit të një pasurie në pronësi të dikujt tjetër, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të *Aneksit të Kushtetutës*, subjektet e rivlerësimit, përveç detyrimit për të deklaruar dhe evidentuar saktë marrëdhënien juridike që e lidh me pasurinë në pronësi apo në përdorim, kanë detyrim të deklarojnë burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, si dhe të justifikojnë ligjshmërinë e burimit. Në gjykimin tim, verifikimi i ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive në përdorim, duhet të kryhet nga Kolegji në të gjitha rastet kur kjo marrëdhënie përdorimi provohet dhe jo vetëm të kufizohet në përgjigje të shkaqeve të ngritura në ankim. Në analizën e bërë nga trupi gjykues për mundësinë financiare të blerjes së këtij automjeti nga familja H., jam dakord me arsyetimin e shumicës.

5. Pavarësisht qëndrimit tim lidhur me trajtimin e institutit të dorëzarisë, si dhe detyrimin ligjor për justifikimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurive në përdorim/posedim, parashtuar më sipër në këtë mendim paralel, shpreh dakordësinë me analizën e bërë në vlerësim të përgjithshëm të çështjes dhe zgjidhjen përfundimtare të saj.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtarët Ina Rama dhe Sokol Çomo, kemi votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket ankimit të Komisionerit Publik Darjel Sina, kundër vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), vendim i cili ka konfirmuar në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, subjektin e rivlerësimit Gerd Hoxha. Kemi votuar kundër vendimit të shumicës duke mbajtur qëndrimin se vendimi i Komisionit që kishte konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, ishte marrë në zbatim të gabuar të ligjit e në kundërshtim me faktet të cilat kanë rezultuar nga hetimi administrativ e gjyqësor, duke u mbështetur në konkluzionet e mëposhtme.

2. ***Për pasurinë, apartament banimi me sipërfaqe 125 m², të ndodhur në Tiranë:***

Kemi ndarë qëndrim të ndryshëm me shumicën për sa i përket vlerësimit të çështjeve që kanë të bëjnë me:

- i. pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për justifikuar shumën prej 2.500.000 lekësh, të deklaruar si gjendje *cash* në banesë në vitin 2003, në vlerën prej (-) 1.281.804 lekësh;
- ii. pretendimin e Komisionerit Publik lidhur me huan e marrë prej personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, znj. E. Ll., në vlerën prej 25.000 eurosh, e cila ka shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë po prej saj në Emporiki Bank, në vitin 2009, për sa i përket (i) lidhjes së subjektit me këtë hua; dhe (ii) mundësisë së personave të tjerë të lidhur, prindërit e personit të lidhur, për të justifikuar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua.

3. Lidhur me çështjen e parë, ndajmë të njëjtin konkluzion si shumica e trupit gjykues se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të justifikojë me burime të ligjshme krijimin e shumës prej 1.500.000 lekësh, të deklaruar se është fituar prej tij nga marrëdhënia e punës në sektorin privat. Pavarësisht disa qëndrimeve të ndryshme në drejtim të analizës ligjore të fakteve juridike që lidhen me këto marrëdhënie të subjektit, për efekt të këtij arsyetimi, po kufizohemi në konkluzionin e njëjtë me shumicën, që shuma e cituar më lart nuk u provua se është krijuar me të ardhura të ligjshme. Si rrjedhojë e këtij konkluzioni të konkretizuar në analizën financiare të kryer në Kolegj, rezulton se për shkak të mospërfshirjes së kësaj shume në analizën financiare, për periudhën 1995-2003, ai gjendet në kushtet e pamundësisë për të krijuar me burime të ligjshme pasurinë likuiditet, të deklaruar prej tij në vlerën prej 2.500.000 lekësh, në një vlerë negative prej (-) 1.281.804 lekësh.

3.1. Në këto kushte, ne kemi vlerësuar se pretendimi i Komisionerit Publik në ankim, por edhe në konkluzionet përfundimtare se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme krijimin e kësaj të ardhure, në vlerën e cituar më lart, është i saktë dhe, si i tillë, duhet pasqyruar edhe në vendim. Konkluzioni i arritur nga shumica dhe i bërë prezent në paragrafin 18 të vendimit, se të ardhurat prej 1.500.000 lekësh nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, mbetet një konkluzion që nuk i përgjigjet plotësisht kërkit të Komisionerit Publik dhe që për më tepër nuk përfaqëson sipas konceptit të ligjit, efektin që ky përfundim ka në verifikimin dhe kontrollin e burimeve të krijimit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit. Ky konkluzion i shumicës do të duhej të

konkretizohej, sipas vlerësimit tonë, me deklarin e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë likuiditet në vitin 2003, sipas përcaktimit të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe qëllimit të vetë procesit të rivlerësimit.

4. Lidhur me çështjen e dytë që i përket shumës prej 25.000 eurosh, të marrë hua prej personit të lidhur, znj. E. Ll., nga prindërit e saj, kemi ndarë një qëndrim të ndryshëm nga shumica për të dyja pretendimet që ka ngritur Komisioneri Publik, qoftë për detyrimin dhe përgjegjësinë e subjektit në drejtim të provueshmërisë së burimit të krijimit të kësaj shume, por edhe në drejtim të mundësisë së personave të tjerë të lidhur për ta justifikuar atë me burime të ligjshme.

4.1. Sipas vlerësimit tonë, në analizë të fakteve që kanë rezultuar të provuara nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, rezulton një situatë e ndryshme nga shumica në drejtim të lidhjes dhe interesit të subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e huas ndaj Bankës Emporiki, të marrë për rikonstruksionin e apartamentit prej 125 m², të ndodhur në Tiranë.

4.2. Sipas deklarin të subjektit në deklaratën *vetting*, personi i lidhur, znj. E. Ll., ka marrë hua shumë prej 25.000 eurosh nga prindërit e saj me qëllim shlyerjen e kredisë, marrë po prej saj në Bankën Emporiki në vitin 2009, me qëllim rikonstruksionin e apartamentit prej 125 m². Sipas kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2009, personi i lidhur ka marrë hua nga Banka Emporiki shumë prej 25.000 eurosh, e cila do të përdorej për rikonstruksionin e apartamentit me sipërfaqe 125 m², në Tiranë, kontratë e cila është nënshkruar edhe nga subjekti i rivlerësimit dhe znj. A. Ç., në cilësinë e dorëzanësve. Kjo hua ndaj bankës është shlyer plotësisht më 02.02.2011, me anë të pagimit të plotë të detyrimit të mbetur nëpërmjet përdorimit të shumës prej 25.000 eurosh, marrë hua prej prindërve të personit të lidhur. Nëpërmjet këtij veprimi, ka përfunduar cilësia edhe detyrimi i subjektit të rivlerësimit, si dorëzanës për shlyerjen e saj.

4.3. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, i bërë prezent gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe i mbështetur nga shumica e trupit gjykues, se ai nuk ka përgjegjësi për justifikimin e burimeve të ligjshme të kësaj huaje, sepse në kohën e marrjes së saj ai ishte vetëm në statusin si i fejuar me personin e lidhur dhe se apartamenti i cili do të rikonstruktohej me anë të kredisë, jo vetëm nuk i përkiste subjektit, por ai as gëzonte posedimin faktik të tij, mbetet, sipas vlerësimit tonë, si paprovuar dhe i pabesueshëm, duke pasur në konsideratë rrethanat e mëposhtme.

4.4. Dorëzania është një institut i së drejtës civile, i parashikuar në Kodin Civil për të garantuar shlyerjen e detyrimeve ndaj personave të tretë. Sipas parashikimit të nenit 585 të Kodit Civil: *Dorëzania është një veprim juridik me të cilin një person (dorëzanësi) detyrohet t'i sigurojë kreditorit ekzekutimin e detyrimit të një personi të tretë (debitori kryesor)*. Në nenin vijues të Kodit Civil, veçanërisht në nenin 590, paragrafi i parë parashikohet se: *Dorëzanësi është i detyruar solidarisht me debitorin kryesor për ekzekutimin e detyrimit, përveç kur është parashikuar ndryshe në marrëveshje*.

4.5. Nga leximi i këtyre dispozitave dhe nenit 423 të Kodit Civil, i cili parashikon se: *Detyrimi është solidar kur kreditori ose secili nga kreditorët ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e së njëjtit detyrim tërësisht apo pjesërisht si nga debitorët së bashku, ashtu edhe nga secili prej tyre veç e veç*, kuptohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur qëndronin karshi

Bankës Emporiki si debitorë solidarë për marrëdhënien e huas lidhur me këtë ent financiar, dhe se të dy së bashku, në kuptim të dispozitave të Kodit Civil, do të përgjigjeshin me pasuritë e tyre, në rast të mosekzekutimit të detyrimit që personi i lidhur kishte ndaj bankës lidhur me shlyerjen e kredisë.

4.6. Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit se ai ishte thjesht një dorëzanës të cilit nuk i interesonte fati i shlyerjes ose jo të kredisë, e cila lidhej vetëm me personin e lidhur, duket i pambështetur ligjërisht. Përfshirja në një marrëdhënie të tillë juridike, me këtë status, do të thotë që subjekti i rivlerësimit ka pranuar të lindin disa detyrime të mirëpërcaktuara prej ligjit dhe dispozitave të veçanta të kontratës së huas bankare, të cilat nuk mund të interpretohen në një mënyrë të ndryshme, për të zbehur përgjegjësinë që vjen nga kjo pjesëmarrje. Për shkak të kësaj përgjegjësie, ka ardhur si pasojë edhe përfitimi pasuror që ai ka pasur nga huaja prej 25.000 eurosh, e cila e ka çliruar atë nga çdo detyrim solidar ndaj bankës.

4.7. Lidhur me pretendimin se apartamenti i cili iu nënshtrua rikonstruksionit, nuk ishte në posedimin e subjektit deri në momentin që ai filloi bashkëjetesën me personin e lidhur dhe nënshkroi kontratën e shitjes me pronarët e apartamentit, znj. A. Ç. e z. A. Ç., kemi arritur në konkluzionin se është një pretendim që nuk gjen mbështetje në faktet që rezultojnë nga aktet e administruara nga hetimi administrativ. Nga analiza e të dhënave që rezultojnë në dosje, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë nisur jetesën faktike në apartamentin për rikonstruksionin e të cilit u mor huaja më parë se kjo bashkëjetesë të deklarohej prej subjektit në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2011.

4.8. Nga kontrata e huas të lidhur me Bankën Emporiki, me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 26.03.2009, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e dorëzanësit, dhe personi i lidhur, znj. E. Ll., në cilësinë e huamarrëses, deklarojnë të njëjtën adresë banimi, përkatësit: *rruga "{***}"*, *pall. {***}*, *shk. {***}*, *ap. {***}*, *Tiranë*, e cila është adresa e apartamentit prej 125 m², për të cilin po merrej kredia. Në një deklaratë bashkangjitur kësaj kontrate huaje, personi i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit kanë deklaruar se i gjithë informacioni që ata kanë dhënë, është i saktë dhe i plotë. Gjithashtu, në nenin 19 të kontratës së huas, është parashikuar se të gjitha njoftimet që do t'i drejtohen dorëzanësit, si edhe huamarrësit, do të konsiderohen të kryera po qe se janë dërguar në adresën: *rruga "{***}"*, *pall. {***}*, *ap. {***}*, *Tiranë*, pra në të njëjtën adresë të deklaruar prej tyre si vendbanim e që i përket apartamentit prej 125 m², ose në adresa që i adresuari përkatës mund të përcaktojë në të ardhmen me shkrim për këtë. Këto elemente tregojnë se vendbanimi i subjektit në këtë apartament, kishte nisur efektivisht, për sa kohë adresa ishte e deklaruar duke pasur edhe një konsekuencë ligjore specifike që lidhej me njoftimet.

4.9. Sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 26.02.2009, të shtetasve A. e A. Ç., me cilësinë e bashkëpronarëve të apartamentit objekt rikonstruksioni, rezulton se ata kanë marrë përsipër nëpërmjet këtij deklarimi, të kalojnë pronësinë e këtij apartamentit në favor të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur brenda një viti nga data e hartimit të deklaratës, rrethanë që tregon se interesi i subjektit në marrjen e kredisë për rikonstruksionin e apartamentit, ishte i njëjtë si ai i personit të lidhur, përderisa sendi do të kalonte në bashkëpronësi të përbashkët brenda vitit. Të njëjtin parashikim e gjejmë edhe në nenin 7, paragrafi 7 i kontratës së huas bankare, sipas të cilit përcaktohet se: *huamarrësi do të*

transferojë titullin e pronësisë nga A. (LL.) Ç. dhe A. Ç. tek E. Ll. dhe Gerd Hoxha brenda datës 31.03.2010. Kjo kontratë është e nënshkruar prej subjektit si dorëzanës, për pasojë provohet dijenia e tij e plotë rreth të ardhmes së afërt të tij me këtë pasuri në terma ligjorë, si bashkëpronar i saj.

4.10. Nga akti “Njoftim për shlyerje të parakohshme”, drejtuar Bankës Emporiki, personi i lidhur rezulton se ka deklaruar se kredia prej 25.000 eurosh, është marrë për blerje apartamenti, rrethanë e cila vendos në diskutim/dyshim të gjitha deklaratimet e subjektit dhe personit të lidhur në lidhje me destinacionin e kredisë, e për pasojë të gjitha shpjegimet e dhëna prej tyre përgjatë procesit të rivlerësimit.

4.11. Sipas aktit të titulluar “Raport vlerësimi”, i përpiluar prej studios “{***}” ShPK, që mban datën 26.02.2009, e të depozituar në bankë për plotësimin e kritereve që mundësonin marrjen e kredisë, rezulton se vlera e tregut e kësaj pasurie në momentin e marrjes së kredisë ishte 150.000 euro. Nga pamjet fotografike që shoqërojnë këtë akt, duket se punimet e nevojshme për ta bërë këtë apartament të banueshëm sërish, nuk mund të marrin kohën e pretenduar prej subjektit, për gati dy vjet, deri në mars 2011, duke qenë se apartamenti ka qenë i ndërtuar plotësisht dhe i banueshëm edhe para këtij momenti, ndërsa ndërhyrjet e konsideruara si rikonstruksion, janë të nivelit përmirësues e arredues, punime që kërkojnë në çfarëdo rrethane më pak kohë në dispozicion për t’u kryer.

4.12. Rezulton, nga hetimi administrativ, se disa prej kësteve të kredisë janë paguar pranë Bankës Emporiki prej subjektit të rivlerësimit, e dhënë që tregon për një pjesëmarrje me përgjegjësi të plotë të subjektit në këtë marrëdhënie.

4.13. Nga leximi i të dhënave që rezultojnë në faqen zyrtare të ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se apartamenti në fjalë ka të faturuara për shërbimin e furnizimit me ujë, që nga muaji nëntor 2009, pothuaj në mënyrë të njëtrajtshme e në shifra të arsyeshme për abonent familjar.

4.14. Për të gjitha argumentet e renditura më lart, pakica ka arritur në konkluzionin e ndryshëm nga shumica, se ka mjaftueshëm të dhëna që tregojnë se jetesa e subjektit të rivlerësimit në apartamentin e ndodhur në Tiranë, ka filluar kohë më parë se ajo të deklarohej në deklaratën periodike të pasurisë në vitin 2011, element që tregon koneksitetin e subjektit me këtë pasuri dhe të gjithë aksesoret që e shoqërojnë atë jo vetëm për shkak të të qenit dorëzanës, por edhe për shkak të posedimit e përdorimit të kësaj pasurie që në momentin e marrjes së kredisë ose në një kohë afër saj.

4.15. Në këto kushte, ne, gjyqtarët në pakicë, kemi arsyetuar se subjekti i rivlerësimit, i ndodhur në pozicionin e dorëzanësit për një kredi të marrë për rikonstruksionin e një apartamenti në të cilin në mos banonte në momentin e marrjes së kredisë, ka banuar menjëherë pas rikonstruksionit, si dhe ka pasur ndërgjegjësimin të plotë se ky apartament do të kalonte në bashkëpronësi të tij brenda një viti, duhet konsideruar për efekt të ligjit nr. 84/2016 se ka pasur një marrëdhënie detyrimi me Bankën Emporiki, njësoj si personi i lidhur. Për sa më sipër, huaja që ka marrë personi i lidhur, znj. E. Ll., nga prindërit e saj në vitin 2011, për të shlyer të gjithë vlerën e kredisë bankare, e për pasojë për të shlyer edhe detyrimin e subjektit të rivlerësimit

ndaj kësaj banke, duhet të konsiderohet si një hua që ka shërbyer si e tillë edhe për subjektin e rivlerësimit e, për pasojë, prindërit e personit të lidhur duhet të konsiderohen si persona të tjerë të lidhur edhe për subjektin e rivlerësimit Gerd Hoxha, i cili do të ketë në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit, detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë prej 25.000 eurosh, të marrë hua prej tyre.

5. Lidhur me çështjen e provueshmërisë së burimit të krijimit të kësaj shume nga huadhënësit, sërish kemi ndarë mendim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues, duke arritur në konkluzionin se personat e tjerë të lidhur nuk justifikojnë me të ardhura të ligjshme të dokumentuara, krijimin e shumës prej 25.000 eurosh, të dhënë hua personit të lidhur, analizuar faktet si më poshtë.

5.1. *Së pari*, rezulton se kjo shumë është deklaruar fillimisht në deklaratën periodike të vitit 2011 prej personit të lidhur, znj. E. Ll., si e marrë **hua** prej prindërve të saj, pa interes dhe pa afat, dhe se ka shërbyer për shlyerjen e kredisë. Në këtë seksion, nuk ka deklarime për burimin e krijimit të kësaj shume prej prindërve, rrethanë që duket e natyrshme për shkak të mospasjes së detyrimit ligjor për deklarimin e këtyre burimeve për huadhënësit. Nga procesverbali i datës 10.01.2015, i mbajtur në ILDKPKI, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë dhënë shpjegime mbi disa paqartësi të hasura nga institucioni gjatë kontrollit të deklarimeve të tyre në vite dhe, ndër të tjera, rezulton të kenë deklaruar edhe për me huan prej 25.000 eurosh, duke u shprehur se: *Shuma prej 25.000 eurosh, që i është dhuruar znj. E. LL. nga babai i saj, z. Xh. Ll., është dhënë cash, pa ndonjë akt të shkruar, për shkak të marrëdhënies së posaçme prind-fëmijë. Kjo shumë është siguruar nga z. Xh. LL. dhe znj. L. Ll. nga kursimet e tyre familjare ndër vite dhe mbahej prej tyre në banesë, në formën cash.*

5.2. *Së dyti*, Nga hetimi administrativ i kryer për subjektin e rivlerësimit, konkretisht nga përgjigjet e dhëna prej tij për pyetësorët e drejtuar nga Komisioni, nuk ka asnjë referim të detajuar mbi burimet që kanë përdorur prindërit e personit të lidhur për të krijuar këtë shumë. Subjekti ka shpjeguar në përgjigje gabimin e kryer prej tij në deklaratimet para ILDKPKI-së në vitin 2015, duke saktësuar se shuma është dhënë hua dhe jo dhuruar, por nuk ka shpjeguar se si prindërit e personit të lidhur e kanë krijuar këtë shumë.

5.3. Në përgjigjet e pyetësorit nr. {***}, në përgjigjen e pyetjes 16, duke argumentuar se subjekti nuk duhet të përgjigjet për këtë hua, ka referuar për burimin e krijimit të saj, akte të cituara po prej tij në përgjigjen nr. {***} të këtij pyetësori. Nga verifikimi i këtyre akteve, rezulton se një ndër to është edhe deklarata noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.06.2018, e lëshuar nga z. Xh. Ll. dhe znj. L. Ll.. Në këtë deklaratë, prindërit e personit të lidhur deklarojnë se si burim për krijimin e kësaj shume kanë shërbyer: *(i) pagat; (ii) pensioni mujor i z. Xh. LL. që nga viti 1994, në vlerën 28.300 lekë; (iii) pension mujor i znj. L. Ll. që nga viti 2000 e në vijim, në vlerën 13.000 lekë; (iv) shuma prej 40.000 lekësh në muaj, të dhëna nga vajza jonë A. Ll. (Ç.) që prej vitit 1995 dhe aktualisht, me qëllim përmbushjen e nevojave tona për jetesë mesatare dhe për çdo shpenzim tjetër që kemi pasur të nevojshëm.* Këtë burim për krijimin e kësaj shume, e citon për herë të parë edhe personi i lidhur, znj. E. Ll., në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, të drejtuar asaj prej Komisionit në procesin e saj të rivlerësimit.

5.4. Konstatimi i parë që bëhet në këto deklaratime, është fakti se përfitimi i shumës prej 40.000 lekësh në muaj nga prindërit e personit të lidhur prej vajzës së tyre, përmendet vetëm përgjatë procesit të rivlerësimit e nuk gjen gjurmë në asnjë dokument shkresor të mëparshëm. Subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar në mënyrë të përsëritur se nuk ka një kontratë formale e cila provon marrëdhënien e huas mes personit të lidhur dhe prindërve për shkak të lidhjes së posaçme, por nuk kanë treguar asnjë vëmendje për të provuar apo për të përcjellë ndonjë indicie për marrëdhënien e deklaruar mes motrës së personit të lidhur dhe prindërve të saj, për dhënien e shumës prej 40.000 lekësh çdo muaj, as në deklaratimet e bëra në ILDKPKI në vitin 2015, as në deklaratën *vetting* dhe as në përgjigjet e pyetësorit të parë të drejtuar prej Komisionit. Kjo e dhënë është shfaqur për herë të parë pas pyetjes drejtuar personit të lidhur prej Komisionit në pyetësorin nr. {***}, ndërkohë që detyrimi për provueshmërinë e burimeve të ligjshme të personave të tjerë të lidhur, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ishte i njohur që me hyrjen në fuqi të ligjit.

5.5. Në këtë situatë të provueshmërisë së përfitimit të kësaj shume periodikisht prej prindërve të personit të lidhur, si edhe duke vlerësuar rrethanat e tjera që rezultojnë nga aktet e administruara, kemi vlerësuar se edhe në versionin se kjo shumë u është dhënë prej motrës së personit të lidhur çdo muaj prindërve të saj, për gjithë vitet, 2005-2010, të marra në analizë, nuk krijohet bindja dhe mbetet e pabesueshme se prindërit e kanë përdorur atë për të krijuar kursimet në shumën prej 25.000 eurosh.

5.6. *Së pari*, vetë prindërit e subjektit në deklaratën noteriale të nënshkruar prej tyre, deklarojnë se këto të ardhura janë dhënë nga vajza e tyre A. Ll. me qëllim përmbushjen e nevojave tona për jetesë mesatare dhe për çdo shpenzim tjetër që kemi pasur të nevojshëm. Në këto kushte, është e natyrshme dhe logjike, madje edhe brenda traditës dhe kulturës së vendit që vajza e madhe të mbështesë financiarisht prindërit për të lehtësuar jetesën tyre, për ta përmirësuar atë e për ta çuar në një nivel dinjitoz në raport me mundësitë financiare të saj. Në këtë logjikë, duket e pabesueshme që prindërit, të gjendur gjithmonë nën kujdesin e mbështetjen e vajzës së madhe, e cila për më tepër ka mbështetur financiarisht edhe personin e lidhur, znj. E. Ll., referuar asaj çfarë ka rezultuar nga procesi i rivlerësimit të saj, të kenë pasur kujdesin (apo të kenë ndier nevojën) për të kursyer pikërisht nga ato para që janë destinuar për shpenzim, siç edhe ata vetë pohojnë. Nga hetimi administrativ, rezulton se prindërit kanë pasur edhe pasuri likuiditet të depozituar në sistemin bankar, e cila, sipas tyre, është krijuar pikërisht nga disponimi i kësaj ndihme, fakt që ndërsa konfirmon logjikën që sistemi bankar për ta ishte një opsion për të depozituar kursimet, bën njësoj të pabesueshëm pretendimin që ata kanë kursyer duke mbajtur në gjendje *cash* në banesë shumën prej 25.000 eurosh.

5.7. *Së dyti*, vlerësohet e pabesueshme që prindërit e personit të lidhur të jetonin duke kursyer të ardhurat që u jepeshin nga vajza e tyre pikërisht për të mos qenë nën presionin e një jete me kufizime, dhe këto kursime t'ia jepnin hua vajzës tjetër, e cila, sipas deklaratave të saj, kishte 5.000.000 lekë gjendje në *cash*, të cilat i dispononte në këtë kohë në banesë.

5.8. *Së treti*, kontradiksioni për llojin e marrëdhënies, nga hua të deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë dhe në deklaratën *vetting*, në dhurim të shpjeguar në procesverbalin e ILDKPKI-së, pavarësisht saktësisht gjatë procesit të rivlerësimit, vlerësohet si një mungesë koherence e qartësie e cila afekton besueshmërinë në drejtim të ekzistencës së saj.

5.9. Në konkluzion, lidhur me këtë çështje, për shkak të gjithë konstatimeve të mësipërme, të cilat më së paku bëjnë të pabesueshëm faktin se nga shuma mujore dhënë prindërve të personit të lidhur prej vajzës së tyre, janë kursyer vlera që kanë kontribuar në krijimin e shumës prej 25.000 eurosh, kemi vlerësuar se si të ardhura të ligjshme mbi të cilat duhej të kryhej një analizë financiare me qëllim vlerësimin e mundësive për kursim të prindërve, duhet të jenë ato të dokumentuara prej institucioneve shtetërore, si të ardhura nga paga e pensionet të cilat duhen vlerësuar në raport me shpenzimet jetike të tyre, sipas standardit të INSTAT-it. Në këtë vlerësim, nuk janë llogaritur si shpenzim likuiditetet e përdorura për krijimin e depozitave prej personave të tjerë të lidhur, duke arsyetuar se ato, si një shpenzim tjetër për një nivel jetese më të mirë, mund të jenë krijuar prej shumave mujore të dhëna prej vajzës së tyre. Kemi arsyetuar se shpenzimet jetike sipas vlerësimit të INSTAT-it, janë një standard ligjor i aplikuar edhe për subjektet si një nivel bazik për përballimin e jetës, ndërsa jetesa ballafaqohet me nevoja të ndryshme të paparashikueshme, edhe për kategorinë e moshës së tretë, veçanërisht lidhur me shpenzimet për shëndetin, të cilat janë përballuar në këtë rast nga mbështetja financiare e vajzës, siç kanë deklaruar edhe ata vetë. Siç rëndom rezulton në procesin e rivlerësimit, edhe subjektet që i nënshtrohen këtij procesi, ngarkohen me shpenzime specifike përtej atyre të parashikuara nga INSTAT-i rast pas rasti, rrethanë që dëshmon se vlerësimi i pasurisë është një proces dinamik dhe në zbatim të parimit të objektivitetit. Duke kryer këtë analize vlerësuese, midis të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve jetike të personave të tjerë të lidhur, rezulton se ata nuk mund të kursenin shumën e dhënë hua personit të lidhur, me një pamundësi që shkon në vlerën prej 18.004 eurosh.

5.10. Në konkluzion, ndajmë qëndrimin se subjekti i rivlerësimit nuk përmbushi detyrimin ligjor për të provuar burimet e ligjshme të krijimit të shumës prej 25.000 eurosh prej personave të tjerë të lidhur, sipas detyrimit që i vjen nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

5.11. Në përmbledhje, lidhur me pasurinë apartament, të ndodhur në Tiranë, me sipërfaqe 125 m², konstatohet se pretendimi i Komisionerit Publik për çështje të trajtuara brenda këtij asemi të subjektit të rivlerësimit, se ka pasur mungesë burimesh të ligjshme për të krijuar pasurinë prej 2.500.000 lekësh në vitin 2003, në vlerën prej (-)1.281.804 lekësh, si dhe nuk justifikon plotësisht shumën e marrë hua prej personave të tjerë të lidhur prej 25.000 eurosh, gjendet i drejtë dhe duhet konsideruar si element në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

6. *Lidhur me pasurinë apartament, të ndodhur në Vlorë e të blerë në vitin 2016*

Kemi ndarë qëndrim të ndryshëm nga shumica dhe kemi rënë dakord me vlerësimin që ka bërë Komisioneri Publik lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e saj.

6.1. *Së pari*, vlerësojmë të rëndësishme të qartësojmë qëndrimin tonë lidhur me kufijtë e ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik për këtë pasuri, për të cilët kemi pasur një qëndrim të ndryshëm nga shumica, qëndrim i cili ka ndikuar dukshëm rezultatin përfundimtar lidhur me këtë pasuri. Në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur në vendim, pakica ka vlerësuar se ankimi i Komisionerit Publik lidhur me nevojën për verifikimin e burimeve të krijimit të pasurisë apartament në Vlorë, të cilat janë deklaruar prej subjektit të rivlerësimit se përbëhen prej

kursimeve të tij dhe personit të lidhur në vite, përfshin edhe kontrollin e verifikimin e kursimeve të personit të lidhur.

6.2. *Së dyti*, lidhur me këtë shkak, duam të sjellim në vëmendje paragrafët e ankimit të paraqitur prej Komisionerit Publik, në të cilët referohet nevoja e këtij kontrolli si pjesë e kontrollit të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së deklaruar. Në ankim, në paragrafin 7.1, Komisioneri Publik, duke renditur çështjet për të cilat komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë ka rekomanduar ankimin e vendimit, ndër të tjera, ka cituar: *kontrollin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë, apartament me sip. 128 m², në Vlorë.*

6.3. Mbështetur mbi rekomandim e vëzhguesve ndërkombëtarë, Komisioneri ka marrë në analizë dhe ka ngritur në nivelin e një shkakut ankimi pretendimet për këtë pasuri, të renditura në paragrafët 31 e vijues të ankimit. Në nënparagrafët e këtij paragrafi, Komisioneri Publik ka renditur arsyetimin e Komisionit mbi vlerësimin ligjor të kursimeve të personit të lidhur, znj. E. Ll., në masën prej 5.000.000 lekësh, të deklaruar prej saj në deklaratën fillestare të pasurisë dhe në atë *vetting* e të deklaruar se janë përdorur si burim për financimin e apartamentit në Vlorë. Në këtë pjesë të ankimit, Komisioneri Publik nënvizon qëndrimin e Komisionit se për këtë shumë duhet konsideruar vendimi i një trupe tjetër gjyquese, siç pretendon edhe subjekti i rivlerësimit, e cila ka kryer rivlerësimin e personit të lidhur, subjekt rivlerësimi gjithashtu.

6.4. Në konkluzion të fakteve të renditura në nënparagrafët e paragrafit 31 në ankim, Komisioneri Publik, në paragrafin 32 të ankimit, shprehet se: *mbështetur në rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, si edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se kursimet cash të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, janë elemente që do të duhet të analizohen në kuadër të ligjshmërisë së të ardhurave të përdorura si burim për krijimin e kësaj pasurie.*

6.5. Në nënparagrafët vijues të paragrafit 32, Komisioneri Publik rendit kontestimet për momente të veçanta të analizës që ka bërë Komisioni për kursimet e subjektit dhe personat e lidhur, pa identifikuar posaçërisht analizën për kursimet në vlerën prej 5.000.000 lekësh, për të cilën Komisioni nuk ka bërë një analizë, duke qenë se i është referuar qëndrimit që ka mbajtur trupa tjetër gjyquese që ka vlerësuar personin e lidhur si subjekt rivlerësimi, duke ia njohur këtë shumë si me burime të ligjshme.

6.6. Në paragrafin 32.4 të ankimit, Komisioneri Publik sërish shprehet se: *Për sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, çmohet i nevojshëm rivlerësimi i zërave përbërës të analizës financiare dhe mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes së tij, për të mbuluar me burime të ligjshme, kursimet e deklaruar ndër vite, të përdorura për blerjen e kësaj pasurie.*

6.7. Përveç sa më lart, pas paraqitjes së analizës paraprake financiare të përgatitur prej Kolegjit dhe të mbështetur mbi shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, të prezantuar me dy versione, për shkak të qëndrimit të paunifikuar të trupit gjyqësor për shkaqet e ankimit dhe kontestimit të subjektit të rivlerësimit në drejtim të versionit në të cilin analiza e kursimeve, në shumën prej 5.000.000 lekësh, konsiderohej si pjesë e ankimit, Komisioneri Publik, në seancën e datës 05.04.2022, shprehu qartë se kjo shumë ishte një nga burimet që duhej t'i nënshtrohej

juridiksionit kontrollues të Kolegjit dhe se ky ka qenë qëllimi i Komisionerit Publik që në ankimin e tij dhe si i tillë duhej kuptuar.

6.8. Të njëjtin qëndrim të qartë, Komisioneri Publik mbajti në konkluzionet përfundimtare të çështjes, në të cilat u shpreh [në paragrafin 2.3.4] rreth pamundësisë së personit të lidhur për të krijuar shumën prej 5.000.000 lekësh në vitin 2004 me burime të ligjshme, konkluzion i cili afekton kontrollin e pasurisë, apartament, në Vlorë.

6.9. Në analizë të këtyre deklarimeve, por jo vetëm, pakica ka vlerësuar se kontrolli i kësaj shume duhet të jetë pjesë e analizës së burimeve të ligjshme të përdorura për blerjen e apartamentit në Vlorë, ndërsa shumica e ka përjashtuar këtë shumë nga kontrolli, duke konkluduar në kufizimin e ankimit vetëm mbi kontrollin e kursimeve të tjera të ish-bashkëshortëve, të cilat kanë shërbyer për financimin e pasurisë në Vlorë dhe duke marrë si të mirëqenë faktin se kjo shumë është krijuar me burime të ligjshme, siç ka pranuar Komisioni

6.10. Në këtë konkluzion, kemi arritur jo vetëm duke kryer një lexim literal të kërkimeve të Komisionerit Publik, të paraqitura në ankim dhe përgjatë gjykimit, por edhe nga një lexim i arsyeshëm e në funksion të arritjes së qëllimit për të cilin është paraqitur ankim, kontrolli i burimeve të blerjes së pasurisë në Vlorë. Faktet mbi të cilat kemi konkluduar si më lart, po i rendisim në vijim.

- a) Burimi i deklaruar i blerjes së kësaj pasurie, janë kursimet në vite të ish-bashkëshortëve, sipas deklarimit të tyre në deklaraten *vetting*, duke përfshirë në këto kursime edhe vlerën prej 5.000.000 lekësh, të deklaruar si gjendje *cash* prej personit të lidhur në deklaraten *vetting* dhe deklaraten fillestare të pasurisë.
- b) Vlera e apartamentit të blerë në Vlorë, është 55.452 euro, për pasojë shuma prej 5.000.000 lekësh përbën pjesën më të rëndësishme të burimit të financimit të kësaj pasurie, element që do të bënte pa sens të kontrollohej pjesa tjetër e burimeve që zënë një peshë shumë më të parëndësishme, në kuptim të kërkimit të Komisionerit Publik të cituar më lart, në ankim.
- c) Vetë Komisioni nuk ka kryer një verifikim të ligjshmërisë së krijimit të kësaj shume, duke qenë se e ka lidhur atë me qëndrimin që ka mbajtur trupa gjyquese e Komisionit që ka kryer rivlerësimin e personit të lidhur, për pasojë Komisioneri Publik nuk mund të bënte një analizë të detajuar rreth kësaj shume, në mungesë të analizës së Komisionit, përveçse të kërkonte prej Kolegjit që të gjithë zërat e analizës që janë përdorur si burime për financimin e apartamentit, të rivlerësoheshin prej Kolegjit.
- ç) Institucioni i Komisionerëve Publikë ka kontestuar qëndrimin e mbajtur prej Komisionit në procesin e rivlerësimit të personit të lidhur për ligjshmërinë e kësaj shume në ankimin e paraqitur në Kolegj kundër atij vendimi, duke kërkuar prej Kolegjit rikontrollin e saj.
- d) Për shkak të vendimit të ndërmjetëm të trupit gjyqes për administrimin e akteve të çështjeve reciproke të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, të gjitha aktet e procesit të rivlerësimit të personit të lidhur, përfshi vendimin përfundimtar të marrë nga Kolegji për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. E. Ll.⁶¹, janë bërë pjesë e akteve që duhej t'i nënshtroheshin vlerësimit të trupës gjyquese të kësaj çështjeje. Në

⁶¹ Vendimi nr. 26, datë 06.07.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

këtë kontekst, edhe qëndrimi i mbajtur në atë çështje për këtë shumë, duhej mbajtur në vëmendje dhe t'i nënshtrohej procesit të çmuarjes së provave në funksion të zgjidhjes së çështjes, në konsideratë të nenit 309, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Civile.

- dh) Për shkak të koneksitetit të çështjeve, faktit se kemi të bëjmë me një pasuri të përbashkët, të krijuar me kursime të përbashkëta, nën regjimin e bashkësisë ligjore, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, është e detyrueshme, në vlerësimin tonë, që pjesë e kontrollit të kësaj pasurie të jenë të gjitha burimet e përdorura për krijimin e saj, për sa kohë që Komisioneri ngre si shkak kontrollin e tyre. Kontrolli i veçuar dhe nën një ndarje mekanike mes kursimeve të subjektit dhe atyre të personit të lidhur, nuk do të realizonte qëllimin e shpallur prej Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, se subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur gëzojnë të njëjtat pozita dhe status procedural, në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë.
- e) Qëndrimi i mbajtur nga shumica se kërkimet e Komisionerit Publik kanë rënë në dekadencë, sipas parashikimit të nenit 459 të Kodit të Procedurës Civile, gjenden pa efekt në këtë rast, duke qenë se, sipas vlerësimit tonë, kërkimet janë paraqitur në ankim dhe ato vetëm janë risjellë posaçërisht në vëmendje e janë konfirmuar përgjatë gjykimit, për shkak të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit.

6.11. Përfundimisht, pakica ka vlerësuar se kjo shumë duhet t'i nënshtrohet kontrollit rivlerësues të Kolegjit, si një prej burimeve kryesore të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi.

6.12. Në vijim të këtij qëndrimi, në kushtet e të qenit një mendim në pakicë, po rendisim në mënyrë të përmbledhur, analizën ligjore e financiare, në përfundim të së cilës, ne kemi konkluduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar pasurinë apartament, në Vlorë, në vlerën (-) 6.572.225 lekë. Kjo vlerë është e ndryshme nga ajo e konkluduar prej shumicës, kryesisht për shkak të përfshirjes në analizë të shumës prej 5.000.000 lekësh, por edhe për shkak të disa analizave të ndryshme nga shumica, ligjore e financiare, për sa u përket kursimeve në *cash* të subjektit dhe të personit të lidhur për vitet 2003-2016, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore, si edhe të analizës për statusin e shumës prej 1,2 milionë lekësh, të përfutur prej subjektit të rivlerësimit në vitin 2011, nga shitja e një automjeti.

6.13. Lidhur me shumën prej 5.000.000 lekësh, të deklaruar si gjendje *cash* prej personit të lidhur në vitin 2004, nga analiza e akteve në dosjen e shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit përgjatë gjykimit në Kolegj, por edhe nga aktet e dosjes që i përket procesit të rivlerësimit të personit të lidhur, të cilat u administruan me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues, kanë rezultuar faktet si më poshtë⁶².

6.14. Personi i lidhur ka deklaruar në deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë, në vitin 2004, si gjendje *cash* të kursyer, vlerën prej 5.000.000 lekësh, si: *të holla cash të ruajtura në shtëpi, me burim, kursim nga të ardhurat e mia e familjes, dhuratë nga motra*. Krahas deklarimit të shumës prej 5.000.000 lekësh si gjendje në *cash*, në deklaratën fillestare në vitin 2004, personi i lidhur e ka përshkruar këtë shumë te rubrika e të ardhurave edhe në deklaratën

⁶² Fakte të cilat janë arsyetuar dhe janë bazë e vendimit nr. 26/2022 (JR), datë 06.07.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. E. Ll. (personi i lidhur i subjektit Gerd Hoxha).

vetting, nën përgjegjësinë që përcakton neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016, për të deklaruar me vërtetësi e plotësi të gjitha të ardhurat e krijuara, burimet e tyre dhe pasuritë e krijuara me to, me qëllim paraqitjen në optikën dhe përcaktimet e legjislacionit të ri kushtetues të të gjithë informacionit të duhur e të nevojshëm për të bërë të mundur që organet e rivlerësimit të kryenin një proces kontrolli objektiv dhe të vërtetë të pasurive në pronësi të subjekteve të rivlerësimit. Shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikonte në këtë kontekst, edhe sanksion për mosplotësimin me saktësi e vërtetësi të kësaj deklaratë⁶³.

6.15. Në këtë kuadër ligjor në fuqi, personi i lidhur ka deklaruar në mënyrë të detajuar në deklaratën *vetting*, burimet e krijimit të kësaj shume, duke përcaktuar si të tilla edhe të ardhurat: *Nga punësimi te biznesi i ndërtimit të motrës A. Ll. Ç. që nga viti IV i shkollës së mesme deri në vitin II të Shkollës së Magjistraturës (nuk kam pasur kontratë pune për shkak se isha e punësuar në një biznes familjar), me pagë mujore 30.000 - 40.000 lekë në muaj, plus të dhuruara nga motra ime, znj. A. Ll., për shkak të mbarimit shkëlqyer të Shkollës së Magjistraturës. Gjatë gjithë kësaj kohe, shpenzimet e mia përballoheshin nga të ardhurat nga bursa e shkollës si studente e shkëlqyer nga Fakulteti i Drejtësisë, prindërit me të cilët banonte dhe motra, znj. A. Ll.*

6.16. Lidhur me shumën 2.000.000 lekë, deklaruar si dhuratë nga motra e personit të lidhur, subjekti ka kërkuar që ajo të përfshihet si e ardhur në analizën financiare, duke pretenduar se për këtë vlerë, provohet ligjshmëria e krijimit të saj dhe mosdeklarimi i vlerës së dhurimit në deklaratën *vetting*, ka qenë një lapsus/harresë.

6.17. Pakica ka konsideruar në vlerësimin e kësaj të ardhure, deklaratimet e subjektit dhe personit të lidhur në deklaratën *vetting*, si dhe shpjegimet e dhëna nga personi i lidhur gjatë hetimit administrativ në Komision, nga të cilat ka rezultuar se: **(i)** Në deklaratën fillestare të deklaramit të pasurisë në vitin 2004, personi i lidhur ka deklaruar dhurim nga motra, por shifra e dhurimit prej 2.000.000 lekësh nuk specifikohet. **(ii)** Edhe në deklaratën *vetting*, tek e cila sërish deklarohet dhurim i motrës në vitin 2004, nuk specifikohet shuma e dhuruar. **(iii)** Në dokumentin e administruar nga Komisioni, të marrë prej ILDKPKI-së, rezulton se në aktin e llojit procesverbal, të mbajtur nga ky organ, të emërtuar “Sqarime mbi deklaramin e pasurisë nga G. Hoxha dhe E. Ll.”, të datës 20.01.2015, personi i lidhur ka deklaruar se ka përfituar dhurim nga motra për shkak të mbarimit shkëlqyer të Shkollës së Magjistraturës, por edhe në këtë rast, nuk ka evidentuar vlerën e shumës së dhuruar. **(iv)** Vërehet se vetëm gjatë hetimit administrativ, me shpjegimet e pyetësorit nr. {***}, personi i lidhur ka saktësuar se vlera e dhuruar prej motrës është në shumën 2.000.000 lekë dhe se ky dhurim është bërë pa dokument noterial. **(v)** Nga të dhënat e fashikullit të hetimit administrativ të personit të lidhur, rezulton se, për të provuar përfitimin e shumës 2.000.000 lekë në vitin 2004, është paraqitur si provë deklarata noteriale e motrës së saj A. Ç. (Ll.) dhe e bashkëshortit të saj A. Ç., me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.6.2018, në të cilën ata kanë deklaruar, ndër të tjera se: [...] për shkak të mbarimit me rezultate të shkëlqyera të Shkollës së Magjistraturës, si dhe për të ndihmuar daljen e saj në jetë, ne, z. A. Ç. dhe znj. A. Ll. (Ç.), i kemi dhuruar një sasi të

⁶³ Mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

ardhurash, në shumën 2.000.000 lekë, pa kontratë, për shkak të marrëdhënies së posaçme që kemi mes nesh.

6.18. Nga analizimi i të dhënave të mësipërme, konstatohet se, në përgjigje të këtyre pyetjeve të drejtuara nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit standard, dhe konkretisht asaj që lidhet me dhurimet e përfituara prej të tretëve, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, ndonëse kanë dhënë përgjigje për shuma të dhuruara familjes me rastin e lindjes së fëmijëve, në vlera shumë më modeste se ajo e pretenduar si e dhuruar nga motra e personit të lidhur, znj. E. Ll., meqenëse përfundoi studimet si studente e shkëlqyer, nuk kanë deklaruar në të, vlerën e shumës së dhënë dhuratë e të përmendur në deklaratën *vetting*. Në këtë mënyrë, personi i lidhur, edhe pse në shkelje të detyrimit ligjor për të deklaruar këtë shumë që në deklaratën *vetting*, aq më tepër që ajo kishte shërbyer si një burim i rëndësishëm për krijimin e pasurisë në vitin 2016, nuk e ka deklaruar atë as në përgjigjet e para të dërguara prej Komisionit. Duke vepruar në këtë mënyrë, nuk ka përmbushur detyrimin për të deklaruar në mënyrë të plotë dhe të qartë, detyrim që procesi hetimor ia ka dhënë asaj për të shpjeguar në mënyrë shteruese çdo të dhënë me vlerë për procesin e rivlerësimit. Personi i lidhur ka munguar në këtë mënyrë sërish, të përcaktojë vlerën e kësaj të ardhure, ndonëse ka pasur një kuptim të qartë për pyetjet që i janë shtruar, duke konsideruar përgjigjet e detajuara për dhurata e tjera.

6.19. Në këtë kuptim, pretendimi i personit të lidhur, i mbështetur edhe nga subjekti i rivlerësimit, se vlera e kësaj të ardhure të dhuruar nga motra për shkak të përfundimit të studimeve me rezultate të shkëlqyera, është 2.000.000 lekë, e bërë prezente prej saj vetëm në pyetësorin nr. {***} e në vazhdim të procesit, mbetet një e dhënë e cila nuk mund të verifikohet e që nuk krijon besueshmëri për ekzistencën e saj. Në këtë arsyetim, mbahet në konsideratë fakti se subjekti përfitonte në kohën e dhurimit të kësaj shume prej Shkollës së Magjistraturës, të ardhura në vlerën prej përafërsisht 29.326 lekësh në muaj, vlerë shumë modeste në raport me shumën prej 2.000.000 lekësh, të dhënë dhuratë nga motra. Kjo rrethanë logjikshëm do të kërkonte vëmendje të shtuar e qartësi për vlerën e pasurisë së dhuruar, e cila ishte e vështirë të krijohej prej personit të lidhur me të ardhurat personale të kohës, për pasojë pretendimi i subjektit se mospërcaktimi i saj është thjesht një “lapsus”, është i pabesueshëm në vlerësimin e pakicës.

6.20. Për shkak të kësaj situatë dhe të detyrimit që kishte personi i lidhur të përcaktonte qartësisht të ardhurat që kishin shërbyer si burim për krijimin e pasurive, pakica vlerëson se personi i lidhur kishte detyrimin ligjor të deklaronte vlerën e saj të paktën në deklaratën *vetting*, për sa kohë që ajo nuk gjendet e caktuar/deklaruar as në deklaratën fillestare të pasurisë. Përcaktimi i saj në një kohë të avancuar të procesit të rivlerësimit, kur kishin filluar të identifikoheshin problematikat me natyrë financiare për pasurinë e subjektit të rivlerësimit apo të personit të lidhur, çmohet se është kryer jo vetëm për nevoja të evidentimit të sforcuar të vlerës së vërtetë të dhuruar, por kryesisht për nevoja të ndreqjes e azhurnimit të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur. Në këtë arsyetim, mbahet në vëmendje edhe fakti se të vetmet burime që mund të japin informacion për gjendjen e likuiditeteve *cash*, janë deklarimet e subjekteve të rivlerësimit në deklaratat periodike të pasurive, aq më tepër kur burimet e krijimit të tyre mbështeten vetëm në deklarime dhe në asnjë akt shkresor që të provojë plotësisht, ekzistencën e tyre apo burimin e krijimit të tyre. Në këtë

kontekst, deklaratimet duhet të jenë bindëse, të qarta, koherente e në harmoni me të dhënat e tjera, në mënyrë që të arrijnë nivelin e duhur të provueshmërisë së kësaj lloji pasurie.

6.21. Në këtë kuptim, mosdeklarimi i vlerës së dhurimit në kohën e përcaktuar prej ligjit në deklaratën periodike vjetore dhe as në deklaratën *vetting*, madje as në pyetësonin e parë, e bën të pabesueshëm deklarin e subjektit për dhurimin nga motra e personit të lidhur, të shumës prej 2.000.000 lekësh. Deklarimi i vlerës së dhurimit, për më tepër, do të ishte i nevojshëm në rastin konkret, kur provohet se të gjitha pasuritë e subjektit të rivlerësimit kanë në një mënyrë ose një tjetër lidhje me dhurata apo trajtimet preferenciale të kryera prej motrës së personit të lidhur.

6.22. Kjo paqartësi dhe paplotësi e përsëritur në deklaratime dhe e pashoqëruar me akte shkresore provuese të kohës, por vetëm me deklaratimet noteriale të bashkëshortit dhe motrës së personit të lidhur gjatë procesit të rivlerësimit, për vlerën e të cilave Kolegji tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar⁶⁴, i vënë organet e rivlerësimit në vështirësi për të verifikuar vërtetësinë e tyre. Pretendimet e përsëritura të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit në Komision dhe në Kolegj, se e motra e personit të lidhur gëzonte një situatë financiare shumë të mirë dhe kishte mundësi financimin jo vetëm të kësaj shume apo të privilegjeve të tjera, por edhe të vlerave shumë më të mëdha, nuk janë përgjigje ligjore dhe të bazuara në fakte në drejtim të qëllimit për të cilin është ngritur ky proces dhe adresimit që ai bën për kontrollin e pasurive të subjekteve të rivlerësimit. Pavarësisht situatës financiare të motrës së personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, e cila, nën statusin e personit tjetër të lidhur, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka justifikuar shumat e pretenduara si të dhuruara, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mund të zhvishen nga detyrimi kushtetues për provueshmërinë e përfitimit e kësaj shume në kohën dhe masën e deklaruar.

6.23. Për këtë çështje, pakica ka arritur në përfundimin se mbeti i paprovuar përfitimi nga personi i lidhur, i shumës prej 2.000.000 lekësh dhe, për pasojë, kjo vlerë nuk duhej konsideruar si e ardhur në kontrollin e krijimit të shumës prej 5.000.000 lekësh, që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Vlorë.

7. Lidhur me verifikimin dhe provueshmërinë e krijimit të shumës së përfituar nga personi i lidhur prej punësimit të deklaruar te biznesi i motrës, sipas deklaratës *vetting*, në vlerën 35.000 lekë – 40.000 lekë/muaj për periudhën 1997-2004, nga aktet e administruara gjatë procesit, rezultuan faktet e mëposhtme.

- a) Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar se për vitet 1997-2004, ka përfituar të ardhura nga punësimi në biznesin e ndërtimit të motrës A. Ç. (pa pasur kontratë pune, për shkak se ishte e punësuar në biznes familjar), me pagë mujore 30.000 – 40.000 lekë në muaj.

⁶⁴ Shih vendimet e Kolegjit: nr. 6/2018(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Besa Nikëhasani; nr. 7/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Elision Sadiku; nr. 34/2019(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti; nr. 2/2020(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani; nr. 23/2020(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prella; nr. 24/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Ferdinand Elezi; nr. 29/2020(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Edison Ademi; nr. 33/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Seci; nr. 11/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Përparim Kulluri; nr. 12/2021(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Madani; nr. 11/2022(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj.

- b) Në DPV-në fillestare të vitit 2004, personi i lidhur nuk ka specifikuar se ka përfituar të ardhura nga punësimi në aktivitetin privat të motrës së saj.
- c) Më datë 20.01.2015, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur janë thirrur në ILDKPKI për të dhënë shpjegime lidhur me ndryshimin e pasurisë. Nga procesverbali i mbajtur për të shpjeguar burimet e krijimit të shumës 5.000.000 lekë, si kursime në *cash* në DPV-në fillestare të vitit 2004, personi i lidhur, si një prej burimeve të krijimit të kësaj shume, ka deklaruar: *të ardhurat e përfituara nga punësimi në biznesin e ndërtimit të motrës A. Ç., nga viti IV i shkollës së mesme e deri në vitin II të Shkollës së Magjistraturës (pa pasur kontratë pune, për shkak se ishte e punësuar në biznes familjar), me pagë mujore 30.000 – 40.000 lekë në muaj.*
- ç) Gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, personi i lidhur ka paraqitur si provë për të faktuar të ardhurën e marrë nga angazhimi te biznesi privat i motrës së saj, dy deklarata noteriale, të lëshuara gjatë kohës së nisjes së procesit të rivlerësimit, nga motra dhe bashkëshorti, me anë të të cilave ata deklarojnë:
 - i. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.6.2018, deklaruesit A. dhe A. Ç. janë shprehur se E. Ll., që prej vitit IV të shkollës së mesme deri në vitin II të shkollës së Magjistraturës, **ka qenë e punësuar pranë biznesit tonë të ndërtimit dhe qiradhënies, me pagë mujore 35.000 lekë.**
 - ii. Ndërsa në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2020, po të njëjtit deklarues, znj. A. dhe z. A. Ç., kanë deklaruar se znj. E. Ll., gjatë periudhës 1997-2004, i është dhënë **një shpërblim simbolik mujor**, në masën 35.000 lekë, për ndihmën e ofruar për mbajtjen e fëmijëve të vegjël, në kushtet kur ata kanë qenë të angazhuar në punët e biznesit.
- d) Personi i lidhur, gjatë hetimit administrativ, në shpjegimet e dhëna për rezultatet paraprake të hetimit për periudhën 1997-2004, ka pretenduar se: *[...] ka pasur ndihmë dhe kontribut nga motra A. Ç., me pagesa të përmuajshme prej 35.000 lekësh. Kjo ndihmë nuk ishte në formën e pagës mujore, sepse unë nuk punoja e nuk mund të isha e punësuar në atë periudhë, por për të mos u ndjerë unë keq e për të më shpërblyer në njëfarë mënyre lidhur me ndihmën që unë i jepja motrës sime në mbajtjen e fëmijëve (5 dhe 7 vjeç në atë kohë), në mbledhjen e qirave të pasurive të paluajtshme të tyre dhe për çdo nevojë e mundësi që unë kisha për t'i ndihmuar.*

7.1. Subjekti i rivlerësimit, gjatë prapësime në Kolegj, deklaroi në të njëjtat linja me ato të deklaruara prej personit të lidhur përgjatë procesit administrativ, por edhe gjyqësor, rreth natyrës së marrëdhënieve mes motrave dhe mundësive shumë të mira financiare të motrës së personit të lidhur për dhënien e kësaj ndihme.

7.2. Nga analiza e deklarimeve, konstatohet se në deklaratën *vetting* të personit të lidhur, nën përgjegjësitë që prodhon ky deklaram, kjo marrëdhënie përshkruhet si një marrëdhënie punësimi, e cila ka shërbyer për krijimin e një të ardhure në vlerën prej 3.360.000 lekësh⁶⁵. Subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur nuk kanë sjellë asnjë dokument në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës së kësaj marrëdhënieje apo edhe të ardhurave të krijuara prej saj, qoftë edhe në nivelin e indicieve, siç mund të ishin akte të prodhuara prej personit të lidhur, znj. E. Ll., apo dokumente në të cilat kishte ndonjë gjurmë se ajo kishte kryer realisht një detyrë në një pozicion konkret pranë biznesit të motrës për gjithë vitet e deklaruara prej saj si e punësuar në deklaratën *vetting*.

⁶⁵ Të ardhura të deklaruara nga subjekti në deklaratën “vetting”, për periudhën 1997-2004, nga punësimi te biznesi i ndërtimit të motrës A. Ç., me pagë mujore 35.000 lekë në muaj, në total për 23 muaj, arrin vlerën 3.360.000 lekë.

7.3. Pretendimet e ndryshme dhe kontradiktore të paraqitura prej personit të lidhur dhe subjektit të rivlerësimit, gjatë një faze të avancuar të hetimit administrativ, që përkon edhe me kohën pas mbajtjes së qëndrimeve të Kolegjit për provueshmërinë e marrëdhënieve të punësimit, dhe që përshkruajnë në një mënyrë tjetër llojin e marrëdhënies që ka prodhuar si të ardhur shumë prej 3.360.000 lekësh, mbeten gjithashtu në nivel deklarativ dhe të pambështetura në asnjë provë, përveçse në deklarinimin e bashkëshortëve Ç.. Këto deklarime kanë mangësi të theksuara në vlerën e tyre provuese si të gjitha deklaratat noteriale të krijuara gjatë procesit të rivlerësimit e të pambështetura nga të dhëna që vijnë nga burime të tjera, si dhe kanë edhe defektin e rëndësishëm në drejtim të besueshmërisë së tyre, për sa kohë ato vijnë në kundërshtim, së paku me deklarinimet që vetë këta individë kanë dhënë brenda të njëjtit proces, për të njëjtën marrëdhënie. Deklarinimet se këto shuma ishin simbolike për personin e lidhur e, për pasojë, nuk dukej se meritonin një interes të dedikuar drejt dokumentimit të tyre për efekt provueshmërie, konsiderohen prej pakicës si të paarsyeshme, për sa kohë këto shuma të përfituara sipas deklarinimit të personit të lidhur, tejkalonin ndjeshëm edhe pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në kohën e përfitimit të tyre dhe, për më tepër, kanë shërbyer për krijimin e një shume prej 5.000.000 lekësh gjendje *cash* në banesë, e cila nuk mund të nënvleftësohej për kohën e krijimit, madje edhe sot, kur pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë rritur në mënyrë të ndjeshme.

7.4. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pretenduar se në krijimin e kësaj shume, kanë shërbyer edhe të ardhurat e prindërve të personit të lidhur, dhurimet që motra u ka bërë prindërve periodikisht ndër vite, të cilat duhet të llogariteshin në zërin e analizës “të ardhura”, llogaritje e cila do të ndryshonte balancën e analizës financiare që kontrollonte krijimin e kësaj pasurie, duke prezantuar për vlerësim dy versione të analizës financiare që Kolegji do të duhej të konsideronte. Konstatohet se ky pretendim nuk gjen pasqyrim në deklaratën *vetting*, në të cilën personi i lidhur ka përshkruar në mënyrë të detajuar se nga cilët komponentë përbëhej shuma prej 5.000.000 lekësh.

7.5. Pakica çmon të nënvizojë qëndrimin se objekt i punës së organeve të rivlerësimit, është kontrolli i vërtetësisë së deklarinimeve të subjekteve të rivlerësimit të kryera në deklaratën *vetting* dhe verifikimi i burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurive. Procesi hetimor administrativ apo ai gjyqësor i zhvilluar prej organeve të rivlerësimit, nuk mund të jetë një proces që fton/lejon subjektet të bëjnë deklarime të reja, më të volitshme për vlerësimin e pasurisë së tyre. Ata janë të ftuar të japin shpjegime e të paraqesin prova që mbështesin deklarinimet e tyre dhe jo të modifikojnë deklarinimet në përputhje me problematikat e prezantuara. Verifikimi i deklarinimeve është një proces *post factum* dhe, si i tillë, nuk mund të ndërtohet mbi deklarime të bëra rishtas, aq më tepër kur ato kundërshtojnë deklarinimet e bëra nën përgjegjësi të deklarata *vetting*. Për më tepër, fakti që personi i lidhur, znj. E. Ll., ka prezantuar në mbrojtjen në seancë gjyqësore në procesin e rivlerësimit të zhvilluar për të në Kolegj, dy versione që lidhen me situatën financiare të familjes së saj, të ndryshme në zërat që përcaktojnë të ardhurat e shpenzimet, vlerësohet si një element që potencon mungesën e besueshmërisë të deklarinimet e subjektit të rivlerësimit dhe të saj, për sa kohë që ajo vetë nuk ka një të vërtetë të vetme jetësore për të mbrojtur, por e prezanton atë në versione alternative, në përputhje dhe në funksion të një rezultati pozitiv për të.

7.6. Në konkluzion, për të ardhurat e deklaruar prej personit të lidhur në deklaratën *vetting*, si të përfituara në vitet 1997-2004 nga punësimi te biznesi i motrës, pakica, pasi analizoi burimet e krijimit të tyre sipas deklarimeve në deklaratën e pasurisë *vetting*, përveçse i gjeti ato kontradiktore me deklaratimet e mëposhtme të dhëna rreth këtyre burimeve gjatë procesit administrativ në Komision dhe shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, arriti në përfundimin se mbetën në nivel deklarativ e të paprovuara, si marrëdhënia e deklaruar e punësimit te biznesi i motrës së saj, ashtu edhe të ardhurat e krijuara nga kjo marrëdhënie në vitet 1997 - 2004, në vlerën prej 3.360.000 lekësh. Personi i lidhur nuk pretendoi pagimin e detyrimeve tatimore për këto të ardhura gjatë procesit të rivlerësimit, për shkak të ndryshimit të kualifikimit të marrëdhënies nga “një marrëdhënie punësimi” në përcaktimin e saj si një “marrëdhënie ndihme familjare”. Për pasojë, mosprovueshmëria e marrëdhënies së punësimit dhe e të ardhurave të fituara prej saj, e shoqëruar edhe me mungesën e provueshmërisë të pagesës së detyrimeve tatimore për këto të ardhura, duke qenë se ato nuk u mbështetën me dokumentacion provues apo të dhëna nga burime të njohura sipas parashikimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, u vlerësua nga pakica si një situatë që dëshmon për mosplotësimin e kritereve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

7.7. Për sa më sipër, pakica ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dështoi të provonte përfitimin e këtyre shumave nga personi i lidhur dhe, si rrjedhojë, totali i vlerës së llogaritur si e paprovuar, prej 3.360.000 lekësh, nuk duhej të përfshihej në analizën financiare të kryer për të verifikuar burimet e ligjshme të krijimit të shumës prej 5.000.000 lekësh në vitin 2004.

7.8. Në përfundim të kësaj analize që lidhet me verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të shumës prej 5.000.000 lekësh, kemi konkluduar se personi i lidhur ka rezultuar të jetë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, në vlerën prej (-) 3.734.553 lekësh.

8. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e kursimeve në *cash* të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në deklaratat periodike të pasurisë për vitet 2006-2010, për t'i dhënë përgjigje pretendimit të Komisionerit Publik mbi llogaritjen e saktë të tyre, pakica mori në shqyrtim dhe analizoi këto deklarime në raport e harmoni me verifikimin e dokumenteve të administruara që provojnë të ardhurat e krijuara prej subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, përgjigjet e dhëna prej tyre gjatë procesit hetimor në Komision e gjyqësor në Kolegj, dhe bëri konstatimet e mëposhtme.

8.1. Në DPV-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Cash*” në shtëpi 1.500.000 lekë, me burim nga paga si student në Shkollën e Magjistraturës dhe nga puna në sektorin privat që nga vitit 1995 e në vazhdim deri sot. Nga analiza e deklaratës periodike të këtij viti, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin, tip “Mercedes Benz”, për një vlerë prej 1.147.766 lekësh. Kjo vlerë përkon me pakësimin me 1.000.000 lekë të gjendjes së *cash*-it të deklaruar në vitin 2003, prej 2.500.000 lekësh, duke u konsideruar prej tij se ka mbetur tashmë në banesë gjendja *cash*, prej 1.500.000 lekësh, e krijuar sipas deklaratimit me të njëjtat burime si ato të përdorura në vitin 2003. Ndërsa subjekti pretendon se kjo shumë ka mbetur e gjitha në zotërimin e tij në fund të vitit 2004, pra në total 1.500.000 lekë, në konsideratë të konkluzionit të arritur edhe nga shumica e trupit gjykues me të cilin jemi dakordësuar, në përcaktimin e vlerës së *cash*-it për vitin 2003, vetëm në shumën 1.218.204

lekë, shuma e mbetur në disponim të subjektit në fund të këtij viti, do të ishte (1.218.204 lekë, cash në dispozicion në vitin 2003 – 1.000.000 lekë, vlera e automjetit të blerë në vitin 2004) në vlerën 218.204 lekë.

8.2. Në DPV-në e vitit 2005, në seksionin “Ndryshimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme”, subjekti ka deklaruar gjendje cash 350.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pretenduar se termi “gjendje” në këtë vit, duhet të kuptojë shtesën e cash-it në vlerën e deklaruar, për sa kohë që është pasqyruar te rubrika e ndryshimeve të pasurisë. Në këto kushte, u vlerësua të konsiderojmë këtë deklaram sipas shpjegimeve që japin subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur dhe ta konsiderojmë vlerën prej 350.000 lekësh, si kursim të vitit 2005, i cili do t’i shtohet vlerës prej 218.204 lekësh të mbetur sipas përlogaritjeve më sipër, nga kursimet e vitit 2004.

8.3. Në DPV-në e vitit 2006, në seksionin “Ndryshimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtar 350.000 lekë dhe të ardhura si pedagog në Universitetin jopublik {***} 250.000 lekë.* Në seksionin “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari private dhe/ose publike”, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtar 350.000 lekë dhe të ardhura si pedagog në Universitetin jopublik {***}, 250.000 lekë.*

8.4. Në DPV-në e vitit 2007, në seksionin “Të ardhura nga paga”, është shpjeguar që: *Deklaroj se në deklaramin e mëparshëm, të bërë më datë 20.03.2007, për shkak të paqartësisë në përpilimin e deklaramit, kam deklaruar të ardhura të njëjta si në faqen nr. 3, ashtu dhe në faqen nr. 4 të deklaramit, te rubrika e plotësuar si të ardhura nga paga si gjyqtar në Gj. Rrethit Tiranë. Ky deklaram i kësaj shume përfaqëson shumën e kursyer nga unë për periudhën 01.01.2006 deri më 31.12.2006, dhe jo të ardhurat neto nga puna si gjyqtar në këtë periudhë. I njëjti lapsus ekziston edhe në deklaramin e të ardhurave si pedagog, të cilat nuk janë të ardhura të kursyera, por të ardhurat e përfituara për periudhën në fjalë edhe të kursyera.*

8.5. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, personi i lidhur ka deklaruar se: *Njëkohësisht, referuar deklaramit të pasurisë për vitin 2006, dorëzuar pranë ILDKPKI-së në dt. 20.03.2007 nga ish-bashkëshorti im, z. Gerd Hoxha, ka rezultuar se kursimet e këtij shtetasi nga paga e përfutuar prej tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vitin 2006, kanë qenë në shumën 350.000 lekë.*

8.6. Në kushtet e paqartësisë që sjellin deklaramet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për gjendjen e cash-it në vitin 2006, jo vetëm për faktin që konfundojnë termin të ardhura me kursime, por edhe për mungesën e koherencës dhe kundërshtitë mes qëndrimeve të dy ish-bashkëshortëve për gjendjen cash të kursyer, u analizuan deklaramet e tyre, në raport me të dhënat që u përfutuan nga dokumenti i lëshuar prej Universitetit jopublik {***} (pa numër protokolli), datë 26.10.2016.

8.7. Në vërtetimin e Universitetit jopublik {***}, të datës 26.10.2016, deklarohet se të ardhurat neto të përfituara prej subjektit të rivlerësimit nga angazhimi si pedagog te ky universitet, për periudhën janar 2004 – dhjetor 2008, janë në shumën 392.940 lekë. Me qëllim identifikimit të shumave që subjekti ka përfutuar nga mësimdhënia vit pas viti, u analizuan të

dhënat e këtij vërtetimi në raport me deklaratimet periodike që ai ka bërë për vitet 2004 - 2008, të cilat vijnë në një linjë me arsyetimin e bërë prej shumicës, duke konkluduar se në vitin 2004, subjekti ka përfituar 30.000 lekë, në vitin 2005 ka përfituar shumën prej 90.000 lekësh, në vitin 2006 ka përfituar shumën prej 118.114 lekësh, në vitin 2007 ka përfituar shumën prej 124.136 lekësh dhe në vitin 2008 shumën prej 30.690 lekësh.

8.8. Në kushtet e mësipërme, edhe pse në DPV-në e vitit 2006, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, janë deklaruar të ardhura nga paga si gjyqtar dhe nga puna si pedagog në Universitetin jopublik {***}, në shumën totale prej 600.000 lekësh dhe nuk është deklaruar specifikisht *kursime në cash*, sqarimet e dhëna në deklaratën vijuese të vitit 2007, referuar mënyrës së deklaratimit të DPV-së, u konsideruan si të mirëqena dhe të tilla që qartësojnë qëllimin dhe synimin e deklaratimit të subjektit, referuar situatës së kursimeve në vitin 2006. Gjithashtu, duke konsideruar që paga e përfituar si gjyqtar në vitin 2006, në totalin e saj ka qenë më e madhe se vlera 350.000 lekë, e deklaruar prej subjektit si pagë/kursim në DPV-në e vitit 2006, arrihet në konkluzionin se vlera e deklaruar prej tij si pagë në vitin 2006, ka qenë vlerë e destinuar për t’u deklaruar si kursim dhe në analizën financiare duhet të llogaritet si e tillë, së cilës do t’i shtohet edhe shuma prej 118.114 lekësh nga Universitetit jopublik {***}, duke u konsideruar për këtë vit, si kursim, shuma prej 468.114 lekësh.

8.9. Lidhur me kursimet e deklaruara në vitet 2007, 2008, 2009 dhe 2010, ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën e, për pasojë, nuk po elaborojmë më tej analizën.

8.10. Në konkluzion të qëndrimeve si më sipër, duke llogaritur të gjitha kursimet e subjektit të deklaruara si të tilla, deri në vitin 2010, rezulton se ai kishte mundësi të dispononte në fund të këtij viti si kursime totale, shumën prej 2.086.318 lekësh.

8.11. Duke qenë se në DPV-në e vitit 2011, subjekti, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, ka deklaruar blerjen e apartamentit dhe shlyerjen e këstit 1.500.000 lekë, të siguruar nga kursimet personale ndër vite, duke zbritur prej shumës 2.086.318 lekë, shumën prej 1.500.000 lekësh, rezultatja prej 586.318 lekësh përfaqëson vlerën e kursimeve të mbetura në dispozicion të subjektit, pas pagimit të këtij kësti

9. Lidhur me trajtimin e shumës prej 1.200.000 lekësh, të përfituar prej subjektit nga shitja e një automjeti në vitin 2011, kemi ndarë qëndrim të ndryshëm nga shumica, pasi e kemi gjetur të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik se kjo shumë nuk duhet konsideruar si kursim në *cash* për vitin 2011 e nuk duhet t’u shtohet kursimeve në vite të subjektit duke u mbështetur në arsyetimin e mëposhtëm.

9.1. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë, shitjen e automjetit në pronësi të tij dhe vlerën prej 1.200.000 lekësh të fituar prej këtij transaksioni. Në këtë deklaratë, kjo shumë nuk është përshkruar si kursim i subjektit në fund të vitit 2011, por vetëm si e ardhur e krijuar prej shitjes së pasurisë automjet, si një detyrim që vjen për shkak të ndryshimit të të drejtave të pronësisë mbi një pasuri të luajtshme në pronësi të tij përgjatë vitit deklarues.

9.2. Përveçse është deklaruar vetëm si një vlerë e përfituar nga shitja e kësaj pasurie, ajo nuk është kualifikuar si kursim i këtij viti, siç subjekti ka bërë në të gjitha vitet pararendëse, por edhe në vijim, dhe as rezulton të jetë identifikuar në ndonjë mënyrë në deklaratimet e mëposhme si burim për krijimin e ndonjë pasurie. Madje edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, kjo shumë është deklaruar vetëm si një nga të ardhurat e krijuara prej subjektit, por ajo nuk është saktësuar apo identifikuar se është përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie, qoftë ajo likuiditet, pasuri e paluajtshme apo e luajtshme. Në ndryshim nga kjo situatë, në deklaratën *vetting*, subjekti, kur ka deklaruar si të ardhur shumën e përfituar prej shitjes së një automjeti tjetër, e ka identifikuar atë si burim për financimin e automjetit “Mercedes Benz” të sipërpërmendur, duke e përcaktuar atë shumë posaçërisht si të tillë⁶⁶. Ky veprim mungon të jetë kryer për shumën prej 1.200.000 lekësh, e cila pretendohet të jetë përdorur për të krijuar kursime dhe më pas si burim për krijimin e pasurive të bashkëshortëve, element që përforcon bindjen se kjo shumë nuk ka shërbyer për krijimin e kursimeve në *cash* dhe as për financimin e ndonjë pasurie, por është shpenzuar përgjatë vitit financiar njësoj si të ardhurat e tjera të subjektit.

9.3. Përveç sa më lart, nga një lexim i ngjarjeve financiare të vitit 2011, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, të cilët deklarojnë se kanë nisur bashkëjetesën në këtë vit, kanë kryer transaksione të rëndësishme financiare dhe jo vetëm, të cilat deduktohet në konkluzion të analizës së fakteve në vijim, se janë të mbështetura financiarisht edhe nga përdorimi i kësaj shume. Kështu, në këtë vit, rezulton se: **(i)** subjekti ka kryer pagesën e kështit të apartamentit në Tiranë, në vlerën prej 1.500.000 lekësh, dhe deklaroi se bashkë me personin e lidhur, kanë filluar të bashkëjetojnë në apartament të ri; **(ii)** në muajin shkurt të këtij viti, rezulton se personi i lidhur, znj. E. Ll., ka shlyer kredinë në Bankën Emporiki, në vlerën prej 25.000 eurosh, me anë të huas/dhurimit të prindërve të saj, shumë për të cilën pakica, si më lart arsyetuar, ka ndarë qëndrimin se nuk justifikohet plotësisht burimi i ligjshëm; **(iii)** në korrik të këtij viti, është blerë prej babait të subjektit, automjeti tip “Audi Q7”, për një vlerë prej 4,9 milionë lekësh, e cila, siç ka pretenduar edhe vetë subjekti në proces, është blerë për shkak të një ekonomie të përbashkët të tij me familjen, përfshirë edhe të ardhurat e tij në vite, çështje e cila gjithashtu iu nënshtrua hetimit gjyqësor dhe për të cilën pakica ka qëndrimin në vijim⁶⁷; **(iv)** nga vlera prej 1.200.000 lekësh, e përfituar prej shitjes së automjetit, shuma prej 1.000.000 lekësh është marrë paraprakisht nga subjekti që në muajin mars, kur ka lidhur kontratën paraprake të shitjes, siç rezulton nga kjo kontratë, për pasojë ajo është disponuar lirisht pothuaj përgjatë gjithë këtij viti kalendarik e financiar për nevoja të familjes së subjektit të rivlerësimit.

9.4. Në këto kushte, duke analizuar rrethanat faktike që u renditën më lart, subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshëm arsye të rëndësishme për të shpenzuar shumën e përfituar

⁶⁶ Në deklaratën “*vetting*”, personi i lidhur, në seksionin “*Angazhime nga veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre*”, në rubrikën me numrin 12, ka deklaruar: “*Të ardhura neto të përfituara nga shitja e automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, në shumën 11.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., lidhur para noteres I. B.. Kjo shumë u përdor e gjitha për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz” nga z. A. H., për shumën 1.500.000 lekë, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.05.2007, redaktuar para noteres A. M.-H., Tiranë*”.

⁶⁷ Nga analiza e kryer në Kolegj, rezultoi se nga babai i ish-bashkëshortit të subjektit, në korrik 2011, është blerë automjeti, tip “*Audi Q7*”, por ai rezulton me situatë ekonomike financiare të mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen këtij automjeti, në vlerën (-) **4.995.395 lekë**.

prej shitjes së automjetit. Në këtë kuptim, mosdeklarimi i shumës prej 1.200.00 lekësh si kursim në fund të vitit kalendarik 2011, nuk është një haresë apo pasaktësi në deklaram, por në vlerësimin e pakicës, përlligj dhe përfaqëson realisht situatën financiare të subjektit dhe të personit të lidhur në këtë vit.

9.5. Në konkluzion, në vlerësimin tonë, kjo shumë nuk duhet t'u shtohet kursimeve të përdorura për blerjen e apartamentit në Vlorë.

10. *Në drejtim të verifikimit të kursimeve të deklaruara nga personi i lidhur për vitet 2006-2010*

Kemi konstatimet e vlerësimet e mëposhtme, të arsyetuara me të njëjtën metodologji si për kursimet e subjektit të rivlerësimit. Këto kursime janë krijuar prej të ardhurave të saj nga puna si gjyqtare dhe nga puna si pedagoge në Universitetin jopublik {***}. Tipologjia e deklaramit, e cila ka prodhuar nevojën për analizë të *cash*-it në këto vite, lidhet me faktin se personi i lidhur, znj. E. Ll., ka deklaruar si kursime në *cash*, vlera të njëjta me të ardhurat e krijuara prej punës si gjyqtare dhe pedagoge, si edhe ka pretenduar se vlerat e krijuara prej shitjes dhe blerjes së dy automjeteve në njërin prej viteve të deklaramit, duhet të konsiderohen si kursime në *cash* për atë vit.

10.1. Edhe në këtë analizë, përveç informacionit për pagat e personit të lidhur, u konsiderua përmbajtja e shkresës së titulluar “Vërtetim”, datë 26.10.2016, lëshuar nga Universiteti jopublik {***}, ku pasqyrohet se personi i lidhur, znj. E. Ll., ka realizuar për periudhën tetor 2003 – dhjetor 2008, të ardhura neto nga puna si pedagoge në këtë universitet, në vlerën 774.360 lekë, pa specifikuar saktësisht vlerën e përfiturar çdo vit. Gjithashtu, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.12.2019, Universiteti jopublik {***} ka konfirmuar se: *Znj. Ll. është angazhuar si pedagoge e jashtme pranë Fakultetit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar {***}, për periudhën tetor 2003 - dhjetor 2008. Për periudhën tetor 2003 - shtator 2004, institucioni nuk disponon dokumente. Të ardhurat e realizuara për periudhën tetor 2004 deri më dhjetor 2008, janë si më poshtë: të ardhurat bruto 860.760 lekë; tatim në burim 86.070 lekë; të ardhura neto 774.360 lekë.*

10.2. Meqenëse në vërtetimin nr. {***} prot., datë 16.12.2019, të lëshuar nga Universiteti jopublik {***}, pasqyrohet se të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur fillojnë në tetor 2004 dhe shtrihen deri në shkurt të vitit 2008, sipas deklaramit të vetë asaj në DPV-në e vitit 2008 dhe dokumentacionit bankar i cili konfirmon kreditimin e shumës prej 22.320 lekësh në këtë vit, shpërndarja e këtyre të ardhurave në periudhën tetor 2004 - shkurt 2008, u korrektoua sipas të dhënave të mësipërme, duke konsideruar edhe periudhën akademike e cila mundëson çdo vit kalendarik përfitimin e të ardhurave për shkak të mësimdhënies. Rezultati i kësaj metodologjie të ngjashme me analizën që ka bërë edhe shumica, u reflektua në llogaritjen e kursimeve të personit të lidhur. Sipas kësaj analize, personi i lidhur rezulton të ketë marrë prej Universiteti jopublik {***}, në vitin 2004, pagën për tre muaj, tetor-dhjetor, në vlerën 75.204 lekë; në vitet 2005, 2006 e 2007, pagën për 9 muaj në secilin vit, respektivisht në vlerën prej 225.612 lekësh dhe për vitin 2008 ka përfiturar vlerën prej 22.320 lekësh.

10.3. Në një vlerësim të përgjithshëm të kësaj analize, rezulton se personi i lidhur ka deklaruar në total në vite, të ardhura prej Universitetit jopublik {***}, shumën prej 1.235.000 lekësh, e cila dukshëm është më e lartë se ajo që vërtetohet nga institucioni se është përfiturar,

duke bërë që në krye të herës të pabesueshme deklaramet e subjektit për gjendjen *cash*, e cila është krijuar edhe për shkak të këtyre të ardhurave. Në konsideratë të këtyre konkluzioneve, kemi pasur vlerësimet e mëposhtme.

10.4. Në DPV-në e vitit 2006, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, personi i lidhur ka deklaruar: *Të ardhura nga paga si gjyqtare në shumën 450.000 lekë, të ardhura si pedagoge në Fakultetin {***} në shumën 360.000 lekë, si dhe të ardhura nga shitja e automjetit në vlerën 400.000 lekë.* Në seksionin “Të ardhura nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, ka deklaruar: *Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtare, në masën 900.000 lekë dhe të ardhura nga paga mujore si pedagoge në Fakultetin {***}, 45.000 lekë/muaj.*

10.5. Në përgjigjet e pyetësorit nr. {***}, personi i lidhur ka deklaruar se *ka përfiturar të ardhura nga paga si gjyqtare në shumën 972.560 (nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë dhe të ardhura si pedagoge në shumën 360.000 lekë. Po në këtë vit, si rezultat i shitjes së automjetit tip “Fiat Punto”, {***}, dhe blerjes së automjetit tip “Opel Joy Corsa”, shpenzimeve të kryera për jetesë dhe shpenzimeve të tjera, kam kursyer shumën 800.000 lekë, e cila së bashku me shumën 100.000 lekë të kursyer në vitin 2005 dhe 5.000.000 lekë që ishte kursim i realizuar përpara fillimit të ushtrimit të detyrës, përbëjnë shtim të kursimeve të mia, në shumën totale 5.900.000 lekë⁶⁸.*

10.6. Pavarësisht se personi i lidhur, znj. E. Ll., i ka deklaruar si të ardhura dhe jo si kursime, në një lexim logjik të gjithë të dhënave, kursime të mundshme për këtë vit, referuar deklarameteve të saj, mund të llogaritet shuma 450.000 lekë, me burim nga paga, duke qenë se paga vjetore si gjyqtare është në vlerën 972.560 lekë, dhe vlera prej 225.612 lekësh, si pedagoge në Universitetin jopublik {***}. Kjo e fundit është maksimalisht shuma e përfiturar prej saj nga kjo marrëdhënie sipas analizës së bërë më lart, në versionin që e gjithë e ardhura ka shërbyer për kursim dhe jo në vlerën e deklaruar prej saj, në shumën 360.000 lekë, e cila nuk provohet as që është përfiturar në këtë vit, aq më pak të jetë krijuar si kursim në fund të vitit. Të ardhurat e krijuara apo të shpenzuara për shitblerje të pasurive automjete në këtë vit e të deklaruara në seksionin e ndryshimeve të pasurisë, nuk përfaqësojnë, në vlerësimin tonë, vlera që duhet të llogariten si kursime, por vlera që pasqyrojnë ndryshimet në pasurinë e luajtshme të personit të lidhur, të cilat kanë ndodhur gjatë vitit deklarues. Në finale, për vitin 2006, duhet të përllogaritet si kursim për personin e lidhur, vlera prej 675.612 lekësh.

⁶⁸ Subjekti i rivlerësimit, znj. E. Ll., gjatë gjykimit në Kolegj, me prapësimet mbi analizën financiare paraprake, sipas pretendimeve të Komisionerit Publik, për kursimet e saj në “cash” për vitin 2007, ka shpjeguar se: “[...] Kjo do të thotë që në vitin 2006, kam realizuar të ardhura nga punësimi si gjyqtare dhe si pedagoge, gjithsej në shumën 1.055.300 lekë dhe kam kursyer shumën 810.000 lekë. Në vitin 2007, sipas së njëjtës logjike të sipërcituar, kam kursyer shumën 450.000 lekë nga të ardhurat e mia nga paga edhe si gjyqtare, edhe si pedagoge dhe në vitin 2007, kam realizuar kursim në shumën 225.000 lekë. Pra, në vitin 2006, kam kursyer vlerën 810.000 lekë dhe në vitin 2007, kam kursyer 450.000 lekë.

Pavarësisht sa më sipër, nëse Kolegji nuk pranon arsyetimin e sipërcituar, mund të konsideroj shtimin e “cash-it” nga të ardhurat nga punësimi si pedagoge, të barabartë me vlerën e të ardhurave të dokumentuara sipas shkresës së Universitetit jopublik “{***}”. Pra, në vitin 2006, gjendja “cash” të përllogaritet se është shtuar në vlerën 675.000 lekë, në vitin 2007 në vlerën 375.000 lekë dhe në vitin 2008 në vlerën 220.000 lekë”.

10.7. Në DPV-në e vitit 2007, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, personi i lidhur ka deklaruar: *Të ardhura nga paga si gjyqtare në shumën 150.000 lekë, të ardhura si pedagoge në Fakultetin {***} në shumën 300.000 lekë.* Në seksionin “Të ardhura nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, personi i lidhur ka deklaruar: *Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtare në masën 825.442 lekë (795.442 pagë + 30.000 shpërblim) dhe të ardhura nga paga mujore si pedagoge në Fakultetin {***} për periudhën janar – korrik 2007, në masën 45.000 lekë/muaj dhe për periudhën nëntor – dhjetor, 15.000 lekë/muaj, dhe 3.000 lekë/orë mësimore.*

10.8. Në përgjigje të pyetësorit nr. {***}⁶⁹, të drejtuar nga Komisioni, për vitin 2007, personi i lidhur nuk e ka pretenduar si kursim shumën e deklaruar si të ardhur nga puna si pedagoge në Universitetin jopublik {***}, në vlerën prej 300.000 lekësh. Për më tepër që sipas analizës së bërë më lart, nuk provohet të ketë përfituar në këtë vit kalendarik, prej Universitetit jopublik {***}, shumën prej 300.000 lekësh, siç deklaroi, por vetëm shumën prej 225.612 lekësh, për pasojë deklarim i saj për gjendjen e *cash*-it të krijuar në fund të vitit, duhet të llogaritet vetëm shuma prej 150.000 lekësh, e pranuar prej saj në përgjigjet e dhëna në pyetësorin nr. {***}, të drejtuar nga Komisioni.

10.9. Në DPV-në e vitit 2008, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, personi i lidhur ka deklaruar: *Të ardhura nga paga si gjyqtare në shumën 200.000 lekë (totali 819.775 lekë në vit), të ardhura si pedagoge në Fakultetin {***} në shumën 25.000 lekë vetëm në muajt janar, shkurt.* Në seksionin “Të ardhura nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, personi i lidhur ka deklaruar: *Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtare në masën 200.000 lekë dhe të ardhura nga paga mujore si pedagoge në Fakultetin {***}, për periudhën janar – korrik 2007, në masën 25.000 lekë vetëm për muajt janar, shkurt.*

10.10. Duke analizuar mënyrën e deklarimit të personit të lidhur në këtë vit, konstatohet se vlera prej 200.000 lekësh, duhet të konsiderohet si kursim, pavarësisht deklarimit të saj si e ardhur, duke qenë se ajo është trajtuar si një pjesë e të ardhurave prej punës si gjyqtare. Ndërsa nuk konsiderohet si kursim vlera prej 25.000 lekësh, e përfituar prej Universitetit jopublik {***}, duke qenë se në përgjigjet e pyetësorit nr. {***}, personi i lidhur nuk e konsideron këtë vlerë si kursim të vitit, por vetëm si të ardhur. Si konkluzion, shuma e kursyer në vitin 2008 dhe që duhet t’i nënshtrohet analizës financiare, është shuma prej 200.000 lekësh.

10.11. Ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën në lidhje me gjendjen e kursimeve *cash* për vitet 2010 e 2011 në vlerat respektive prej 200.000 lekësh.

⁶⁹ Në përgjigjet e pyetësorit nr. {***}, për pyetjen 4, referuar të ardhurave të vitit 2007, subjekti ka shpjeguar sa vijon:

“Për vitin 2007, sipas deklaratës vjetore të këtij viti, dorëzuar në ILDKPKI në dt. 19.03.2008, kam përfituar të ardhura nga paga si gjyqtare, në shumën 825.442 lekë dhe të ardhura nga paga si pedagoge në Fakultetin {***}, në shumën 300.000 lekë. Referuar shpenzimeve të kryera për këtë vit financiar dhe të ardhurave të përfituara, shuma e kursyer prej meje për vitin 2007, është shënuar në faqen 3 të formularit të vetëdeklarimit, në vlerën 150.000 lekë, shumë e cila i shtohet vlerës prej 5.900.000 lekësh, të kursyera në vitin 2004, 2005 dhe 2006, në një total kursimesh në shumën 6.050.000 lekë”.

10.12. Në DPV-në e vitit 2012, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *Blerje, me anë të kontratës Leasing. Shuma 9.679.47 euro e paguar, është siguruar në mënyrë të barabartë nga kursimet personale të subjektit dhe të bashkëshortes.* Në analizë të këtij deklarimi, u zbritën me nga ½-tën kursimet e ish-bashkëshortëve të akumuluar deri në vitin 2012, duke pasur një rezultat financiar pozitiv për vitin financiar, por që shkakton pakësimet e kursimeve të subjektit të rivlerësimit në vlerën 586.318 lekë dhe të personit të lidhur në vlerën prej 676.208 lekësh⁷⁰. Kjo situatë financiare reflektohet më pas në përlogaritjen e mundësisë për kursime për blerjen e apartamentit në Vlorë.

10.13. Për sa më sipër, në referim të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur në deklaratat periodike të viteve 2013, 2014, 2015 e 2016⁷¹, gjendja e likuiditeteve *cash* të ish-bashkëshortëve në vitin 2014, shtohet në vlerën prej 300.000 lekësh; në vitin 2015, kjo gjendje pakësohet në vlerën prej 800.000 lekësh; dhe më pas, shtohet në vitin 2016, në vlerën prej 500.000 lekësh.

10.14. Duke konsideruar konkluzionet e mësipërme për: (i) gjendjen e kursimeve *cash* të subjektit në vitin 2003; (ii) kursimet *cash* të subjektit në vitet 2004-2012; (iii) gjendjen e kursimeve *cash* të personit të lidhur në vitin 2004; (iv) kursimet e personit të lidhur në vitet 2006-2012; kursimet e përbashkëta në vitet 2012-2016, sipas analizës financiare të ndërtuar mbi to, rezultojnë se subjekti dhe personi i lidhur kishin mundësi të justifikonin me burime të ligjshme për blerjen e pasurisë, apartament, në Vlorë, vetëm shumën prej 1.014.851 lekësh, përkundër vlerës së blerjes së kësaj pasurie prej 55.000 eurosh, ekuivalente me 7.615.223 lekë, sipas kontratës së shitblerjes.

10.15. Në këto kushte, sipas vlerësimit tonë, subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të financuar blerjen e apartamentit në Vlorë, në një vlerë prej (-) 6.572.225 lekësh.

11. Lidhur me automjetin, tip “Audi Q7”

Kemi ndarë gjithashtu qëndrim të ndryshëm me shumicën e trupit gjykues duke i gjetur të drejta pretendimet e Komisionerit Publik të ngritura në ankim, lidhur me të drejtat e subjektit të rivlerësimit në raport me këtë pasuri.

⁷⁰ Vlera e automjetit në shumën 16.500 euro (ekuivalent me 2.305.380 lekë). Vlera për t’u paguar nga “{***}”, deri në përfundim të afatit në shumën 18.345,06 euro. Në vitin 2012 janë paguar 7.500 euro (ekuivalent me 1.047.900 lekë) nga “{***}” dhe është deklaruar që shuma prej 9.679,47 eurosh (ekuivalent me 1.352.208 lekë) është paguar duke u siguruar në mënyrë të barabartë nga kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur. Nga analiza financiare, ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të mbulonte me burime të ligjshme një pagesë maksimalisht deri në shumën 586.318 lekë, ndërsa personi i lidhur gjysmën e vlerës në shumën 677.208 lekë. Shuma e paguar, të dy së bashku, në një total prej 1.262.526 lekësh.

⁷¹ Deklarimet e kursimeve në “cash” të subjektit dhe të personit të lidhur në DPV 2013 – 2016 janë:

- Në DPV-në e vitit 2013, subjekti nuk deklaroi shtesë/pakësim në “cash”.
- Në DPV-në e vitit 2014, subjekti deklaroi shtim në “cash”, shumën 300.000 lekë. Në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar “Kursime nga të ardhurat vjetore të miat dhe të bashkëshortit, të cilat u shtohen shumave të kursyera dhe të deklaruara ndër vite”.
- Në DPV-në e vitit 2015, subjekti deklaroi pakësim “cash-i”, në shumën 800.000 lekë. Në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: “Pakësim i kursimeve të mbledhura ndër vite “cash” në banesë”.
- Në DPV-në e vitit 2016, subjekti deklaroi gjendje “cash” në banesë 500.000 lekë.

11.1. Pasuria nën kontroll, sipas këtij shkaku ankimi, është një automjet, tip “Audi Q7”, blerë nga babai i subjektit, z. R. H., me anë të kontratës së datës 20.04.2011, në vlerën prej 37.000 USD, vlerë së cilës i shtohet edhe vlera prej 932.091 lekësh, paguar për doganën e mjetit. Sipas kontratës së huapërdorjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 07.07.2011, huadhënësi R. H. i lë në përdorim huapërdoruesit, subjekti i rivlerësimit, automjetin në pronësi të tij për një afat kohor të papërcaktuar për ta përdorur brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Huapërdoruesit i kalon, sipas kësaj kontrate, edhe përgjegjësia fizike dhe ligjore për mjetin.

11.2. Komisioneri Publik ka parashtruar në ankim, në paragrafët 34 e vijues, se Kolegji duhet të analizojë dhe kontrollojë analizën financiare të kryer për babain e subjektit të rivlerësimit nga Komisioni, lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme për të financuar blerjen e automjetit, tip “Audi Q7”, duke pasur në konsideratë kursimet e deklaruara prej subjektit në deklaratat periodike vjetore dhe të dhënat e deklaratës noteriale të prindërve të tij me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.09.2020, rezultatet e së cilës, duke u analizuar krahas përgjegjësisë fizike të subjektit mbi automjetin, tregojnë se subjekti është pronar *de facto* i kësaj pasurie.

11.3. Ndryshe nga qëndrimi i shumicës së trupit gjykues, kemi pasur vlerësimin se kontrolli i kësaj pasurie, mbështetur në pretendimet e Komisionerit Publik, duhet të fillojë nga verifikimi i burimeve të ligjshme të babait të tij për të financuar blerjen e kësaj pasurie dhe se rrethanat e tjera të konstatuara prej hetimit administrativ, duhet të analizohen në raport dhe harmoni me rezultatet e analizës financiare për burimin e krijimit të pasurisë.

11.4. Sipas vlerësimit tonë, rasti në shqyrtim, referuar shkaku të ankimit i cili ka ngritur dyshimin për pasuri *de facto* të subjektit, në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, përjashton dhe bën pa relevancë diskutimin nëse përdorimi i një sendi i prodhon subjektit të rivlerësimit detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të tij dhe përdorimin e qëndrimeve të mbajtura prej jurisprudencës së Kolegjit në të tilla raste, se ky detyrim nuk ekziston pasi kjo situatë nuk e vendos marrëdhënien brenda përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin tonë, standardet dhe kuptimi për kufijtë e kontrollit të një marrëdhënieje përdorimi të pranuar prej Kolegjit, nuk gjejnë zbatim në rastin konkret, për sa kohë në këtë rast është ngritur dyshimi për pasjen e një marrëdhënieje të ndryshme nga përdorimi dhe për pasuri *de facto* të subjektit. Situata në shqyrtim është pikërisht përjashtimi nga zbatimi i këtij rregulli, sipas po kësaj jurisprudence⁷².

11.5. Në këto rrethana, kemi vlerësuar se kontrolli i të drejtave të subjektit drejt kësaj pasurie, duhet të nisë sipas pretendimit të Komisionerit Publik, nga kontrolli i burimeve të financimit, duke u kryer për këtë shkak një kontroll që merr në analizë çdo të dhënë rreth të ardhurave dhe shpenzimeve të babait të subjektit, një dimension i ndryshëm nga verifikimi që bëjnë organet e rivlerësimit sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vetëm për pasuritë në transaksion dhe brenda një vlerësimi të arsyeshëm e objektiv të shpenzimeve të personave të tjerë të lidhur.

11.6. Në vlerësimin tonë, rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ, mbështesin pretendimet e Komisionerit Publik për dyshimin se pasuria ka qenë në pronësi *de facto* të subjektit.

⁷² Shih vendimin e Kolegjit nr. 26/2019 (JR), datë 21.10.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Ramadan Troci dhe vendimin nr. 9/2020 (JR), datë 26.06.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Alfred Gjoni.

11.7. Së pari, nga analiza financiare e kryer për babain e subjektit për të blerë automjetin, rezulton se ai gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për ta blerë atë për një vlerë prej (-) 4.995.395 lekësh, praktikisht aq sa është edhe vetë vlera e pasurisë në fjalë. Në këtë analizë, janë konsideruar si të ardhura, ato të babait dhe nënës së subjektit të rivlerësimit, pa përfshirë të ardhurat e subjektit dhe të motrave të tij për periudhat e tyre të shkollimit.

11.8. Subjekti ka pretenduar se të ardhurat e tij dhe ato të motrave të tij duhet të konsiderohen si burime të krijimit të shumës së përdorur për financimin e kësaj pasurie, pretendim të cilin e ka ngritur në hetimin administrativ në një fazë të avancuar, pasi Komisioni i kishte vënë në dukje problematikat me financimin e pasurisë. Në terma praktikë, subjekti i rivlerësimit pretendon të llogariten të ardhurat e tij për analizën financiare të familjes së babait, të cilat i korrespondojnë pothuajse vlerës së automjetit të blerë. Në vlerësimin tonë, ky pretendim i subjektit nuk duhet të merret në konsideratë sepse bie në kundërshtim me disa deklaratime/shpjegime, të dhëna po nga vetë subjekti i rivlerësimit përgjatë hetimit.

11.9. Subjekti, në fazën fillestare të hetimit, ka depozituar në Komision deklaratën noteriale me nr. {***} rep., {***} kol., datë 12.09.2020, të prindërve të tij, të hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit rreth mënyrës së fitimit të pronësisë e burimeve të financimit të kësaj pasurie.

Në këtë deklaratë, prindërit e subjektit deklarojnë se: *shuma për blerjen e këtij automjeti është siguruar nga të ardhurat e përfituara nga ne: z. R. H. e znj. A. H. ndër vite, që prej fillimit të marrëdhënieve të punës në vitin 1973 e deri në ditën e blerjes së këtij automjeti. Më tej, ata shprehen se: fëmijët tanë kanë ndjekur shkollën e lartë dhe specializimet përkatëse pas përfundimit të saj. Për pasojë, shpenzimet e tyre (fjetje, ushqim, mjete shkollore etj.) përballoheshin nga ne të dy, duke i lejuar të kursenin sa më shumë të ardhura nga punësimi i tyre në punë të ndryshme, gjatë periudhës së shkollës edhe më pas, me qëllim përdorimin e këtyre të ardhurave në momentin e daljes si familje më vete. Në vijim, deklarata vijon: deklarojmë se të ardhurat tona ndër vite kanë qenë më se të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës, sigurimin e apartamentit të banimit dhe të automjetit dhe përbëhen nga të ardhurat tona të fituara me punë, që prej fillimit të marrëdhënieve të punës në vitin 1973, sipas dokumentacionit përkatës të vënë në dispozicion për ju nga z. Gerd Hoxha, në përgjigjet e pyetësorit nr. {***} të dërguar nga ju si më poshtë [...]. Aktet e cituara në deklaratë, në mbështetje të këtij deklarimi të fundit, janë të gjitha aktet zyrtare që provojnë të ardhurat e prindërve të subjektit në vite nga punësimi i tyre në sektorin publik e privat.*

11.10. Në harmoni me këtë deklaratë janë edhe shpjegimet e dhëna prej subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. {***}, në të cilin Komisioni i ka shtruar pyetje rreth burimit të krijimit të kësaj pasurie. Subjekti ka deklaruar se: *Shuma për blerjen e këtij automjeti, është siguruar nga të ardhurat e përfituara nga prindërit e mi, z. R. H. dhe znj. A. H., ndër vite, që prej fillimit të marrëdhënieve të punës në vitin 1973 e deri ditën e blerjes së këtij automjeti. Dokumentacioni provues bashkëlidhur është si më poshtë vijon: [...]. Subjekti ka renditur të njëjtin dokumentacion si në deklaratën noteriale. Vetëm në përgjigjet e pyetësorit të katërt, subjekti përdor konceptin e burimit të të ardhurave të të gjithë familjes për blerjen e automjetit, duke deklaruar se: të ardhurat e ligjshme dhe të tatuara të tim ati në total, vetëm për periudhën e fundit, 5-6 vjeçare, nga viti 2006 deri në qershor 2011, përlllogariten në 4.500.000 lekë dhe në total të ardhurat e ligjshme dhe të tatuara tërësisht të familjes së tij në këtë periudhë 5-6 vjeçare, ishin në total në vlerën prej mbi 15.000.000 lekë.*

11.11. Nga një lexim i kujdesshëm i deklarimeve të prindërve të subjektit, por edhe të deklarimeve të para të tij, duket se ata kanë dashur të potencojnë faktin se automjeti është blerë tërësisht me të ardhurat e krijuara nga puna e tyre, të cilat madje kanë shërbyer jo vetëm për pasuritë e familjes, por edhe për përballimin e shpenzimeve të jetesës së fëmijëve, deri në shkëputjen nga trangu familjar. Nuk ka asnjë shenjë apo indicie në këto deklarime, që të nënkuptojë se të ardhurat që prindërit i konsiderojnë të tyre që nga viti 1973, të kenë të përfshira në to edhe të ardhurat e subjektit apo familjarëve të tjerë (motrave) të tij. Për më tepër që, për shkak të këtyre të ardhurave, duket se bëhet i mundur financimi i automjetit.

11.12. Në këto kushte, në vlerësimin tonë, deklarimi i subjektit i bërë prezent për herë të parë vetëm në përgjigjet e pyetësorit të katërt të Komisionit, duke pretenduar të konsiderohen të ardhurat e të gjithë familjes për blerjen e këtij automjeti, madje edhe të tijat, ndonëse asnjëherë të përmendura prej tij në formën e një investimi apo kontributi të kryer në krijimin e kësaj pasurie përgjatë gjithë kohës që ai ka deklaruar për pasuritë dhe interesat privatë të tij, është i pabesueshëm dhe i pambështetur nga vetë deklaratimet e përcjella në proces prej vetë atij.

11.13. Për shkak të kësaj inkonsistence në deklaratimet e subjektit dhe kundërshtisë së tyre me ato të prindërve të tij, kemi vlerësuar se analiza financiare që duhet t'u bëhet burimeve të krijimit të kësaj pasurie, duhet të përfshijë vetëm të ardhurat e prindërve të subjektit, siç edhe ata vetë kanë deklaruar me vullnet të plotë. Pretendimet e ngritura nga subjekti në një fazë të avancuar të procesit, janë dukshëm në shërbim të nevojës për të shëruar problematikat e evidentuara prej hetimit administrativ. Nga analiza e kryer në këtë mënyrë, rezulton se babai i subjektit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie, në një vlerë prej (-) 4,9 milionë lekësh, praktikisht e gjithë shuma që përfaqëson vlerën e blerjes së kësaj pasurie.

11.14. Pas plotësimit dhe dhënies përgjigje të këtij kërkimi të Komisionerit Publik, kemi analizuar pretendimet e tjera të ankimit që lidhen me verifikimin e përgjegjësisë fizike dhe ligjore të mjetit të ngarkuar subjektit sipas kontratës së huapërdorjes dhe analizën e rrethanave të tjera që kanë rezultuar prej hetimit, lidhur me këtë pasuri.

11.15. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklaratën *vetting* dhe ka pretenduar përgjatë gjithë hetimit dhe gjykimit se ai e ka përdorur atë sporadikisht, kryesisht për daljet jashtë vendit me familjen dhe asnjëherë brenda territorit.

11.16. Lidhur me këtë pretendim, rezulton nga hetimi administrativ, se subjekti ka pasur posedimin efektiv të këtij automjeti, nëpërmjet kontratës së huapërdorjes së cituar më lart dhe të shoqëruar me plotësimin e policave të sigurimit në emër të tij dhe të personit të lidhur⁷³. Nga këto akte, të administruara gjatë hetimit, rezulton se subjekti ka përdorur automjetin jashtë

⁷³ *Policat e sigurimit të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur për automjetin "Audi Q7", me targë [***], në funksion të hetimit administrativ, janë përcjellë në Komision nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe grupohen në polica që subjekti i ka pasur së bashku me bashkëshorten dhe polica në emër vetëm të tij.*

Policat e poseduara së bashku u përkasin periudhave si në vijim: 30.7.2016 - 29.7.2017; 30.7.2015 - 29.7.2016; 27.7.2013 - 25.7.2014; 4.7.2012 - 3.7.2013; 1.7.2011 - 30.6.2012; 30.12.2015 - 13.1.2016; 27.11.2015 - 11.12.2015; 18.1.2013 - 18.1.2014; 19.10.2012 - 18.01.2013; 8.9.2012 - 22.9.2012; 25.11.2011 - 9.12.2011; 26.8.2011 - 5.10.2011

Policat e poseduara vetëm në emër të subjektit të rivlerësimit u përkasin periudhave si në vijim: 9.3.2018 - 23.3.2018; 10.2.2017 - 24.2.2017; 25.11.2016 - 9.12.2016; 24.8.2016 - 7.9.2016; 11.3.2016 - 25.3.2016; 21.8.2015 - 4.9.2015;; 7.4.2012 - 21.4.2012; 16.1.2012 - 30.1.2012; 8.7.2011 - 22.7.2011

vendit në 24 raste, në të cilat, sipas parashikimit të nenit 9⁷⁴ të ligjit të kohës nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar⁷⁵, ai është pajisur me kartonin jeshil, ndërsa rezulton të jenë pajisur edhe me policën e sigurimit të detyrueshëm (të njohur si “TPL”), për përdorimin e mjetit brenda vendit përgjatë të gjithë kohës që automjeti ka qenë në pronësi të babait të tij. Këto të dhëna tregojnë se subjekti është sjellë me sendin si pronar dhe duket se vetëm përdorimi i zakonshëm dhe i rregullt edhe brenda vendit, ka detyruar atë të plotësojë në emër të tij edhe policat e sigurimit të detyrueshëm për lëvizjen e automjeteve në territorin e vendit. Gjithashtu, edhe përcaktimi i bërë në kontratën e huapërdorjes për përgjegjësi fizike dhe ligjore të automjetit, të cilat i kalojnë subjektit, duket si një vullnet për kalimin e tagrave të plotë mbi sendin dhe jo sporadikë, si subjekti pretendon.

11.17. Hartimi i kontratës së huapërdorjes, menjëherë pas kalimit të pronësisë së automjetit te babai i subjektit, tregon gjithashtu për një marrëdhënie të qëndrueshme të subjektit me sendin dhe jo sporadike, siç ai pretendon. Një marrëdhënie sporadike do të lindte në momentin që do të shfaqej nevoja, por jo menjëherë me kalimin e pronësisë.

11.18. Tipi i automjetit, i cili përkon me një automjet me përmasa të konsiderueshme, dhe me të dhëna që i përkasin një mjeti që del nga natyra e automjetit familjar, dhe konsiderohet si një automjet luksi⁷⁶, duket se e largon babain e subjektit nga preferimi i një automjeti të tillë për përdorim vetjak, konsideruar moshën dhe statusin social.

11.19. Vlera e automjetit, rreth 4,9 milionë lekë, gjithashtu është një element që dobëson besimin se babai i subjektit mund t’i lejonte vetes një shpenzim të kësaj natyre, aq më tepër të përballuar nga të ardhurat e fëmijëve të tij, për të cilët ai ka deklaruar se i ka mbështetur financiarisht gjatë gjithë kohës që ata të krijojnë kursimet e tyre për përballimin e jetesës pas shkëputjes nga trangu familjar. Për më tepër, duke mbajtur në konsideratë moshën, statusin social dhe ekonomik apo stilin e jetesës në shërbim të vazhdueshëm të familjes, si edhe faktin e deklaruar nga subjekti se babai i tij ka punuar në pozicione pune në sektorin privat, të cilat nuk duket se rezonojnë me aspiratën për të zotëruar një automjet të këtij lloji, forcohet bindja se zotërimi i kësaj pasurie nga babai i subjektit, është i pabesueshëm.

11.20. Nuk rezultojnë gjurmë të përdorimit të mjetit prej babait të subjektit, në kuptimin e një përdorimi efektiv dhe të përshtatshëm me tagrat e pronarit të mjetit.

⁷⁴ Kjo dispozitë parashikon se:

“1. Kontrata për sigurimin e detyrueshëm, referuar shkronjave “a” e “ç” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, mbulon dëmet ose humbjet e ndodhura në Republikën e Shqipërisë.

2. Kontrata për sigurimin e detyrueshëm, referuar shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, mbulon dëmet ose humbjet e ndodhura në Republikën e Shqipërisë dhe në territoret e shteteve anëtare të sistemit të kartonit jeshil.

3. Kontrata për sigurimin e detyrueshëm, referuar shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, i referohet territorit të Republikës së Shqipërisë dhe territoreve të shteteve anëtare të sistemit të kartonit jeshil, kur nuk është rënë dakord ndryshe”.

⁷⁵ Ky ligj aktualisht është ndryshuar me ligjin nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Sipas këtij ligji, “Kartoni jeshil” është certifikata ndërkombëtare e sigurimit, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Kretës dhe se “Polica e sigurimit të detyrueshëm”, siç shpjegon edhe vetë emërtimi, është e detyrueshme për përdorimin e mjetit brenda vendit.

⁷⁶ Në kontratën e huapërdorjes, ky automjet identifikohet i markës “Audi”, i tipit “1BV Q7”. Automjeti me këto karakteristika, referuar burimeve të hapura të kërkimit, rezulton të jetë me cilindrata 3000 dhe, si i tillë, bazuar në informacionin e ofruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), ai klasifikohet si një automjet luksi:

<https://www.dpshttrr.al/mjete/taksa-detyrime>.

11.21. Pretendimet e subjektit për mënyrën e pagesës së mjetit apo faktin se pagesat e bëra prej tij janë bërë për llogari të babait të tij, apo edhe vetë shitja e mjetit në vitin 2018 dhe ngurtësimi i të ardhurave në depozita bankare, konsiderohen më shumë si një përkujdesje për ta shkëputur marrëdhënien me këtë send në kuadër të procesit të rivlerësimit sesa një ushtrim natyral i tagrave të pronësisë prej babait të tij.

11.22. Për të gjitha argumentet e mësipërme, pakica ka vlerësuar se *së pari*, analiza nëse jemi ose jo para zbatimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe a na lejon ky nen të hetojmë për burimet e ligjshme të pasurisë të personit tjetër të lidhur, është pa relevancë në rastin konkret, duke qenë se dispozita e zbatueshme është parashikimi i nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, që detyron subjektet të provojnë ligjshmërinë e pasurive në përdorimin e tyre. Në kushtet kur kjo marrëdhënie përdorimi është vënë në dyshim në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ankimi, pakica vlerëson se hetimi duhet të jetë i plotë, i gjithanshëm dhe pa kufizime. Një nga detyrat e organeve të rivlerësimit është hetimi dhe zbulimi i pasurive të padeklaruara të subjekteve, dhe në rastet kur këto dyshime ngrihen, organet kanë detyrë të ushtrojnë të gjitha kompetencat në juridiksionin e tyre, për t'i hetuar këto dyshime.

11.23. Së dyti, në vlerësimin tonë, subjekti i rivlerësimit nuk e përmbysi barrën e provës, kaluar përmes ankimit të Komisionerit Publik lidhur me pronësinë *de facto* të kësaj pasurie. Nga analiza logjike e të gjitha fakteve që kanë rezultuar nga procesi, të analizuar më lart, krahas faktit se babai i tij nuk justifikon burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, të çojnë sipas vlerësimit tonë, në konkluzionin se dyshimi i ngritur nga Komisioneri Publik, se subjekti i rivlerësimit është pronar *de facto* i kësaj pasurie dhe gjendet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, është i drejtë dhe i bazuar në prova.

12. Për të gjitha sa u arsyetuan më lart, pakica ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për justifikimin e pasurive, apartament me sipërfaqe 125 m², të ndodhur në Tiranë, dhe apartament me sipërfaqe 128 m², të ndodhur në Vlorë, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si edhe para fshehjes së të drejtave të pronësisë lidhur me automjetin “Audi Q7”, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84.2016.
13. Në konkluzion të këtyre dy kualifikimeve, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që e ka konfirmuar atë në detyrë, duhej të ndryshohej dhe të disponohej për shkarkimin e tij nga detyra, sipas urdhërimit të kësaj dispozite.
14. Për sa më sipër, kemi votuar kundër vendimit të shumicës, i cili la në fuqi vendimin e Komisionit objekt gjykimi.

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi